

F/e 0-60



BIBLIOTEKA  
E USHTARIT DHE OFICERIT

8

# KOMANDANT DHE STRATEG I MADH






BIBLIOTECA

*Fjalime dhe letra  
té  
Skënderbeut*

«Botohen me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së heroit  
tonë kombëtar Gjergj Kastriotit, Skënderbeut.»



KONTROLI  
1974 - 1975

BOTIM I DREJTORISË POLITIKE TË USHTRISË POPULLORE

TIRANË, 1967



Gatitur nga STEFAN I. PRIFTI

"*... kushlohen ushtirisë sonë heroike popullore*"

### Dy fjalë si hyrje

Me rastin e 500 vjetorit të vdekjes së heroit tonë kombëtar GJERGJ KASTRIOTIT, SKËNDERBEUT, mendova se do të ishte një punë e dobishme botimi më vehte i fjalimeve dhe i letrave, të cilat thuhet se ai i ka mbajtur e shkruar në raste të ndryshme të jetës dhe të aktivitetit të tij. Këto fjalime e letra përbahen në veprën monumentale të historianit tonë humanist M. Barleti, e cila mban titullin: «Historia e jetës dhe e vepravet të Skënderbeut», dhe janë nxjerrë prej saj në bazë të botimit shqip, bërë në Tiranë në vitin 1964. Kështu, në këtë botim nuk përbahen gjithë letrat që i atribuohen Skënderbeut.

Këto fjalime, mbështeten në një realitet historik të padis-kutueshëm të asaj kohe, në aspiratat, idealet, dëshirat dhe mëndimet, në luftën vigane, në mëndjen dhe zemrën, në dorën e në shpatën e Skënderbeut dhe të popullit të tij; ato shprehin frymën progresive të kohës, shpirtin e popullit tonë, të simbolizuar përmes figurës së madhërishme të birit të tij të denjë, kryetrimit Skënderbe. Në këto fjalime e letra Barleti ynë vë në dukje me mënyrën më të përshtatur vjetitë më të larta, më të bukura dhe më të ndritura të popullit tonë: mëndjelartësinë shqipëtare që të shprehemi me termin e Barletit, urtësinë dhe zgjuarësinë shqiptare, vendosmërinë dhe guximin e paepur arbëror, besimin e patundur dhe fuqinë e pamposhtur të shpirtit dhe të trupit shqiptar, dashurinë e zjarrtë dhe të pakufishme për liri e pavarësi të atdheut, për nder e krenari kombëtare, shkurt: gjithë ato veti, cilësi e tipare karakteristike, që spikatin në veprën e Barletit tonë dhe që gërshetohen e çfaqen madhërishëm me tërë vitalitetin e tyre përmes veprimit dhe aktevet të veçantë që tërësojnë luftën e madhërishme të popullit tonë për liri e pamvarësi nën udhëheqjen e kryetrit. Duke patur para-sysh këtë përbajtje të lartë dhe reale, unë mendova se botimi më vehte i këtyre fjalimeve dhe letrave do t'i shërben-

te qëllimit edukativ për të njojur sa më mirë të kaluarën e lavdishme të popullit tonë, për të ushqyer me zjarrin skënderbegjian në ushterinë dhe riniqë tonë heroike ndjenjën e dashurisë së flaktë për atdhe, për liri e pavarësi kombëtare, besimin në fuqinë e pamposhtur dhe të pashtetur të popullit tonë dhe të fitores së plotë mbi armiqjtë etj. etj.

Duke ecur gjithmonë në traditat e lavdishme të heroit kombëtar Gjergj Kastriotit, të të parëve tanë, të partizanëve trima, ushtria jonë ka qenë e do të jetë e gatëshme të mbrojë me heroizëm të pashqë truallin e shenjtë, fitoret historike socialiste të popullit nga armiqjtë imperialisto-revisionist dhe veglat e tyre rrëth kufijve të atdheut.

Është nevoja të shënojmë këtu se fjalimet dhe letrat në fjalë shoqërohen me nga një hyrje ose karakterizim të përgjithëshëm lidhur me rëndësinë dhe vlerën e tyre në përmbytje, me përcaktimin e kohës, të vendit dhe me rastin kur mbahen apo shkruhen etj., si dhe me shënimë përkatëse për çështje, që duan sqarim. Gjithashtu duhet të shënojmë këtu se, duke marrë parasysh pikërisht qëllimin edukativ, që mendojmë se arrihet me anë të këtij materiali, ne i kemi riprodhuar fjalimet dhe letrat në fjalë me ndonjë ndryshim në disa shprehje jo të kohës, me ndonjë shkurtim përpjesë jo të nevojshme etj. Kjo nuk sjell ndonjë dëm në frymën, qëllimin dhe përmbytjen themelore të tyre.

Më në fund shënojmë se bashkë me letrat dhe fjalimet e Skënderbeut kemi riprodhuar në ndonjë rast edhe letra e fjalime jo të tij, si letrën e mbretit të Hungarisë Vladislav, me të cilën kërkon ndihmën e kryetrimit tonë kundër turqvet, fjalimin e mbretit të Napolit Ferdinand, me të cilin ai falënderon Skënderbeun, fjalimin e ororit David në senatin e Raguzës i cili është në esencë një hymn lavdie shqiptare përmes figurës së heroit tonë legjendar, e ndonjë tjetër. Këto letra e fjalime të huaja kanë vlerë të madhe edukative, prandaj menduan t'i riprodhojmë në këtë botim.

Siq dihet, Barleti ka qenë një historian i madh humanist që ka lënë një vepër të madhe patriotike, edukative. Por, ai, si përfaqësues i asaj kohe, përvèç shumë anëve pozitive, ka edhe mendime e shprehje idealiste, si psh mbi fenë, fatin, perënditë, etj. për të cilat janë bërë përpjekje të mënjanohen në këtë tekst.

Tiranë, 16.X.1967.

Stefan I. Prifti

I

## FJALIMI I SKËNDERBEUT NË KRUJË

Këtë fjalim Skënderbeu e mbajti në kohën kur, pasi çlroi Krujën dhe ngriti në të flamurin e lirisë më 28 Nëendor 1443, po bëhej gati të nisej për të çliruar pjesën tjetër të mbretërisë atërorë të tij. Ky rast i u dha Skënderbeut, sikurse dihet, pas betejës së Nishit, në të cilën turqit, me ndihmën direkte të kryetrimit tonë, pësuan kërdi të madhe nga Huniadi. Skënderbeu me ushtarët e tij, të cilët, siç thotë Barleti, «të gjithë kishin në gojë lirinë» dhe kur «kudo oshëtinte emri i émbël i lirisë» (I, 69), e çlroi Krujën me firmanin e sulttanit dhe me shpatën shpagimtare në dorë kundër turqvet kokëngjeshur, «të mbyllur si zoq në kafaz», duke bërë në ta kërdi të madhe. Pas kësaj, «si mbaruan këto punë» dhe u vu përsëri, vazhdon Barleti, në rregull e në udhë të mbarë çdo gjë në qytet, dhe si u grisën e u dogjën, kudo që u gjetën, flamurët e shënjasit e Tiranan» (I, 70). Skënderbeu dërgoi disa nga paria e qytetit të çliruar nëpër vëndet fqinjë të tij përtu bërë të ditur ngjarjen dhe «për t'i nxitur që të rrëmbevin sa më shumë armët; por s'ishte nevoja për asnjë lajmëtar apo nxitës: të gjithë pothuaj u gjetën të armatosur, duke pritur vetëm, me shpirt të vendosur, një komandant e iniciator» (Po aty). Kështu u grumbullua shpejt e shpejt në Krujë një fuqi e rëndësishme, ku shquhej sidomos për zjarrin e saj rinia, e cila, «sikur të mos kujdesej për gjë tjetër, i kishte rrëmbyer armët dhe po i shkonte pas, duke e quajtur shpëtimtar të lirisë», sepse «liria buçiste në gojë dhe në gjokset e të gjithëvet» (I, 71).

Ky fjalim i Skënderbeut, i mbajtur para se ai të jepte urdhërin e nisjes, është me rëndësi të madhe: në të Barleti ynë vë në dukje mbi të gjitha thelbin e shpirtit të popullit tonë; dashurinë për liri, rolin primar të tij në luftën vigane përtat fituar lirinë, mënçurinë dhe urtësinë e kryetrimit, që është vetë urtësia e popullit në shkallën më të lartë të saj.

«Asgjë të re, as të papritur nuk shoh këtu, kapedanë dhe

ushtarë kryetrima, që të mos ma ndjente më parë zëmra dhe të mos më mbushte me shpresë, sa herë që unë sillnja ndërmend tërë mall edhe **bujarinë e lashtë** të popullit, edhe shërbimet e veçanta dhe zyrtare tuaja ndaj babës tim, Gjoni. Dhe me të vërtetë, mos ma merrni për mburrje, por unë s'kam **dyshuar kurrë**, në asnjë çast të jetës sime, se, kur ruanja në zemër këtë qëllim, këtë dashuri për atdhe, kur ushqenja këto ndjenja për liri, këto dëshira të mia që s'më ndaheshin, **ishin edhe tuajat**. Kur ju më stonit shpesh, në kohën që isha pranë Tirani<sup>1)</sup> me tërë dashurinë dhe gatishmërinë tuaj për këtë vepër,<sup>2)</sup> gjë që unë tanë e kujtoj me kënaqësi dhe e them me mburrje,<sup>3)</sup> ju shkonte ndoshta në mënd se e kisha harruar atdhenë, se e kisha harruar nderin tim dhe lirinë, meqë ju kthenja prapë në shtëpi fort të pikëlluar, pa asnjë shpresë të sigurtë, pa asnjë shënje të qartë të qëllimit tim. Po's'ka dyshim, qytetarë, se me atë heshtje time, me atë përulësi të shtime<sup>4)</sup> të shpirtit tim, unë mendojë për vehte dhe për ju, sepse punët ishin t'atilla, që duheshin bëre më tepër se sa thënë, kurse ju kishit nevojë më fort për fre se sa për mamuza<sup>5)</sup>. Po e them se unë ua fsheha planet e mia, se s'ju thashë asnjë fjalë gjatë gjithë kësaj kohe për dëshirat e mia, jo sepse dyshonja në besnikërinë tuaj apo s'jua dinja mirë shpirtin, pose ju vetë m'i çfaqët të parët qëllimet tuaja në atë kohë aqë të rrezikëshme<sup>6)</sup>, por sepse më mbante frika që më shtinte brishtësia e vdekëtarëvet dhe paqëndrueshmëria e njerëzvet, e cila lëshohet me ngjut në çdo punë, dhe kur është rasti për lirinë, rrëmbhet e s'bëhet dot zap, nuk peshon asgjë, nuk ia var asnjë rregulli. Dhe, sikur t'i paraqitet rasti më i vogël jo vetëm për ta fituar, por për ta provuar lirinë, atëherë s'mund ta largojnë atë nga qëllimi as një mijë shpata, siç i thonë një fjale, as një mijë rrezique as vdekja e sigurtë dhe as rreziku i padyshimitë i të miravet dhe i jetës.

Por, kur në një punë të tillë, të nisur kot, përpjekjet da-

1) D.m.th., pranë Sulltanit Muratit II' si peng etj.

2) Për clirimin e vëndit nga robëria turke.

3) Skënderbeu shpreh këtu ndjenjën e krenarisë për sympathinë e popullit ndaj tij dhe për gatishmërinë për t'i shkuar pas.

4) Skënderbeu shthihej se i përuiej Sulltanit për t'i shpëtar rrezikut që e kërcënonte dhe për të plotësuar qëllimin e tij, që e mbante të ishehu (I, 60).

5) Për shtytje, për nxitje.

6) Barleti përdor shpesh shprehjen abstrakte në vënd të shprehjes konkrete. Brishtësia = të dhënët lehtë, të mosduruarit.

lin pa gjë, atëherë s'mbetet veç se vdekja më Mizore apo skllavëria edhe më e keqe dhe që shpresë për të nesërmën fluturon e rastis, që të shket një herë nga duart, s'kthehet më kurrë prapë. Kjo punë niset një herë e mirë e, në mos vaftë mbarë, mundësia<sup>1)</sup> qduket përgjithmonë. Prandaj unë, po jua them sheshit, nuk e shikonja as vehten time si një pjesëtar të sigurtë në këtë plan.<sup>2)</sup> Kisha frikë se mos gjuha, që s'i durohej para një pune kaqë të madhe, se mos muret e shtëpisë më tradhëtonin. Për dëshmitar kam Hamzanë, nippin, që u bë pastaj<sup>3)</sup> përkrahësi kryesor i planit dhe shoku i mundit, si edhe disa të tjerë fare të pakë, me ndihmën besnikë dhe të papërtuar të të cilëvet jemi duke e kryer këtë punë. Dhe, sa do që neve na qëlloi të jetonim bashkë, të ushqeheshim dhe sidomos të kishim një shpirt e një zemër, me gjithëkëtë asnjë nga këta s'më mori vesh që unë s'e kisha harruar atdhenë, veçse në luftën hungarezë<sup>4)</sup>, asnjë s'më dëgjoi zérin, të flisnja, veç se atëherë, kur e pati mundësinë pa frikë ndëshkimi.<sup>5)</sup>

Ju, shqiptarë, mund të gjenit një tjetër mbrojtës të lirisë, një tjetër përkryes të qëllimevet dhe të aspiratavet tua ja, sepse, në këtë vënd, s'kanë munguar mëndjet e ndritura; po Juve ju pëlqeu me gjithëkëtë... që këtë liri ta prisnit më mirë nga unë, qoftë edhe vonë, se sa nga të tjerë, apo ta fitonit vetë me dorën tuaj. Ju, si burra aqë të fortë, të rritur në liri, që qëndruat kaqë kohë nën mynxyrën barbare, nuk u mërzitët derisa të më shihnit. Por përsë doni që unë të mbaj për vehte me të padrejtë emrin e clirimtarit? Lirinë nuk e solla por e gjeta unë këtu. Sapo më shkeli këmba truallin tuaj, apo dëgjuat emrin tim, m'u derdhët me vrap të gjithë, më duallët përpëra kush e kush më parë, sikur të kishit dëgjuar se u ngritën nga varret etrit, vëllezërit, bijtë tuaj... Ju më latë prapa, ju m'i lidhët menjëherë duart, ju më mbytët me shërbime aqë të mëdha dhe me një gaz shpirtror aqë të madh, sa që duket se ju më kini bërë tanë aqë rob, sa edhe

1) Kuptohet: «për ta nisur prapë».

2) Me këtë Barleti theksion rrezikun e madh të Skënderbeut nga Sulltani i pabesë, por dhe urtësinë e madhe të tij.

3) D.m.th., pasi Skënderbeu ia rrëfeu planin dhe e mori me vëhte pas betejës së Nishit etj. (I, 66-67).

4) Lufta e Nishit më 3 nëntor 1443, në të cilën Huniadi, kryetrimi i hungarezëvet, theu e dërmoi turqit.

5) D.m.th. pas kërdisë në Nish.

të lirë.<sup>4)</sup> Mbretërinë dhe këtë qytet nuk jua dhashë unë, po ju ma dorëzuat mua. Armët nuk jau solla unë, por ju gjeta të armatosur. Lirinë e pashë se e kini kudo, të pashoq, të lënë nga baba im, e vutë përsëri në vënd, me kujdes e besnikëri të pandryshuar, skeptrin,<sup>5)</sup> që ma ruajtët gjer në këtë ditë, dhe më bëtë përsëri, me mundin e punën tuaj të pa-përtuar, zot të mbretërisë së të parëvet të mij, pa derdhur gjak. Përpara tani, për të shtënë në dorë edhe çka mbetet. Pjesën më të madhe të punës e kemi mbaruar. Kruja është fituar, krahina e gjithë është jona, Dibra dhe pastaj popullsitë e tjera janë bashkuar me ne dhe emri i armiqvet është çdakur nga fushat; mbeten qytetet. Po të mendoj gjëndjen e tyre të vështirë, duke parë se të gjitha janë të rrrethuara nga ne, të zëna në befasi, se të rrrethuarvet u kanë mbetur vetëm muret e çveshura, kam shpresat e mira. Po të marr parasysh vështirësitë që paraqitin këto vënde dhe trupat që janë vendosur brënda nga Tirani, duket se do të jetë nevoja të përdorim ndonjë zgjuarsi apo këmbëngulje shumë të madhe. Por këto do t'i gjykojmë më mirë, kur të ndodhemi në vënd e të kemi përpara armikun e kur të mbajmë shpatën në këtë të djathën tonë shkrumbonjëse, se sa tani për së largu e në tym. Të nisemi, pra, pa ngurim dhe kudo të tregchemi me guxim prej fitimtarësh. Megjithëkëtë, duhet t'ia nisim para së gjithash nga Petrela, jo sepse kjo kështjellë mbetet prapa të tjeravet për nga vështirësia e pozitës apo nga mbrojtja natyrale, por sepse është më afër këtij qyteti<sup>6)</sup> Unë besoj se ne do ta gjejmë atje emrin dhe frikën e fatit të Krujës<sup>7)</sup> më të madhe, sepse ata<sup>8)</sup> i panë me sy edhe trimëritë tuaja, edhe fatkeqësitë e veta. Këto do të mund t'u kallin atyre një frikë ndoshta jo të vogël e, në mos ua kallshin tamam këtë, atëherë do të veprojë sigurisht këmbëngulja jonë. Një gjë vetëm duhet të na ngulet mirë në kokë dhe të mos na dalë asnjerit nga mëndja: në mos u pushtoftë si qytet e

1) Këtu shprehet roli primar i popullit në veprën e Skënderbeut, baza popullore e luftës çlirimtare në udhëheqjen e tij.

2) D.m.th. ma dhatë mua, si trashëgimtar legitim, sundimin, mbretërinë.

3) Krujës.

4) D.m.th. frikën e turqve nga fitimi i Krujës.

5) D.m.th. rojet turke të Petrelës.

në mos qofshim të zotët t'i plotësojmë dëshirat tona, atëherë s'kemi sepse të kthehem i prapë në shtëpi. Ne na duhet të provojmë çdo mjet, mundin, durimin, shpatën, arin dhe argjëdinin, me qëllim që fitores sonë t'ia fillojmë që këndej. Në qoftë se do të ndodhë që ne të marrim qytetin me forcë, atëherë nuk duhet të ketë vënd nga ana jonë për asnjë mëshirë kundër kokëfortëvet, por t'ia arrijmë fitores qoftë edhe me mënyrën më të pazakontë, me qëllim që t'ua thyejmë guximin të tjerëvet. Në qoftë se do të na jepet mundësia që ta shtiem atë në dorë pa derdhur gjak, duke na e dorëzuar vetë vëndasit,<sup>9)</sup> atëherë do të na duhet që të gjithëve të veprojmë me urtësi të madhe si publikisht ashtu dhe privatish, me qëllim që të nxitim kështu edhe të tjerët për dorëzim». (I,72-74).

Ky fjalim i Skënderbeut gjeti aprovim të plotë nga masa e ushtarëvet, nga bijtë e popullit. Barleti thotë tekstualisht kështu: -Nga kjo fjalë ushtëria e mori mirë vesh dhe e lavdëroi fort urtësinë e Skënderbeut dhe nuk i bëri ndonjë ndryshim, as e priti me zemër të thyer planin e tij». (I,74).

Me këto fjalë Barleti na tregon qartë se vepra e madhërishe e Skënderbeut e ka bazën e fuqisë dhe të madhërisë së saj në popull, se ajo mbështetet në popull. Pa këto baza, Skënderbeu nuk do të ishte ai që është, sepse historinë e bëjnë popujt, të udhëhequr nga bijtë më të mirë të tyre. Populli, i përfaqësuar këtu nga ushtëria, duke aprovuar me zemër jo të thyer planin e Skënderbeut dhe duke lavdëruar fort urtësinë e tij, tregon kështu urtësinë dhe mënçurinë e vet. Kjo në fund të fundit do të thotë se Skënderbeu përfaqëson në formën më të përsosur urtësinë dhe mënçurinë popullore, mëndjen dhe zemrën e popullit, shpirtin e tij, siç e thamë më lart, ai është «një simbol i vetë popullit», një «yll i ndritur e i bukur i Arbërisë», siç e thotë gjetkë Barleti (X, 395), prandaj edhe një udhëheqës e strateg i madh e i pashoq.

## II

### FJALIMI I SKËNDERBEUT PARA SFETIGRADIT

Kështjella e Petrelës, drejt së cilës u nis ushtëria me Skënderbeun në krye dhe me kapedanët e tjerë pas (I,72), u dorëzua pa luftë menjëherë apo arritën atje forcat shqiptare (I,76).

1) D.m.th. nga banorët vëndas, shqiptarë, të Petrelës.

Po kështu u dorëzuan pa luftë edhe dy qytete të tjera, kësh-tjella me rëndësi në Mat, **Petalba<sup>1)</sup>** dhe **Stellushi<sup>2)</sup>** (po aty). Pas kësaj Skënderbeu shkoi në Dibër për të çliruar qytetin e Sfetigradit, por ky qytet nuk ndoqi shëmbëllin e të tjerëvet, ai nuk u dorëzua menjëherë (I,77-80). Çështja, sipas zakonit që kish populli dhe ushteria e tij, u shtrua për diskutim. U çfaqën tre mendime: një palë thonin se rrëthimi duhej lënë e shtyrë për në pranverë, për shkak të dimrit, një palë mendo-nin të kundërtën, se duhej filluar menjëherë nga sulmi e çli-ruar me cdo kusht qyteti. Më në fund mendimi i tretë, i çfa-qur nga Moisiu, thoshte që rrëthimi të mos ndërpritej, por edhe sulmi të mos ndërmerrëj, që qyteti të mbahej i rrëthuar me një pjesë të forcavet, kurse sulmi të lihej për më vonë, për në pranverë; ndryshe, humbjet shqiptare do të ishin të më-dha dhe të papërligjura. Me këtë mendim u radhit edhe Skën-derbeu, duke e gjykuar si më të maturin, më të urtin e më të dobishmin. Kështu Skënderbeu vendosi që të qëndrojë në Sfetigrad për të vazhduar rrëthimin Moisiu me një pjesë të ushtërisë, kurse pjesën tjetër e lroi për t'u mbledhur përsëri në pranverë. Me këtë rast ai, para se ta lironë ushtërinë, i mban asaj këtë fjalë, me të cilën i shpjegon arësyet që e ded-yrojnë të veprojë kështu, e përgëzon për trimërinë dhe durimin e saj dhe e falënderon për shërbimet e mëdha ndaj tij, me ndjenjën e një krenarie të ligjëshme kombëtare në zemër dhe me shpresën e sigurtë për fitore edhe më të mëdha në të ardhëshmen.

Barleti na thotë se gjatë diskutimit të çështjes së Sfetigra-dit, u çfaqën gjithash tu mendime të ndryshme «edhe për gjithë gjëndjen dhe mënyrën e luftës». (I,81). Prandaj në këtë fjalë të Skënderbeut shprehet edhe ndonjë mendim nga ata, që përbëjnë bazën e takikës së tij dhe që do t'i zhvillojë e plotëso-jë më mirë më tutje.

Çlrimi i Petrelës, i Petralbës, i Stellushit, dhe rrëthimi i Sfetigradit bëhet në një kohë të shkurtër, të vështirë dhe me shpejtësi të madhe. Barleti gjen këtu rastin të vërë në dukje, me atë zjarrin e dashurisë së tij për atdhe në zemër, fuqinë e madhe, trupore dhe shpirtërore, të kryetrimit dhe të ushtarëvet të tij. «Kështu është për t'u lavdëruar, thotë ai, «Sa durimi jo i pavënd dhe forca e paepur e trupit, aqë edhe fuqia e pamposh-

tur e shpirtit të tij, që i bënte ballë cdo gjëje me shpejtësi- (I, 76). Dhe më poshtë: «Dëbora kishte mbuluar kudo gjithë çhenë; fytyrat e njerëzvet ishin tharë nga të ftohtit, duart u ishin bërë akull dhe trupi u kishte ngrirë e u ishte bërë si kall-kan. Megjithë këtë asnjjeriu, përvëç rojes, nuk i lejoi që të hynin nëpër shtëpitë apo brënda murevet<sup>1)</sup> dhe as vetë nuk desh të hynte, për t'i bërë të tjerët, me shëmbëllën e vet, që t'i zinte turpi» (Po aty). Duke vazhduar admirimin e tij ndai kryetrimit, Barleti e konsideron fuqinë trupore të Skënderbeut si një shumë të madhe e të pazakontë, që habit njerëzinë; ai thotë tekstualisht kështu: «Por unë nuk e gjej të udhës të lë pa e zënë në gojë edhe një gjë tjetër, shumë më të madhe, që thonë për të; që nga dita e parë që erdh në Shqipëri e gjersa çli-roi mbretërinë mezi i bënte dy orë gjumë cdo natë, mrekulli kjo veçanërisht e një trupi *hyjnor* dhe e një trimërie të pa-shterur». (Po aty). Me këtë fuqi Skënderbeu «luftonte gjith-monë krahë çveshur dhe s'donte t'ia dinte as nga të ftohtit, as nga të nxehjtët, duke e bërë këtë punë me një guxim të atillë, që brezat e ardhëshëm do të çuditën më fort se do të besojnë». (Po aty).

Një fuqi të tillë, që Barleti e ngre në kulmin më të lartë për kryetrimin, kanë edhe ushtarët. Për këtë fuqi, për këtë trimëri e durim të tyre, që s'e përkuli kokën gjersa e plotësoi dëshirën që i vlonë me kohë në zemër» (I,81), i përgëzon, siç thamë, dhe i lavdëron Skënderbeu, me gjëzim e krenari në zemër, ushtarët trima të tij.

«Nuk e di, o ushtarë,—foli Skënderbeu—përse t'ju përgëzoj më parë, për trimërinë që treguat... Kështu, unë i kam tanë shë-njat shumë të mira për shkëlqimin e ardhëshëm të Shqipërisë dhe të dinjitetit tuaj. A nuk e shoh unë që tanë të mposhtë cdo gjë me durimin tuaj? Kjo është dita e tridhjetë që kurse unë, me dyshim në zemër e pothuaj i harruar nga mërgimi aqë i gjatë, shkela me këmbë të mbarë në truallin, në atdheun e pushtuar nga barbari. Sot, me përjashtim të Sfetigradit, atij, siç thonë, nuk i ndihet as emri, as era në vëndin tonë... Pastaj s'ka si ti hahet e drejta e të lihet pa u lavdëruar du-rimi juaj, që s'desh t'ia dinte as nga kërcënimet e qillit, as nga koha e keqe e dimrit, as nga gjithë ato vështirësi që i du-allë përpara, që s'e përkuli kokën gjersa e plotësoi dëshirën që i vlonë me kohë në zemër, ashtu siç e pat menduar. Tani

1) Guri i Bardhë, siç e thotë populli, në Mat.

2) Qytet në Qaf-Murrë, në Mat, ndoshta «Kalaja e Skënderbeut».

1) D.m.th. të Petrelës.

unë i përgëzoj të dy palët pér vullnetin e tyre, edhe ata që mendojnë se sitorja<sup>1)</sup> duhet vazhduar, edhe ata që mendojnë se ajo duhet shtyrë pér më vonë. Dhe me të vërtetë, burrin trim nuk duhet ta ndalë asgjë, trimëria e ka zakon të hapë rrugë, siç i thonë një fjale, pér mes ujit, pér mes zjarrit, pér mes gjithë shtigjetet të pakalueshëm. Megjithëkëtë, në qoftëse kjo shtyrje s'ka pér të na sjellë asnë dëm, mund të mendoni, pa u fyer, se edhe ju njerëz jeni. Prandaj shkonit të lumtur dhe ripërtëritni duart fitimtare e, ç'ka peshon më tepër, zemrat tuaja, që të ktheheni pastaj më të patundur pér vepra të reja në një stinë më të ëmbël të vitit. Atëherë ju jap fjalën të gjithëvet se do t'i kini pa kursim armët, mundimet, rastet e luftës së paprerë,<sup>2)</sup> shpërbilimet që kini merituar qysh tani. Por, në qoftë se Tirani<sup>3)</sup> do të vendosë kundër nesh luftën, siç ma merr më tepër mendja mua, atëherë do të na duhet gë planet tona t'i përshtatim sipas gjendjes dhe vetë planevet të armiqvet. Por sidoqë të veprojmë pér të tjerat, sulmin e parë duhet ta bëjmë e t'i rrëmbejmë armët së pari kundër Sfetigradit. Dhe me të drejtë më vjen turp e rendë që armiku s'i ka çkulur ende këmbët që andej, duke poshtëuar kështu shumë keq emrin shqiptar. Por ne na u desh t'i bënim tani udhë kohës, me qëllim që të mos largoheshin të thyer më me turp e që armiku, të mos mësohej pak nga pak t'i përbuzte përpjekjet tona, po qe se neve, duke u orvatur që ta thyenim qëndresën Sfetigradase me një qëndresë më të madhe, do të na shkonte puna kot, sepse nuk do të na duhej të luftonim vetëm kundër burravet, por edhe kundër vetë qillit.<sup>4)</sup> Unë e di se disa komendantëve të lashtë ua kanë quajtur gabim që, pér shkak të paurtësisë dhe paditurisë në punët e luftës, kanë humbur ushtëri shumë të zonjat më tepër nga rrëthanat e vështira se sa nga shpata e kundërshtarit. Unë, në ka ndo-

një gjë, o ushtarë, pér të cilën s'kam fjalë të mjaftueshme që t'ju falënderoj ashtu siç e meritoni, kjo, e them hapur, eshtë në radhë të parë që ju më kini bërë të shoh përsëri gjithë këta filiza të ndritur niprish, gjithë këta kapedanë fort të dashur e të pathyeshëm. Me kapedanë të tillë, me përkrahës të tillë, njeriu eshtë i sigurt pér gjërat më të mëdha. Këta do të japid rast, do të japid shkas që t'ju shpreh dikur edhe Juve falenderimet e mia gjithashtu më të mëdha. Tani, në ka diçka që varet nga unë e që ka të bëjë me nderin e shkëlqimin tuaj, thojeni hapur, çfaqini pa ndrojtje dëshirat tua. Unë ju jam shumë mirënjosë pér shërbimet fort të mëdha kundrejt meje, prandaj nga unë s'ka pér t'ju munguar kurrë gjë.. (I, 81-82).

### III

#### FJALIMI I SKËNDERBEUT NË KUVENDIN E LEZHËS

Ky fjalim mbahet në Kuvendin historik të Lezhës, që u zhvillua në fillim të Marsit 1444.

Skënderbeu, pasi la Sfetigradin, u kthye në Krujë. Ai vazhdoi zgjerimin e mbretërisë, duke çiruar edhe Mokrën, «banorët» e së cilës, thotë Barleti, «i shkonin pas edhe pa grishur kush» (I, 89). Skënderbeu gjatë kësaj kohe mori të gjitha masat pér të përballuar rrezikun turk, pér të cilin ishte i sigurt, siç u tha ushtarëvet në fjalimin e mëparshëm, se s'do të vononte të vinte. Ai ishte i papërtuar, «shpesh vizitonte Krujën dhe vënde e qytetet e tjera, shkontakte sa këtu atje i papërtuar, këqyrte e vërente çdo gjë me kujdes, male, kodra, pyje, gryka, lugina e çdo skutë, me qëllim që të nxirrite se me ç'mënyrë mund ta bënte dikur luftën kundër një armiku aqë të madh me humbje sa më të vogël të ushtarëvet të vet». (Po aty). Por rreziku parashikohej i madh e i vazhduar, prandaj Skënderbeu mendonte pér një organizim e përqëndrim të të gjitha forcavet shqiptare në një front të vetëm e të bashkuar. Me këtë mendim e pér këtë qëllim ai thirri Kuvendin e Lezhës, ku u mbledhë gjithë princërit shqiptarë (II, 91-94). Asnjeri nuk mungoi në këtë mbledhje, asnjeri nuk nxori ndonjë arësyte të paqenë, ndonjë pengesë zyrtare apo familiare, por «që të gjithë erdhën fluturimthi me gaz të madh në zemër e kush e kush më parë, si të ishin në garë» (II, 94); Dhe kjo, përfundon Barleti, «ishte një shenjë mjaft bindëse se të gjithë do të ndihmonin pér nevojat e luftës».

Në këtë fjalim historik Skënderbeu thekson mbi të

1) D.m.th. sulmi kundër Sfetigradit pér ta çiruar e fituar me luftë.

2) D.m.th. se ushtarët e Skënderbeut digjen nga zjarri pér çirimin e atdheut.

3) Sultan Muratit II. Sulltani në përgjithësi quhet shpesh, Tiran, mbret, barbar, otoman etj.

4) D.m.th. kohës së keqe, borës e shiut etj. Koha në taktilën e Skënderbeut është një konditë vendimtare pér fitoren, prandaj ajo duhet përdorur me urtësi etj.

gjitha nevojat e bashkimit të të gjitha forcavet në një front unik. Ai e konsideron këtë bashkim si kushtin themelor dhe të vetëm që mund të sigurojë fitoren dhe lirinë e paravarësinë e atdheut. Ai ka besim të madh në fuqinë e bashkuar të popullit, në trimërinë e tij, e cila mund të përballojë hordhitë turke sado të mëdha që të janë. Përveç kësaj, Skënderbeu jep këtu një tok këshilla përmënyrën e vepromit dhe shpreh e përcakton parimet themelore të taktilës luftarake të tij, e cila e tregoi strategun më të madh të shëkullit të tij.

«Etër e princër fort të nderuar,

Dhe unë sot sigurisht nuk do ta turbullonja qetësinë e atdheut, si një iniciator,... dhe nuk do t'ju shtynja ju me ngut në këto vështirësi dhe rreziqe të luftës përis interesat e larëta, sikur Gjon Kastrioti, baba im i dëgjuar e nga ana tjeter një princ shumë i urtë, të mos i kish zënë aqë fort besë dikur këtij Murati të pabesë, kur, nën pretekstin e paqës,<sup>1)</sup> arriti t'ia merrte rob e peng përsiguri të bijtë menjëherë sa po i kërkoi. Por ç'të qahem më tej për princi tim? Ky është një gabim i përgjithshëm.... Ç'të them përfuqinë e grekërvet, të misëvet dhe pastaj të princërvet të tjerë...? Të gjithë këta s'ka dyshim që i çduku një besim i tillë i tepëruar dhe tani s'u ka mbetur asgjë nga Otomani i pabesë veç se mundësia për t'u penduar. Prandaj nuk mbetet asgjë, o etër të këtij Kuvendi, që të mos t'ju them ju në këtë pjesë të fjalës sime, sepse ju duhet t'i kini nxierë fort mirë mësimet nga fatkeqësia e të tjerëvet. Megjithëkëtë, një gjë është për t'u thënë, se kur unë tani, që po ankohem kështu, sjell ndërmënd më me kujdes dhelpërítë otomane dhe i përfytyroj si t'i kem para syvet e kur vështroj, një gjë më jep zemër e më detyron të kem shpresë, se zor të gjej ndonjë popull, që të jetë përmbysur prej tij me mënyra të tjera veçse me dhelpëria e me kurthe, ose me anë të besimit të tepëruar dhe të grindjevet të bërë dëshme.

«Por ja», do të thoshte kush, «Otomani shumë gjëra i ka shtënë në dorë edhe me trimëri; krahina të panumura dhe mbretëria të shuma i ka vënë në zgjedhë në ditët tona me anë të armëvet», — do të numëronte fitoret e pambaruara të tij: «Hyri krenar në Azi, i ra jo një herë anembanë Greqisë dhe pa derdhur pikën e gjakut u fut kaqë herë në

Misi».<sup>1)</sup> — Pra, mos kujtojmë vallë se ai e paska aqë të lehtë të godasë Arbérinë e pamposhtur dhe Shqipérinë e pathyeshëm? Arbérinë, Shqipérinë, ku gjithë këta kapelanë, gjithë këta princër të pathyeshëm, gjithë këta popuj fort luftarakë janë në vlug të fuqisë me armë në dorë e të bashkuar! Dhe me të vërtetë, se sa e çmojnë barbarët dhe se sa e llogarisin trimërinë tuaj, për këtë dëshminë më të sigurtë mund ta kini nga unë, që kam kaluar shumë vjet me ta në paqë e në luftë: «Me pahir e me përdhunë i bidden nevojës për të luftuar kundër jush». Se ç'gjë të mirë veç dhe të madhe mund të bëjë një njeri me pahir e me frikë në zemër, këtë le të ma thotë mua ushtari trim më i mirë.

Por, ndërsa dëshira ime për të folur dhe arësyja e një pikëllimi të përligjur po më shtyjnë që të zgjatem, unë po e them hapur se do të ketë... nga ata që janë mësuar prej një kohe kaqë të gjatë me një paqë, megjithëse jo krejt të pandershme, dhe prandaj mund të hidhërohen nga që unë i ftoj tani për këto lufta të vështira dhe mund të thonë se, sidiqë të marrë puna... asgjë s'mund të kryhet pa gjakun e tyre. E, ndoshta... do të më quajnë gjakatar, gjë që tmerohem kur e mendoj... megjithëqë do të duhej të më quanin më drejt, se them përmbrorrje, **mbrojtës e shpëtimtar të lirisë**.

Larg meje, një akuzë e tillë! Se zor t'ia arrinja me fjalë një mbrojtjeje legjitime dhe të drejtë; por unë nuk e meritoj atë. Unë s'e kam harruar gjer n'atë shkallë të mirën e përbashkët, sa që të ma duronte zëmra vetëm mua të dëgjonja kudo pshëritimat tuaja, të shihja kudo zinë e përbashkët. Përkundrazi, në se dikush s'është i kënaqur, o etër senatorë, nga plani im, dhe nëse rasti i paraqitur nga unë përt'ia filluar luftës nuk duket në të mirë të nderit të Shtetit dhe të të gjithëvet, unë përsë shpejti kam për t'ia kthyer Muratit, në rast se ju e shikoni më të udhës kështu, edhe Krujën, edhe gjithë ç'ka mbetur nga mbretëria... dhe do të kujdesem më tepër që të marr masat përsigurimin tim duke u rrezikuar vetë, se sa që të mbretëroj duke rrezikuar gjithë të tjerët. Vetëm për një gjë më vjen keq, përfatim e popullit... dhe përgjakun e pafajshëm të qytetarëvet; s'ma duron zemra që ata të mbeten pa krye, pa mbrojtës, dhe t'i shkojnë armikut si kurban për t'u therur e unë të harroj besën që ata treguan para pak kohe kundrejt meje dhe që s'e kanë

1) Ndoshfa më 1430.

shkelur kurrë. Por pse të veproja kështu, që të flas më lirisht me ju? Mos do të ishte, pra, më e drejtë që bashkëqytetari juaj të qëndronte përgjithëmonë i mërguar larg atdheut, në skllavëri pranë Muratit në mes gjithë atyre rreziqeve,... apo mos do t'i duhej më mirë ta ngryste jetën në Shqipëri, në truallin ku lindi.... pranë jush? Veç kësaj, a mund të qëndronte vallë si në Shqipëri dhe të shikonte të përlyhen e të poshtërohen edhe më gjatë atdheu i stërgjyshërvet, mbretëria atërore, varret, tempujt, nën sundimin e barbarëvet? Më në fund, c'mendoni pér Krujën? A mos vallë një qytet kaqë i fortifikuar, kaqë i përmendur pér mjetet dhe fuqinë e tij, ka qenë pér t'u lënë në duar të armikut, sikur të mos kishim pikë dashurie pér atdhe? Kruja, zëmra e fuqisë së Arbërit dhe e vëtmja që është ndërtuar nga të parët tanë me të gjitha avantazhet si pér luftë e pér paqë. Këtë sigurisht, në rast se unë s'ia bëj tepër qefin vehtes, zor që mund ta mohoni, o etër fort të nderuar.

Por do të thoshte kush se mund të veprohej më me butësi me Muratin, se nuk duhej ngacmuar aqë fort barbari, se qoftë edhe atdheu nuk duhej rifituar me tërë ato krimë. Por, në se kjo<sup>1)</sup> duhet quajtur më tepër krim se sa një **mbrojtje e nevojëshme e jetës**, që i është lejuar jo vetëm njeriut në bazë të së drejtës njerëzore, por edhe shtazëvet, që s'gjykojnë, në bazë të vetë ligjit të natyrës, gjykojeni vetë. Me gjithë këtë, në e marrshim pér krim, atëhere çdo të mund të thuhej pér tërë atë urrejtje të tij, pér tërë atë armiqësi kundrejt meje? Çdo të mund të thuhej pér ato kurthe të tij që muarrë dhenë dhe që i dini jo vetëm ju, por gjithë bota pothuaj, që edhe armikun më gjakatar do ta kishin bërë të qante me lot? C'mund të thuhej më në fund pér vrasjen mizore të vëllezërvet të mij, të cilët i pashë vetë atje me sytë e mij të prishen dhe pothuaj në të njejtën kohë të gjegjë në vdekjen më të zezë? Mos është pastaj e vogël kjo, që unë kam duruar të shikoj gjer në këtë ditë duart e lyera me gjakun e të mivet e që kam kaluar gati gjithë vitet e moshës më të ëmbël me një rrezik aqë të sigurtë pér jetën, pranë vrasësit të urryer? Zëmra ime e di. Por pse zgjatem me këto? Vetë përfundimi i luftës, si një gjykatesh i drejtë, do ta tregojë pér së shpejti në është bërë çdo gjë mirë apo keq. Vetëm pér një gjë do të guxonja unë t'ju zotohem juve të gjithëve, se në të gjitha punët e mundimshme, që do të na

1) D.m.th. rifitimi (çlirim) i atdheut, mbrojtja e tij dhe e lirisë.

duhet t'ua hyjmë, në të gjitha rreziqet, që do të jetë nevoja t'ua bëjmë ballë, mua do të më kini ushtar apo kapelan me durim të pathyer. Çështjes suaj... unë s'kam pér t'i munguar as ditë, as natë, asnjëherë dhe, sadoqë me këtë dëshirë të shpirtit tim s'mund të matet trimëria dhe lavdia e veprave që duhen bërë, me siguri që me të do të maten kujdesi dhe besimi edhe do t'ia kalojnë.<sup>2)</sup> Por, sidoqë të ndodhë në këtë mes, ne të pakën s'kemi pér t'u penduar pér qëllimin tonë, se pse unë, gjatë gjithë asaj kohe që jetova bashkë me armikun, ia mësova dhe ia di shumë mirë lëkurën, dhelpëritë, mashtimet e gjithë zakonet me radhë, gjë që konsiderohet zakonisht shumë e rëndësishme në punët e luftës. Kështu unë s'kam pér të ndërmarrë asgjë pa i bërë sytë katër, kota pa e menduar thellë.

Por pse po ju përmënd këto gjëra që s'peshojnë fort, kur juve ju janë siguruar gjithë mjetet më të mëdha, madje shumë të mbëdhë ta kësaj lufte? Do të kini me vete senatin dhe popullin e Venedikut, më të fuqishmin sot në det e në tokë...<sup>2)</sup> O princër arbërorë, ju lutem, c'mund të kërkoni më te-për?... Të na vijë turp, turp pér fatin tonë. Të zezat që po vuajmë më detyrojnë që të flas kështu, por është turp pér ne, shumë turp pér Venedikun, që ne të durojmë edhe më gjatë si sundimtarë ata, të cilët, në kohën e etërvet tanë, ai fshat i përbuzur i Skythisë, me zor mund t'i mbante pér sklllevër. S'ka gjë më të ulët se ata: të mësuar të jetojnë vetëm me hajdutëri e me të rrëmbyer, janë rritur aqë shumë sot... duke e vënë në një rrezik të madh. Por s'do të më mjaftonte dita, po të donja t'ju numëroj të gjitha. Më vjen turp që t'ju flas pér poshtërinë e armikut, me të cilin ju duhet të luftoni.

Ejani, pra, kryetrima, merrni hakun, **mbron me lavdinë më të madhe atdhenë, gratë, fëmijët dhe të mirat tuaja, siluni atyre qetësinë e vërtetë të lirisë**. A e ndjeni se në ç'turp

1) Barleti flet këtu me figurë nga ndeshjet në vrap. Kuptimi është se trimëria mbështetet më tepër në kujdesin dhe besimin pér të fituar se sa në dëshirat.

2) Barleti i thur këtu lavde të tepëruara Venedikut. Me këtë Barleti do të thotë se lufta e Skënderbeut është në dobi edhe të vetë Venedikut. E vërteta është se Venediku nuk e përkrahu Skënderbeun në luftën e drejtë të tij. Siç thotë Marks, «forcimi i pushtetit të Skënderbeut në Shqipëri ishte një halë në sy përmendikun».



po jetoni? Se cili mund tē jetē fundi pēr lirinē dhe pēr ju? Në qoftë se, megjithëkëtë, ju duket e durueshme gjëndja Juaj, atëhere me shumë tē drejtë duhet t'i rrroknë armët pēr mua... jo si pēr një bir princi, jo si pēr një tē gjakut tuaj, por si pēr një tē ikur.<sup>1)</sup> Unë nuk flas, o princër, me njerës që i mohojnë luftat e drejta. Mbrojeni atë që Gjon Kastrioti, ai princ i dëgjuar që Juve s'ju ka shërbyer keq, do t'i ainte, po tē mundte, amanet besën dhe trimërisë suaj. Por, në qoftëse nuk ju trondit akoma edhe fati im dhe ju pëlqen më mirë paqa e turpëshme se sa kjo luftë, atëhere unë mund tē shkoj tek njerëzit, tek populli dhe qytetarët e mij besnikë, tē cilët me aqë bujari e gatishmëri ia kanë kushtuar jetën e tyre shpëtimit tim, pēr t'i shtruar së bashku me ta me zemër tē qetë çfarëdo fati, që do tē jetë thënë pēr ne.

Por jo, o etër tē kuvendit, edhe ju, siç kujtoj unë, kini pēr t'i dilni zot, ju them, mbrojtjes edhe pa dashur, kur tē dëgjoni se atdheu, i shtypur prej Muratit, po kërkon ndihmën tuaj, kur tē shikoni se armiku, i pafre dhe tërë kapardi pēr fitoren, po çduk lirinë dhe sundimin tuaj dhe i têrbuar, me gojën e vet tē gjakosur e me duart e ndyra e sakrilege, po turret pēr ta pirë gjer në pikën e fundit gjakun tuaj. Mos prisni veç, ju lutem, atë gjëndje tē vështirë, mos prisni gjersa tē jetë ndoshta vonë pēr t'ju kërkuar juve këtë ndihmë por tani t'i bashkojmë forcat dhe armët tonë dhe kështu ta presim armikun, që do tē vërsulet shumë shpejt, ose t'i vërsulemi vetë. Dhe, kur tē na shikojtë bashkuar, ai ose do, tē pëndohet pēr planin e vet ose, po vazhdoi tē bëjë këmbë përpara, do tē heqë dorë nga lakmia e vajtuar pēr tē dalur fitonjës me kërdinë që do tē pësojë.

Ndonjeri, ndoshta, nga ju ka pastaj frikë dhe kolovitet nga dyshimi se Murati nuk do tē dérgojë kundër nesh një ushtëri tē vetme e tē dobët, por më tepër e shumë tē fuqishme, se, ndoshta, do tē vijë edhe vetë, me qëllim që tē shpaguhet pēr këtë goditje tē tmeruar, kurse ushtëria jonë s'barazohet me forcat e tij. Këto tē gjitha unë i pranoj, sigurisht,

dhe i pranoj me kënaqësi,<sup>1)</sup> por nga ana tjeter mue ma parandjen zëmra se çdo gjë do tē jetë e lavdishme; megjithëkëtë unë ruhem t'u zotohem diçka njerëzvet që dyshojnë; sepse e ardhmja nuk duket sheshit dhe çdo përfundim i asaj qëndron i fshehur. Pēr sa i përket veç mendjes dhe gjykimit njerëzor, unë mund ta tregoj se ato janë një mjet i sigurtë pēr tē gjitha punët, sepse asgjë s'është aqë e vështirë, sa që tē mos mund tē zgjidhet nga mëndja e njeriut.<sup>2)</sup> Natyra është e zonja pēr ta mbrojtur vehten e vet dhe çdo gjë që bëhet drejt, ka zakonisht përfundime fatbardhe.<sup>3)</sup>

Por përsë po e vështirësoj çështjen me këtë mënyrë? A mos vallë, që tē hesht pēr armët, vetë pozita e vëndit dhe territori i Shqipërisë, prej natyre shumë i mbrojtur, mbi të cilin s'ka gjë më tē aftë, më tē përshtatur pēr tē prapsur çdo dhunë, nuk do t'ju ruajë juve nga gjithë sulmet? Mos vallë pastaj, çdo vënd një pēr një e çdo qytet nuk do tē mund tē forcohen, para se tē arrijë armiku, me burra, me armë, me ushqime? Mos vallë më në fund unë vetë bashkë me ushtërinë, që do tē më kini besuar ju, mund ta lë vëndin tē ekspozuar në shkretim, i mbyllur brënda murevet tē shtëpisë, dhe tē vështroj nga ndonjë vënd i sigurtë e nga ndonjë pirlg i lartë, si i svetruar, bashkë me djemtë tuaj, viset tuaja, tē plaçkiten e tē digjen dhe dëme tē tjera tē përbashkëta tē kësaj fare? Me siguri që nuk do tē ma durojë zëmra një poshtëri tē tillë. Armikut do t'i qëndroj, bashkë me forcat, me ushtarët e mij, gjithmonë përpara dhe sulmet e tij do t'i provoj, sadoqë jo me beteja tē rregullta e me kundërshtim tē hapur, gjer në fund. Me një takтикë tjetë<sup>4)</sup> më tē dobishme luftarake dhe me legionet e mia ndoshta tē pagjakosura, unë do t'i thyej aqë keq fuqitë dhe hundët Muratit, sa që t'i lerë pastaj tē gjitha, duke i shkuar, si i thonë një fjale, harxhet kot, dhe t'u mbetet tërë plaçka juve, në rast se nuk do t'i pëlqeje që ta plakë<sup>5)</sup> ushtërinë e vet në një truall armik e në fusha tē huaja dhe, në mes vështirësish shumë tē mëdha nga çdo pikëpamje, t'i ngjasë më fortë një tē rrëthuari se sa

1) Skënderbeu kënaqet, sepse shokët e tij mendojnë kështu gjithë rrëthanat.

2) Verë re këtë mendim tē Barletit, që tregon besimin në forcat e njeriut, në fuqinë e mëndjes së tij.

3) Ky mendim është edhe më i përgjithëshëm se i pari. Sot do të thonim: "Njeriu e bën fatin vetë".

4) D.m.th. që s'është e zakonëshme, jo me luftra frontale etj.

5) D.m.th. lufta ime e drejtë.

1) D.m.th. nga Sultani.

një rrëthonjësi. Përkundrazi, juve nuk do t'ju mungojë asgjë, sepse unë do të jem gjithmonë pranë jush, do t'u bëj ballë të gjithave, do t'ia dal të kemi çdo gjë që duhet jo vetëm sa për t'i mbajtur gjallë qytetarët dhe ushtëritë që do të më jenë dorëzuar, por për t'i ushqyer si jo më mirë.

Por përsë vallë po ju mburrem unë juve sot kaqë tepër e nuk i ruaj më mirë këto kërcënime krenare, këto fjalë të forta e këto sulme trimërore pér armikun? Përse gjithashtu po flasim tanë kundër Muratit me zemër të trëmbur? Ne s'kemi pse të trembemi e s'duhet të trëmbemi fare pér ardhjen e tij. Për këtë më kanë njoftuar mirë njerëzit e tij të brëndëshëm,<sup>1)</sup> si në stuhinë që pata para pak kohe pér punët e mia, si edhe para pak ditëve; kaqë fort që m'i ka bërë me kohë pér vehte dhe m'i ka ruajtur kështu gjer më sot edhe zëmrat e barbarrëvet, **mirësia dhe çështja e drejtës**. Megjithëkëtë, fjala që ka marrë dhenë dhe thëniet e të gjithëvet pohojnë se një ushtëri shumë e madhe po gatitet pa rreshtur kundër nesh me energjinë më të madhe që mund të bëhet. Prandaj i duhet dhënë fund çdo vonese, o etër të Kuvendit, duhen lënë mënjanë tanimë këto këshillime tonë, pér të cilat nevojat e luftës s'kanë kohë të presin. Duhet t'i biem anembanë gjithë vendit, duhet të shpallet vendimi, duhen numuruar kokë pér kokë njerëzit, të shkruhen pa humbur kohë ushtarët, me qëllim që të mos i kërkojmë mënyrat e luftës kur të jetë vonë, atëhere, kur ta kemi armikun përrpara dhe kur buçima e borievet pér të thirrur ushtarët të na shurdhojë veshët.

Ngrehuni, pra, o etër të pathyeshëm, tregohuni më në fund të denjë pér sundimin... para gjithë brezavet që do të vinë këtej e tutje. Falënderimet nga unë pér mirësinë e sotme pritini të armatosur, me përkrenare në krye, para flamujvet, në djersë, në pluhur: dhe do t'i kini sipas ndihmavet, që do të jepni pér luftën». (II, 94-99).

Pas këtij fjalimi, që bëri përshtypje të madhe, Skënderbeu zgjidhet kapedan suprem i forcavet të bashkuara shqiptare dhe vihet në krye të luftës legjendare të popullit. Barleti thotë kështu:

«Me ti dhënë fund fjalës Skënderbeu, princërit të gjithë u drejtuani nga ai dhe, duke ia aprovar një goje dhe me zë të qartë mendimin, po lavdëronin fort e po e ngrinin në quell si shpëtimtarin e lirisë dhe të të gjithë lavdisë. Dhe kështu, pasi i lanë atij të gjithë me radhë e me vullnet të lirë dhe ia .

1) Janë miq të Skënderbeut në Oborrin e Sulltanit.

kaluan gati si me dorë pushtetin, popujt, ushtëritë, dhe pasi i besuan drejtimin suprem të të gjithë gjëndjes dhe kujdesin e luftës, e zgjodhën kryetar dhe kapedan të tyre të vetëm. Që të gjithë e quajtën mjaft të zotin pér këtë pushtet, duke e brohoritur e simpatizuar fort, sepse edhe vetëm nga emri i tij, si nga ndonjë rrufe, çdo kënd i Shqipërisë, mund të mbrohej kundër çdo sulmi të armikut. Krahas këtyre, ajo përvoja e tij pér punët e luftës dhe gjithë ato këshilla prej kapedani, njojja pastaj pér një kohë të gjatë e zakonevet dhe e jetës së barbarëvet dhe gjykimi i sigurtë pér të nga shoqëria dhe eksperiencia e gjatë, u ndiznin të gjithëve zëmrat me një shpresë më të madhe dhe më të sigurtë pér fitoren». (II, 99-100).

I pari ndër të gjithë, që i afroi, përvëç forcavet ushtarake, edhe një «tribut të përvitëshëm me gatishmëri bujare... pér hir të lirisë së Shqipërisë» (II, 100), ishte Arianiti. Pas tij «Shumë të tjerë e kush e kush më parë i u zotuan pér ndihma mjaft të mëdha, sipas gjëndjes së tyre». (Po aty). Kështu, përfundon Barleti, u gjet një sasi e madhe të hollash pér nevojat e luftës. Pa një ndihmë të këtillë, thotë Barleti, Skënderbeu e kish vështirë t'i përballonë nevojat e luftës në një kohë, «kur të gjithë pothuaj digjeshin të gjithë në zjarrin e luftës dhe me njerën dorë, që ta them kështu, lëronin arat e me tjatër mbanin shpatën». (II, 100).

Me këtë mënyrë qëllimi kryesor, pér të cilin u mblohdhën krerët shqiptarë në Lezhë me iniciativën e Skënderbeut, «bashkimi i vëndit në luftën kundër Turqisë» u realizua. Ky bashkim në shkallë kombëtare «ndodhte, nga sa dihet, pér të parën herë në Shqipërinë feudale». <sup>2)</sup> Dhe ky bashkim ushtarakopolitik ishte hapi i parë i Skënderbeut në krijimin e një shteti shqiptar të përqëndruar, pér të eliminuar të këqiat që i vinin vëndit nga përcarja dhe copëzimi feudal, i cili s'mund t'i bënte ballë rezikut turk dhe ishte i padëshiruar e nuk gjënte mbështetje në masat popullore. Prandaj Skënderbeu, duke realizuar në Kuvendin e Lezhës bashkimin e krerëvet në një aleancë apo beslidhje si më sipër, gjeti aprovim të plotë e bashkoi në një edhe zëmrat e popullit<sup>3)</sup>. Dhe ky bashkim me zemër i popullit rrëth tij është baza e gjithë suksesevet të tij, që tërësojnë mbrekullinë shqiptare të shekullit XV.

1) Historia e Shqipërisë, vell. I, Tiranë 1959, f. 276.

2) Këtë e pohon Barleti më poshtë, kur Skënderbeu falënderon ushtarët pér gatishmërinë e tyre, duke e cilësuar këtë bashkim e gatishmëri si një «mrekulli të paparë», që s'i ka ndodhur ndonjë princi tjetër «në shek. tonë» (II, 104).

## FJALA E SKËNDERBEUT PARA PËRLESHJES ME ALI PASHËN

Këtë fjalë ua mban Skënderbeu ushtarëvet të tij para përleshjes me Ali Pashën në fushën e Torviollit më 29 Qershor 1444. Është përleshja dhe fitorja e parë e ndritur e Skënderbeut kundër forcavet të Sulltan Muratit II, pas çlirimtë të mbretërisë dhe caktimit të tij si **kapedan i përgjithshëm** i forcavet shqiptare në Kuvendin e Lezhës. Kjo fjalë ka një vlerë të madhe për gjithëçka thuhet në të.

Kuvendi i Lezhës mbaroi dhe gjithë pjesëmarrësit «u shpërndanë secili me gjësim të madh e me shpresë më të madhe pér në vëndet e veta» (II, 101). Kështu edhe Skënderbeu, «pasi të gjithë e kush e kush më parë e bënë pér vehte këtë njeri me gjithëfarë lavdërimesh e nderimesh dhe pasi «u bënë lutje» pér fuqinë e besëlidhjes dhe pér lavdinë e kësaj aleance kaqë të shënuar» (po aty), u kthye me një pjesë nga krerët në Krujë. Atje thirri menjëherë Moisinë, në dorë të të cilit siç thotë Noli,<sup>1)</sup> kishte rënë ndër kohë Sfetigradi. Moisiu solli me vehte edhe një pjesë të ushtërisë. Pastaj dërgoi krerët pér të bërë regjistrimin dhe rekrutimin e ushtarëvet sipas vendimit që mori Kuvendi. Forcat e mbledhura, të vjetra e të reja, që rrrodhë «nga çdo anë» e Shqipërisë (II, 104), ishin të shuma e tërë zjarr pér të mbrojtur lirinë. Barleti thotë kështu: «Kur erdhën, pra, tek ai fluturimthi nga të katër anët gjithë ajo mizëri gjindjesh e popujsh<sup>2)</sup> trima, saqë të mund të bëhej jo vetëm një ushtëri<sup>3)</sup> dhe as sidokudo, dhe ndërsa po qëndronin para tij duke pritur urdhërin e duke kërkuar armë, ai në fillim i lavdëroi të gjithë, pastaj, duke u mjaftuar me ndihmën e më të zgjedhurvet, dha urdhër që të qëndronin vetëm tetë mijë kalorës dhe shtatë mijë këmbësorë, ndërsa të tjerët i dërgoi më shtëpi», (II, 102). Me këtë «ule të Shqipërisë», siç thotë Barleti më poshtë (II, 104), një pjesë të cilës ai e vendosi nëpër fortesa të ndryshme pér t'i mbrojtur nga armiku, ai do t'i bënte ballë Ali Pashës.

Pesha që Skënderbeu mbajti kundër Ali Pashës, i cili po

1) «Historia e Skënderbeut», Tirana 1962, f. 33.

2) Thotë «gjindjesh (= njerëzish) e popujsh», sepse kjo ushtëri përbëhej nga forca të dërguara prej popullisvet të principatavet të ndryshme shqiptare.

3) D.m.th. si ajo e Skënderbeut etj. Ushtëria e Skënderbeut ka genë gjithëmonë jo e madhe në numur.

vinte me «dyzet mijë kalorës» (II, 101), vetëm me një pjesë të ushtrisë së grumbulluar, bëri përshtypje të madhe. «Të gjithë u habitën», thotë Barleti, «me planin kaqë të guximshëm të këtij burri» (II, 102). Barleti, i cili e admiron jo më pak kryetrimin pér guximin e tij, e shpjegon këtë veprim me dy mënyra: e para, sepse ai donte të kishte kështu mënjanë rezerva pér çdo të papritur; e dyta, sepse ai kishte «besim të pashoq dhe gati të admirueshëm» në fitoren, në vetvehte e në ushtrinë e tij, në popullin e tij, besim që e mbushte me një guxim të pamposhtur dhe që e bënte të dilte kurdoherë fitimtar e faqebardhë, siç ndodh zakonisht me njerëzit e mëdhenj... (po aty). Dhe këtu, në këtë besim të tij të madh, qëndron mbi të gjitha shkaku i admirimit që pati Skënderbeu nga e gjithë bota, siç na thotë Barleti: «Për këtë gjë sidomos e lavdërojnë dhe e admirojnë njerëzit Skënderbenë, sepse ai, sa e sa herë dhe thuajse gjithmonë me forca shumë më të vogla pati gjithë ato fitore gati të pabesueshme mbi armikun». (II, 102-103). Për këtë Skënderbeu është edhe një mrekulli e shkullit të vet (Po aty).

Skënderbeu, pra, në krye të kësaj ushtërie «ule të Shqipërisë», shkoi në Dibër, ku po priste Ali Pashën, «gjeneralin më të zotë të Sulltan Muratit II<sup>4)</sup>». Dhe ndërsa po e priste, «e gjeti të udhës», thotë Barleti, «që t'u thoshte dy fjalë, si kapedan i ri, ushtarëvet të tij të rinj». (II, 103).

Në këtë fjalë, në të cilën zotëron atmosfera e gjëzimit pér suksesin e besëlidhjes dhe ngrihet lart vlera e bashkimit të forcavet shqiptare si kusht pér të rikrijuar «gjëndjen e dikurshme të Shqipërisë, nénës së kryetrimavet» (II, 105), Skënderbeu, pasi thekson nevojën e luftës pér të mbrojtur lirinë, nderin, pavarësinë e atdheut, mbrojtja e të cilit është shpërbëimi më i madh pér njerinë, shpreh mbi të gjitha pikërisht besimin e madh që ka në forcat e veta, në popull dhe në ushterinë e tij: «Shpëtimi është vetëm në duart tonë, tjetër shpëtim s'ka», u thotë ai ushtarëvet (II, 104). Ai thekson këtu në mënyrë të veçantë detyrën e lartë ndaj atdheut, i cili duhet mbrojtur me sakrificat më të mëdha, akoma edhe me gjak, sepse «një herë kemi pér të vdekur, por ja të vdesim trimërisht, ja të shpëtojmë besën e lirinë» (po aty). Ai thekson e ngre lart edhe trimërinë e pashoqe shqiptare, që është siguria e çdo fitoreje, sepse «burri trim s'ka përsë t'i trëmbet fatit» dhe sepse «është turp të pranoni ndonjë fat», u thotë ushtarëvet, «që s'është, në dorën dhe në shpatën tuaj»

1) F. Noli, «Hist. e Skënderbeut», Tirana 1962, f. 36.

po aty). Ai, ndër tjera, thekson edhe «vetëdijen e plotë të trimërisë», e cila është arësyeja dhe baza «më e fortë për fitoren» (II, 105), sepse buron nga vetë vetëdija e luftës së drejtë që bën populli shqiptar. Këtu shprehen e shpjegohen edhe një tok ide të larta e parime taktike të Skënderbeut, drejtësinë e të cilavet e vërtetoi «vetë përfundimi», që pati me fitoren e shkëlqyer kundër forcavet shumë më të mëdha të Ali Pashës.

«Do të dëshëronja, o ushtarë, që ju të të më kishit kapedanin tuaj dhe që unë ta gjëzonja këtë pamje kaqë të shkëlqyer të besnikërisë suaj në ditë më fatbardhe për punët e mia dhe në një kohë më të lumtur përmbrëtinë time; dhe të mos ju ftonja sot për këto vështirësi të reja të luftës dhe përvuajtje të tjera të këtij lloji, por t'ju shprehnja tani, si qytetarë, në paqë dhe qetësi, me mirënjojen më të thellë, falënderimet e mia, të cilat kam qenë gati me kohë, si kapedan jo i papërgjakur, t'jua shpreh juve, si ushtarë fort të përgjakur,<sup>1)</sup> për djersën, për rreziqet, për gjakun që kini derdhur kundër armikut. Por meqë në këto rrëthana të ngutëshme... solli që unë të vinja e t'ju tregonja më fort rreziqet që rrinë mbi krye se sa t'ju sillnja qetësinë, atëhere qdo gjë duhet duruar me zëmër të qetë prej trimi dhe duhet marrë mbi shpatulla, sado e madhe që të jetë, pesha e kësaj lufte, që të mund të jetojmë një ditë në paqë dhe qetësi; duhen rrëmbyer armët me kënaqësi dhe pa humbur kohë, me qëllim që, pasi t'i kemi këputur më në fund prangat e një skllavërie kaqë të gjatë dhe ta kemi përzënë armikun nga vatrat tonë, të shkojmë pastaj një jetë më të lumtur e të gjëzojmë për gjithmonë lirinë.

Por ndërsa po ju flas tanë juve dhe s'po ju gjëzohem dot, ndërsa po shikoj se si po juva rrëmbej zëmrat e po mendoj mirësinë e secilit me radhë, mezi po e përbajt vehten e jam fort i ngashëryer, gati sa s'mund t'i mbaj lotët, sepse më vjen ndërmënd ajo kohë shumë e zezë që unë, larg jush, larg syvet tuaj për aqë vjet, kam kaluar në turp e i përbuzur me çdo mënyrë prahë Muratit të pashpirt, sepse rikujtoj robërinë time dhe vajtoj vitet që më shkuam, kur gjykoj nga zjarrri i ndjenjavet tuaja se c'liro e mbretëri do të kisha unë me ju. Tani, tani me të vërtetë i ndjej gjer në fund edhe krimet e barbarit, edhe gjithë vargun e të këqijavet të mia dhe se sa

1) U drejtohet këtu ushtarëvet të vjetër, me të cilët çlroi mbretërinë etj.

të mira paskam humbur unë larg shoqërisë me qytetarët e mij të dashur. Por, nga ana tjetër, kur e përbledh më mirë vehten e kur shikoj këtë pamje të bukur të kësaj ushterie, çdo gjë e duroj, o ushtarë, me qetësi dhe s'më vjen keq më as përfatim tim, as përgjithë ato të zeza që kanë marrë fund, as përskllavërinë time të gjatë, gjersa neve na është paraqitur tanë rasti përgjithë këto trimë dhe për një liri ndoshta të përherëshme, gjersa mua, që të hesht përtë tjerat, ma solli rasti që të provoj besnikërinë tuaj kaqë të shkëlqyer. Dhe me të vërtetë, çfarë s'do të duronja unë përtë parë tanë gjithë këtë zjarr tuaj, përtë dëgjuar gjithë këto lutje tuaja, që më kërkoni t'jua plotësoj, përtë patur më në fund pëpara syvet sot gjithë lulen e Shqipërisë, e cila kërkon **vetëm armë që t'i rrëmbejë?** Ç'ka më të bukur se kjo pamje: të kesh thirrur e t'i kesh përpëra të mbledhur përcështjen tënde si përcështjen e ndonjë rreziku të përbashkët gjithë Shqiptarët dhe gjithë ata senatorë e bij senatorësh venedikas? Kjo ngjau me mua, por kjo s'i ka ngjarë as Gjon Kastriotit, atij prindit tim, që kaqë fort ju e kini dashur, as ndonjë princi tjetër, që të flas kështu, në shekullin tonë. Dhe, që të kthehem me fjalën time prapë tek ju, ç'është kjo mrekulli e paparë: ta shikosh pothujase tërë Shqipërinë të zbrazur dhe ju vullnetarë të vraponi si ushtarë nga çdo anë tek unë dhe kush e kush më parë, të kërkoni që të gjithë armë e luftë. Kështu, duke më mbrojtur mua, ju dukeni se kini mbrojtur njëkohësisht shtëpitë, vatrat, gratë, fëmijët tuaj... u plotësofshin siç u a do zëmra qëllimet tuaja. Prandaj, në qoftë se këtu duhesin fjalë përtë t'ju dhënë zëmër juve, unë nga kjo anë s'mund të bëj asgjë, sepse po shikoj se qënkeni me të vërtetë trimë dhe fjalët **nuk ua rrisin trimërinë.** Veç kësaj, se ç'mund t'ju thoshnja unë juve, të armatosur e me shpatë në dorë, sikurse jam edhe vetë, këtë ju duhet ta dini mjaft mirë; këtë jua thotë edhe armiku, të cilin tanimë e kini parasyvet, këtë jua thonë sa e sa ngjarje poshtëronjëse, që ju armatosin me zëmërim të përgjithëshëm. Megjithëkëtë, unë do t'ju them atë që, edhe sikur të mos juva thoshnja, vetë gjëndja mund t'juva tregonte fare qartë: ç'është, ju lutem, kjo skllavëri që shihet ndër ne?... Një herë kemi përtë vdekur, por ja të vdesim trimërisht, ja të shpëtojmë lirinë. Ç'është kjo e keqe? Çdo ditë po pushtohet Shqipëria, çdo ditë po ripet; **shpëtimi ynë** çështë vetëm në duart tonë, tjetër shpëtim s'ka. Çfarë armiku kujtoni se po vjen tanë kundër nesh? Ç'mandatë po na sjell? Çfarë shpage po vrapon të marrë? Vdekjen ai ka vendosur

tani pér tē gjithë ne. Ai s'vjen kundër nesh i shtyrë nga urejtja e drejtë,<sup>1)</sup> e luftës, as si një armik i vërtetë, por vjen nga furia dhe tèrbimi pér tē pirë gjakun tuaj. Prandaj, në se dashuria pér atdhe, burrëria e vet, nderi i prindërvet, mund t'ia ngjallin ndjenjat krenare ndokujt, atëhere rrëmbeni armët, mprehni me plot tē drejtë<sup>2)</sup> shpatat, mbrojeni, po e desh puna edhe me gjak. Krujën e truallin e tē parëvet, që me aqë trimëri dhe pa derdhur pikën e gjakut i rifituat me mua në krye, dhe mbretërinë, që ma ruajtët gjer tani me aqë besë dhe ma rikthyet me aqë burrëri, ruajeni edhe këtej e tutje. **Guximi i atij që mbrohet duhet tē jetë më i madh, trimëria e tij quhet zakonisht më e madhe se sa e atij që shkakëton dhunë.<sup>3)</sup>** Ata kërkojnë vetëm plaçkë, vërsulen kundër nesh të shtyrë vetëm nga lëkmia pér tē sunduar. Por ju, që tē mos jeni plaçkë në duar tē tyre, jepini tē gjitha provat e trimërisë, kryeni detyrën ndaj atdheut, pér tē cilin kurrë s'duhet kujtar se është derdhur tepër gjak, se është luftuar sa duhet, sepse dashuria pér tē ia kalon çdo dashurie tjetër.

Por, duke i lënë këto tani me kënaqësi më nj'anë, ç'farë do t'ju mungonte juve pér tē arritur kulmin e fitores e tē lavdisë, në rast se do tē donit tē përdornit ndihmën e dhënë? Me tē vërtetë, pér krah jush në këtë çështje ju nuk kini vetëm arbëri nga janë e s'janë, por pranë jush, ju shikoni tē qëndrojnë edhe princërit e dëgjuar venedikas, tē cilët i nderon dhe njëkohësisht ua ka frikën gjithë Italia. Tani është rasti dhe është shpresa pér tē rifituar atdheun, tē humbur prej kohe, pér ta rritur lumtérinë tuaj.

Etërit dhe gjyshërit tuaj, — më lejoni ta them, — s'e paten menduar, por ju vërvjani vehtes pér qëllim që me këtë bashkim ta rikrijoni gjendjen e dikurshme të Shqipërisë, nënës së kryetrimavet, e ta shpëtoni pér gjithmonë nga ky turp Shqipërinë.<sup>4)</sup> Po ju pëlqeu pastaj që tē më kini mua shok luftë si ushtar apo si kapetanin tuaj, unë s'do tē mbetem prapa jush në çdo mund e rrrezik. Dhe në qoftë se në punë tē tjera

1) D.m.th. nga urejtja kundër një luftë tē padrejtë. Turku, pra, bën një luftë jo tē drejtë, grabitqare.

2) Sepse lufta që bëjnë është plotësisht e drejtë, luftë pér mbrojtjen dhe shpëtimin e atdheut.

3) D.m.th. e agresorit, e atij që i ble tjetrit padrejtësisht më qafë (= iniuriam inferentis). Barleti vazhdon tē theksojë këtu karakterin e luftës së drejtë tē popullit tonë me kryetrimin e tij në krye.

4) Këtu u tregohet qëllimi më i lartë i luftës kundër Turqisë, krijimi i Shqipërisë së bashkuar.

guximi im s'do tē ketë aqë fat, prapëseprapi, sa pér manovrimet, dredhitë dhe gjithë dinakëritë e armikut, unë s'do t'ju lë që t'ju shpëtojnë kurrë, sepse unë, gjersa ndoshta kështu që thënë, një kohë shumë tē madhe tē jetës sime e kam kaluar me neveri në një ambient nga më tē zjtte, duke marrë mësimë nga vetë fatkeqësia ime. Më vjen rëndë t'ju tregoj këtu ultësinë e atij ambienti, megjithëqë shpresa, që i ngjallet ushtarit pér një fitore më tē lehtë, i jep krahë. S'guxoj t'ju bëj fjalë tani pér këtë, se mos ju ligështohen fuqitë, mos i fiket **hovi nga mospërfillja e tepëruar pér tē, sepse me tē vërtetë shpesh herë armiku i përbuzur<sup>1)</sup> e ka vënë në dyshim fitoren dhe ka bërë luftë tē përgjakur.** Prandaj themelonjësit e lashtë tē ushtërisë kanë caktuar se porosia e parë do tē jetë që «luftrat duhen bërë me besim në vetvehte dhe pa përbuzur tē tjerët». Megjithëkëtë, ju vetë kini pér ta parë dhe kini pér ta përbuzur fare pér së shpejti këtë racë njerëzish nga më tē svetëruarat, siç e kini përbuzur edhe më parë gjer më sot me krenari e fatbardhësi, sado që kini qenë tē pakë. E kush tē mos e përbuzë dhe tē mos e urrejë këtë fundëri milieti, këtë llum sklevërish, tē mësuar më fort me vjedhje dhe me hajdutëri se sa me beteja tē vërteta? A mos vallë këta, me gjithë emrin e madh që kanë fituar sot, pér turp ndër njerëzit frikamanë, nuk janë ata turqit sklevër, prej Skythësh tē aratisur, tē cilët, siç thuhet, atdheun e lashtë e kanë pasur përtëj malevet Rife,<sup>2)</sup> dhe ishujve Tarakontë<sup>3)</sup>, akoma përtëj visevet tē Murranit, pranë oqeanit tē veriut? Thuhet se Aleksandri i madh i pat mbyllur këta me shula hekuri si bagëti në një vathë dhënhn ndërmjet maleve Hyperborë. Me zor mund tē mburren këta se kanë arritur ndonjë fitore më luftë tē vërtetë; vetëm me mashtime dhe me pusira kanë shtënë në dorë mbretërirë tē mëdha dhe do tē shtijen ngahera më tē mëdha, në rast se do t'u lihet shteg që t'u ndezë pabesia e tyre. E ç'kujtoni se do tē ngjasë me ju, o arbëri? Mua më duket sikur e shoh që tani Muratin tē kapet nga dredhitë më tē këqia meqë nuk do t'i vlejnë armët kundër jush. Ja, ka ardhur, para syvet e kini Otomanin dinak me premtimë shumë tē mëdha pér Ju... Kujton se do tē gjejë kudo grekër

1) D.m.th. i nënëvlefësuar, i përqmuar.

2) Malet Rife: male tē imagjinuara, që tē vjetrit i mendonin në pjesën veriore tē tokës, prandaj i quajnë shpesh edhe «male Hyperborë», d.m.th., «mbivlerorë». Shpesh me këtë emër janë quajtur malet e Ballkanit, Karpathet, Urali etj.

3) Ndoshta Barleti ngatërron këtu Tarrakonezinë e Spanjës.

e tribalë, kudo Misë, të cilët, pasi iu dhanë, paditur se ç'i priste, me një mirëbesim më të madh se sa duhet për njerëzit, ky sundimtar ose i çfarosi të gjithë, ose i shëmtoi, duke u nxierë një nga një sytë dhe duke i lënë sakat nga gjymtyrët e tjera të trupit.

Me kënaqësi, o ushtarë, i sjell ndër mënd të gjitha këto, jo sepse unë **dyshoj disi për besnikérinë tuaj**, për të cilën asnjë prijësi tuaj gjer më sot s'i ka ndodhur e s'mund t'i ndodhte që të pendohet, por që t'ju tregoj, si çështë e udhës, se ç'nerës dëshiroj të mbroj, se kujt ia kam falur jetën, gjakun e krejt jetën time, se me ç'armik ju kini për t'u përlleshur. Dhe me të vërtetë, ju që të gjithë e patë, e patë se sa fort e çmojnë besnikérinë dhe trimérinë tuaj, prandaj unë ju zgjodha si të vetmit nga tërë ajo mizëri njerëzish dhe ushtëri vullnetare për t'i vënë gjoksin çështjes më kryesore nga të gjitha, kurse të tjerët i dërgova fort të pikëlluar<sup>1)</sup> më shtëpi. Të gjithë po ju presin që t'ju lavdërojnë apo t'ju qortojnë. Unë mendoi se tani nuk mundet as të lavdërohet as të qortohet kush, sepse ç'besim mund t'i kesh një ushtari, që kercënohen brënda kampit?<sup>2)</sup> Por atëhere, kur t'i shikoj shpatat tuaja të avullojnë gjak armiku, kur spektator dhe nxitës njëkohësisht, unë do të marr si shëmbell për vehten time trimérinë tuaj që jetën s'e quan për asgjë, atëhere do t'ju mbuloj me çdo farë lavdesh dhe shpërbimesh. Por a mund të ketë lavdi më të madhe, a mund të ketë shpërbime më të mbëdhë për cilindo nga ju, se sa shpëtimi i atdheut, që varet nga dora e ju të gjithëvet? Peshojeni, pra, mirë, o burra kryetima, se ç'rëndësi të madhe ka puna juaj sot. Po u mundëm në këtë betejë, e kemi të humbur gjithë luftën; po duallëm përkundrazi, fitimtarë, do ta heqim qafe zgjedhën e tanishme të Muratit, do të kujdesemi në të ardhmen vetëm për paqën dhe qetësinë e përherëshme. Silleni ndërmënd zgjedhën armike, talljet e mundësit dhe pamjen tërë mburrje të tij; sillni ndërmënd edhe se ç'mizëri njerëzish të ndryshëm na përcollën, kur u nisëm e u larguam nga sytë e tanëvet, se me ç'dëshira në zëmër e lot në sy i lamë të gjithë, se si na presin gratë, prindërit dhe fëmijët tuaj<sup>3)</sup>. Mund ta marim me mënd: të gjithë janë duke pritur me hall e ankth në zëmër se

1) Sepse kishin dëshirë të qëndronin si ushtarë të Skënderbeut për të luftuar e mbrojtur atdheun.

2) D.m.th. jo në front të luftës.

3) Skënderbeu s'ka ende fëmijë; prandaj thotë: tuaj.

ç'përfundim do t'i ketë dhënë luftës trimëria juaj. **Por burri** trim s'ka përsë t'i trëmbet fatit. Është turp të pranoni ndonjë fat, që sështë në dorën dhe shpatën tuaj. Varet, pra, nga Ju që shpresën, që kanë të gjithë në trimërinë tuaj, ta bëni realitet me fakte. Sa më i madh në numur armiku, aqë më e bukur lavdia juaj... Por megjithëkëtë, nëse ka ndonjë që ndjen frikë, që i mat fuqitë tona me emrin që i ka dalë ushtërisë armike dhe që beson se ka për t'u mundur prej atyre që ia kalojnë në numur, do të bëjë mirë të largohet me gjithë qef që këtej, që të mos e kem më fort bela nëpër këmbë, se sa ndihmë... që ushtëria fitimtare ta gjejë pastaj të struktur nëpër muret e pullazet e shtëpisë... le ta forcojmë këtë ushtëri, në s'na vjen turp... nga njerëzit, me forca më të mëdha, ose më mirë të marrim sytë dhe të ikim që tani; sepse, kush i ka frikë, me këto legjione, komandantit të Muratit, sidomos në fushat shqiptare shumë të mbrojtura prej vetë natyrës, mua më duket i padenjë për shpatën t'je mban, i padenjë për ajrin që thith.

Pa dashur, o ushtarë, burra jo vetëm trima, por edhe kryetima, ua zgjata fjalën këtu. Ejani, pra, zgjojeni nga gjumi trimérinë e dikurshme, frymëzohuni nga ndjenjat fisnikë, mos merrni asgjë tjetër parasysh përvëç fitores, vetëm nga vdekja, që t'i them të gjitha me një fjalë, pranoni të mundëni. Mendoni se, po të fitojmë, çdo lumturi ju pret në të ardhmen, se po të biem trimësht, kjo<sup>1)</sup> do të jetë fundi i të këqiatet dhe i mjerimevet. Në qoftëse kjo është ngulur mirë në mënd dhe vendosur nga ju të gjithë, atëhere më kot më shtyn mua dëshira për të folur më tej, sepse sigurisht natyra e njeriut s'i ka falur atij asnjë shkas më të fortë për fitoren se sa vetëdijën e plotë të trimërisë». (II, 103-107).

Këtë fjalë të Skënderbeut ushtëria e priti me aprovim e gatishmëri të plotë për t'u lëshuar kundër armikut e për ta qërmuar, sikurse e dérmoi. Barleti thotë tekstuallish kështu: «Menjëherë sapo Skënderbeu u dha fund këtyre fjalëve, e gjithë ushtëria e aprovoi mendimin e tij duke lëshuar një britmë dhe duke thirrur nga të katër anët me zë të lartë: «Duhet të nisemi sa më shpejt, të vrapijmë kundër armikut dhe madje ta sulmojmë». Kjo që më në fund një farë prove e si-gurtë, me të cilën mund të tregohet guximi dhe besnikëria

1) D.m.th. vdekja herioke. Kuptimi është se më mirë të vdesim me ndër, se sa të rrojimë në robëri.

## LETRA E VLADISLAVIT DÉRGUAR SKENDERBEUT

«Vladislavi, mbret i Hungarisë, i dërgon shumë të fala Skënderbeut, princit të Arbërvet.

Fati, ndoshta, i shtyri për këtë kohë dhe i vonoi përgëzimit tonë, me qëllim që të të përgëzonim sot jo vetëm pse dolle faqebardhë duke rifiuar mbretërinë, por edhe pse e mbrojte atë me urtësi dhe trimëri, pra, për dy gjëra që vajtën aqë mbarë. Ne, ndërmjet fatkeqësivit tonë të tjera, e kemi shkuar gjithmonë si humbjen jo më të vogël atë mjerim të Shqipërisë, kur yt atë, Gjon Kastrioti... një princ, siç kam dëgjuar, që ka merituar me plot të drejtë mirënjojen e të gjithëvet, nuk mundi, ashtu i shtypur nga Murati, të ta linte ty si djali i tij që e kalonje jetën nën sundim të huaj, mbretërinë e të parëvet, as të kujdesej ndryshe për shtetin e vet. Por tanë trimëria jote, ia ka shtuar shumë fuqinë... Dhe makar të ishte gjallë tanë ai prind i lumtur për këtë djalë... sikur të të kishte parë përpëra se të largohej nga kjo jetë. Prandaj në kohën e sotme, le të më lejohet ta them pa i ardhur kujt rëndë, ti më duke shpaqur i vetmi princ që je pajisur me të gjitha të mirat shpirtërore dhe trupore... Me ty në krye jo vetëm bregu i gjithë tokës shqiptare do të jetë i sigurt këtë e tutje, por përveç kësaj, edhe gjithë popullsitë, që i janë rrëmbyster prej kohësh trupit të mbretërisë së Shqipërisë nga hajdutët e urryer otomanë, do të kthehen përsëri në formën e vjetër të pushtetit dhe të sundimit të tyre. Dhe me të vërtetë, (që të hesht për trimëritë e tjera, të cilat ty dikur pranë barbarëvet, megjithëse ishe fëmijë dhe me gjithë smirën që i brente ata për dija e më tepër, të dhanë një emër shumë të madh), ç'ka më të bukur se ajo fitoja, që ne dëgjuam e besuam me admirim të paparë se sapo e korre kundër Ali Pashës, duke dërmuar dhe duke i dhënë arratinë me gjithë ato forca që pati? Por tanë, o Skënderbe, për ty paraqitet një rast lavdie shumë më të madhe. Tani është rasti që ti të shpaguhesh kundër Muratit për gjithë padrejtësitë e vjetra dhe të reja, që ka bërë kundër teje dhe njerëzvet të tu, dhe jo vetëm për këto të tuat individuale, por edhe për të zezat e përbashkëta të këtij illoji dhe për talljet pa numur... Po deshe që të na ndihmosh me ushterinë tënde fitimtare, gjersa s'i kemi

e ushtarëvet plot dashuri për kapedanin e tyre, për të cilin ata po përgjeroreshin prej kohe, që edhe një provë se planet e Skënderbeut mund të quheshin të siguruara këtë e tutje, gjersa ai e shikonte qartë tanë se njerëzit e tij po hidheshin me aqë gatishmëri, me aqë zjarr e sedër kundër armikut, sa që, në mos kish si t'i lavdéronte për trimërinë, të piken mund t'i lavdéronte për vullnetin e tyre që s'donte t'ia dinte për jetën... Kudo zjente një potere shumë e madhe e ushtarëvet, që po kërkonin të luftonin me dëshirë të zjarritë». (II, 107). Dhe Skënderbeu, «duke vënë re këtë zjarr në mbarë ushterinë, duke parë se ishin ndezur e po digjeshin nga ky zjarr gjithë radhët e ushtarëvet të vet të çdo moshe, në fillim u gëzua pa masë dhe po dëgjonte me kënaqësi në zemër kanosjet e rrepta të secilit, po shikonte me admirim fytyrat e tyre krenare dhe guximin trimëror, që shprehnin nga thellësitë një valë vigane zemërimi» (II, 108). Pastaj, duke dashur t'u plotësojë dëshirat e duke menduar se s'ishte lehtë t'i qetësonte ndryshe e t'i frenonte, u nis për të kërkuar armikun, të cilat i dha dërmën: «Kudo gjak e vrasje, kudo s'dëgjohej tjetër veçse ulurima e atyre që po jepnin shpirt» (II, III).

Në këtë luftë u vranë nga barbarët, thotë Barleti, 22 mijë, u zunë robëri 2 mijë dhe 24 flamurë bashkë me kuaj e plackat e tjera. Dhe këto përfundime u arritën, sepse «në atë betejë nuk mungonte asgjë nga ato që kanë mundësi... për të dalë faqebardhë, por edhe që mund ta detyrojnë për një gjë të tillë: nuk mungoi as koha, as vëndi, as rregulli i përsosur në të gjithë veprimet, as arësyjeja e drejtë dhe njëkohësisht e domosdoshme për t'u përlleshur» (po aty). Dhe Barleti përfundon: «Më në fund për komandantët dhe ushtarët do të mund të thoshnja këtë: «atë ditë luanët kanë komanduar luanë».

Me këta «luanë» të komanduar nga luanë u arrit kjo fitore, që pati rëndësi të madhe dhe zgjoi kudo shpresa për cilimin e gjithë Ballkanit nga robëria turke. Jehona e saj bëri që mbreti Vladislav i Hungarisë të kërkojë ndihmën e Skënderbeut kundër forcave të sultani Muratit në betejën e Varnës. Për këtë ai i shkroi Skënderbeut një letër.

humbur akoma shpresat për punët tonë, të ftojnë për këtë gjithë princët e burrat kryetrima të Hungarise dhe të Polonisë, të fton Juliani... qysh prej kohe i radhitur me armë në dorë së bashku me ne. Asgjë përvëç flamurëvet të tu nuk presim. Në qoftë se ti nuk do të thuash jo për këtë rast të paraqitur nga prisnje, të gjithë e thonë hapur se është krejtësisht e mundur që të marrë fund lufta me turqit dhe të dbohen ata duke u vënë fshesën nga Evropa, ku sundojnë prej një kohe kaqë të gjatë. Prandaj unë mendoj se duhet lënë më 'nj'anë për ty në këtë letër qdo farë nxiteje lidhur me këtë çështje, e cila, po të mbrohet, sjell shpëtimin, dritën, lirinë, po të lihet mbas dore, tmerohem të them se ç'mund të sjellë.

Mjaft më ne... kemi qenë skllavër të zellshëm gjer më sot, mjaft jemi djegur e përvëluar që të gjithë, ndërsa askush nuk mendon se zjarrit duhet t'i bëjë ballë vetë. Ç'po na shohin sytë me mbretërinë e grekërvet, me mbretërinë e tribalëvet? Më në fund, kush mund t'i llogarisë vetë humbjet e mia dhe të këqiat që kam hequr e që më duhet të heq për ditë? Kush mund t'i llogarisë princërit kryetrima, mburojat e fuqisë hungeze, që i kam humbur për gjithë jetën, dhe gjithë ato ushtëri shumë të fuqishme, që m'i ka gllabëruar po ai fat i zi i luftës dhe m'i ka çfarosur thuajse krejt, sa që tani s'ka më në Hungari asnjë shtëpi, asnjë zonjë shtëpie që të mos jetë veshur në të zeza? Të gjitha këto princërit... i kanë marrë vesh e megjithëkëtë askënd nuk e prek fati i mjeruar i të tjerëvet. Kështu ata durojnë që ne t'i lihem i kudo armikut si kurbanë për të shpëtar me gjakun tonë nga rreziqet gjithë të tjerët. Vetëm Evgeni, kryevalltari... dhe Filipi, duka i Burgonjës, nuk i janë shhangur peshës së rendë të fatkeqësisë që na ka goditur. I pari na ka dërguar këtu Julianin bashkë me një ushtëri fort të dëgjuar; i dyti, Filipi, pasi bëri gati një fletë dhe e dërgoi gjer në Helespont<sup>1)</sup>, me sa pat në dorë, ua ndaloj si burrat kalimin turqëvet. Tani një shpresë tjetër na ka lindur për një ndihmë të afërt, që na e do zëmra. Prandaj unë tani, i shtyrë së pari dhe mbi të gjitha nga trimëria jote dhe pastaj i detyruar nga rreziku dhe gjëndja kritike e tërë punëvet tonë, po të ftoj vetëm me dëshirën time për një lufte kaqë të nevojëshme. S'ka njeri që të mos e dijë se ke për ta bërë këtë në rrëthana të vështira për ty, për shkak të rre-

1) Helesponti = Dardanelet.

beshit që apo e pate në punët e tua të brendëshme dhe të qetësë që apo vendose në mbretërinë tënde. Por kjo nuk duhet të përapsojë ty, sepse në këtë fushatë do të fitosh emër shumë të madh e pastaj të mirën që të kërkojmë tanë, do ta bësh për njerës që të janë shumë mirënjohës. Dhe me të vërtetë, atë që ti do ta bësh i pari sot për shpëtimin dhe ndërin tonë, ne do ta bëjmë pastaj gjithmonë për lavdinë tënëde dhe për madhërinë e mbretëris sate».

Qofsh shëndoshë  
Nga Buda jonë mbretërore, më  
5 korrik, në vitin 1443<sup>1)</sup> (II, 115).

Kjo letër e mbretit Vladislav u bë objekt diskutimi në një mbledhje të gjerë të parisë së Skënderbeut dhe pas shumë mendimesh lidhur «me numurin e ushtarëvet dhe sasinë e forcavet që duhej të shkonin» (II, 117), u vendos të nisej vëtë Skënderbeu. Për këtë ai e lajmëroi Vladislavin me letrën e mëposhtëme, me të cilën i përgjigjet kërkuesës së tij.

## VI

### LETRA E SKËNDERBEUT DËRGUAR VLADISLAVIT

«Skënderbeu, princ i shqiptarëve i dërgon shumë të fala Vladislavit, mbretit të Hungarise dhe të Polonisë.

Me gëzim e mallëngjim e mora letrën tënde, o mbret i pathyeshëm, të cilën, pasi e lexuam, sipas urdhërit që dhashë, në një mbledhje shumë të gjërë të kapedanëvet të mij, asnjëri nuk dolli që të thoshte dhe që të mendonte se nuk duhet pranuar me dëshirë rasti i një lufte kaqë të drejtë, që na paraqitet prej teje. Kështu që të gjithë së bashku dhe secili vëçanërisht thonin se s'mund të kishin sot një kënaqësi më të mirëpritur se sa t'i shërbën me gjithë zemër një mbreti të pashoq e ta detyronin fort dhe t'i sillnin njëkohësisht... ndih-

1) Pritej të ishte viti 1444, gjersa kjo letër të shkruhet pas betejës së Torviollit, të cilën historia e shënon të zhvilluar më 29 Qershor 1444, dhe pas betejës së Varnës, zhvilluar në nendor 1444.

mën aqë fort të dëshiruar. Unë u gjëzova shumë nga ky vullnet i të mivet, si për ty në radhë të parë, si për çështjen e përbashkët, kur ushtarët tanë të çdo rangu i pashë kaqë të flaktë dhe kaqë fort të prekur në zëmër për ty, pa ndonjë nxitje nga ana ime. E kush tjetër veç se i urryeri nga njerëzia mund ta mohonte një luftë kaqë të drejtë...? Unë s'kam ç'të them; vetëm m'u plotësoftë dëshira, o Vladislav, që të mund të t'i sjell vetë gjithë ato forca që mendoj e që ma do zëmra të t'i sjell për këtë luftë kaqë të shënuar; atëhere Evropa nuk do të dergjet, ndoshta, në gjithë atë zi, e shtypur nga Murati i pashpirt, fushat e Bazilesë dhe të Varnës nuk do të avullonin më nga gjaku hungarez kaqë herë i derdhur si fli për të tjetrët, as çdo cip i Shqipërisë s'do avullonte nga gjaku shqiptar. Kemi mbaruar tanimë që të gjithë, gjersa secili mendon sé ka lindur vetëm për vehte.

Por pse unë tani rri e ankohem pa dobi dhe qahem më kot? Në të vërtetë, unë s'jam aspak i pakënaqur me forcat e mia... Unë kam ndërmënd që atyre 15 mijë ushtarëve, të cilët pak kohë më parë e shpartalluan Ali Pashën në kufi të Shqipërisë, t'u shtoj edhe aqë të tjerë. Me këta unë, sa më parë që do të më vijë për mbarë, do të marr rrugën për ke ju, për të ndjekur pas flamujt e tu në çdo rast. Mbeq shëndoshë.

Nga Kruja, më 4 Gusht 1443». (II, 119-120). Skënderbeu e mbajti fjalën dhe u nis dhe ushtëria e tij «me një hare të pazakontë dhe me flamuj në dorë po hynte në tokat e Misisë» (II, 121). Por këtu u pengua nga Gjergj Vukovisi, quajtur zakonisht Dhespot i Serbisë, princ i asaj krahine, dhe ndërsa po bëhej gati ta çante rrugën me shpatë mori vesh kërdinë e hungarezëve, të cilët u përlleshën me turqit para se të vinte Skënderbeu. (II, 124).

## VII

### LETËR E SKËNDERBEUT DËRGUAR MURATIT

Pas kërdisë që pësuau hungarezët në Varnë, Huniadi po preqatiste një ushtëri të re për të marrë hakun. Kjo i dogji Muratit plak, i cili, «duke u ndodhur në një farë mënyre ndërmjet hungarezëvet dhe shqiptarëve, popuj fort luftëtarë, nuk do të mund tu bënte ballë fuqivet të tyre» (III, 126).

Përveç kësaj, lidhur me shqiptarët, Murati «i matte fuqitë e Skënderbeut nga ajo kërdia me nam që pësoi Ali Pasha pak kohë përpara dhe njëkohësisht i trëmbej besimit që kishin gjithë popullsitet e Shqipërisë tek ai dhe dashurisë që gjëzonte nga princërit..., e cila shtohej dita ditës» (III, 129). Prandaj Murati mendoi të binte në ujdi me Skënderbeun dhe «ta kapte atë burrë, që s'mund ta thyente me armë, me anë të dhëlpërvet të njohura dhe të mashtimit, siç i kish ndezur sa e sa herë me të tjerët» (III, 126). Kështu ai i shkroi një letër Skënderbeut, ku, pasi e akuzon si njeri bukëshkalë, që ngriti krye kundër tij etj. duke ndihmuar akoma edhe hungarezët e duke i rënë më qafë edhe Gjergj Dhespotit, vjehrit të tij etj. dhe pasi e kërcënë se, po të mos mbledhë mëndjen, do ta ndëshkojë rëndë, i propozon të bien në marrëveshje dhe të bëjnë armëpushim e paqë në mes tyre. (III, 128).

Kjo letër e Muratit, me të cilën ai, siç na thotë bukur Barleti, «u përhoq ta trondiste dhe t'ia turbullonte fort mëndjen Skënderbeut» (III, 126), kuptohet se, sipas zakonit, u bë objekt diskutimi dhe shoshtjeje kolektive për të përcaktu ar qëndrimin që duhej mbajtur dhe përgjigjen që duhej dhënë. Një pakicë ishin të mendimit se duhej pranuar propozimi i sulltanit e bërë paqja me të, kurse Skënderbeu «i hidhte me guxim këshillat e tyre dhe çfaqtë keqardhje që gjëndja shqiptare për të keqen më të madhe të saj, kishte ndërmënd t'i merrte vesh e fundit nga të gjithë dhëlpëritë otomane». (III, 129). Ai mendonte se paqen «me një plan që ndodhej më afér vdekjes, siç ishte Murati, do ta gjëzonin vetëm për pak kohë, kurse paqën e vërtetë do ta kishin «po të mbështeteshin më tepër në armët; përkundrazi, po të pëlgenin më fort rehatinë, do të kishin luftën» (III, 130). Dhe, duke theksuar nevojën për të mbrojtur atdheun dhe nderin e tyre, u thoshte: «Turp që të flisnin tani për paqë, kur sapo u ishin mbyllur burravet plagët nga beteja e freskët me Ali Pashën. Le të rifitonin më parë vatrat e të parëvet dhe lirinë e gjithë popujvet të tyre dhe atëhere më në fund mund të propozohen e të pranoheshin me nder mendime për paqën (Po aty).

Mendimi i Skënderbeut u pranua kështu nga të gjithë, madje me një farë pendimi se kishin thënë diçka që atij s'i pëllqente: «Në këtë rast, pra, si edhe në rastet e tjerë, ata i u bindën Skënderbeut; madje, nga dëshira që të mos dukeshin në

asnje rast te gjendjes se tyre se nuk iu përfillnin këshillat luftarake atij qe e kishin ndjekur pas në luftë, po pendohe- shin se kishin thënë diçka qe ai s'e pëlqente. (Po aty).

Kështu, pasi u arrit uniteti i plotë i mendimit, Skënderbeu i dërgoi Muratit këtë përgjigje:

...Skënderbeu, princ i shqiptarëvet, i dërgon përshëndetje Muratit otoman, prijsit të turqvet. Ti dikur, siç shkruan, më paske bërë fort borxhilli me gjithëfarë nderimesh. Unë sot do të t'i laj me urtësinë dhe gjuhën time të matur, sepse as gjë nuk kujtoj se është aqë e ulët, se sa të mos mundesh të përmash vehten nga një ligjërim aqë i shëmtuar dhe nga fjalë aqë të ulta si ato tuajat, qoftë edhe kundrejt një armiku nga më të mënishmit. Prandaj në letrën tënde dhe të dërguarin tënd e pritëm dhe e pranuam pa u turbulluar fare, madje, që të të them të drejtë, letra jote më bëri më fort të qesh se sa të zemërohem, sepse nga njera anë ti guxon, menjëherë dhe qysh në fillim, të më padisësh për një mosmirënjohje dhe pabesi aqë të madhe, e nga ana tjetër, i shtyrë nga ndonjë ndjenjë shpirbutësie, më përmënd humbjen e shpirtit tim, pa menduar fatin tënd të mjeruar... Dhe më në fund, pa respektuar asnje të drejtë lufte dhe asnje rregull në këto punë, më parashtron me një mënyrë trashamane, që të mos them të turpëshme, si ndonjë mundës të mundurit, kushte të shuma paqeje dhe veçanërisht të atilla, që zor t'i dëgjosh pa zënë veshët.

Sadoqë, o Murat, gjithë këto sharje të tua do të mund t'i jepnin pa dyshim të drejtë kujtdo, edhe atij më të duruarit, për të sharë, prapëseprapë unë një pjesë të tyre po ia fal moshës dhe prirjes gojëleshuar të një plaku, pjesën tjetër pikëllimit të tij, që s'është lehtë ta zbutësh, sidomos kur kam vendosur të luftoj me ty jo me sharje dhe me të bërtitura, por me armë dhe me mërinë e drejtë të luftës<sup>1</sup>). Me gjithëkëtë, përsë, të lutem, or Otoman, tallesh kaqë fort me njerëzit, sikur të të kem rënë unë më parë më qafë dhe jo ti mua? Kështu, pabesi e quan ti largimin tim të domosdoshëm prej teje? Krim ma quan ti çlirimini e atdheut me zgjuarësi dhe trimëri? Por, o burra, llomotit, se unë e pranoj me gjithë qef që të shpallem prej teje përgjegjës në jetë të jetëvet për këtë krimë.<sup>2</sup>)

1) D.m.th. me mërinë që ndjen kundër armikut në luftë të drejtë.

2) D.m.th. për këtë veprime të drejta, që ti i quan krimë.

Nderimet e tua gjithashtu kundrejt meje, që po m'i përmënd e m'i radhit këtu türkuzzë, unë do t'i kujtonja me kënaqësi, sikur të mund të harronja gjithë ato të këqia të tmeruara, të cilat, po të viheshin me radhë në peshë, me siguri që mirësitë e tua aqë të mëdha do të çdukeshin nga faqja e dheut prej mbrapështivet të tua edhe më të mëdha. Megjithëkëtë mua s'më pëlqen të t'i përmënd këtu e të të bëj të skuqesh, por e quaj më të udhës që ti t'i kujtosh e peshosh vetë me vehten tënde. Vetëm për një gjë do të habitej pa dyshim kushdo që mund ta dinte, se si kam mundur unë t'i duroj ato e se si ty s'tu neverit njëherë gjithë ajo mëri e mizori e jote. Mbretërinë atërore ma rrëmbeve, vëllezërit m'i vrave dhe mua vetë, që s'i trëmbësha aspak një gjëje t'atillë, më kishe taksur qysh më parë për vdekje mizore. Dhe tani të duket fort e çuditëshme, o Murat, që ky shpirt, i cili s'ma harronte lirinë, pat kërkuar atëhere të shpëtonte me një farë mënyre nga ajo robëri aqë e madhe! Gjer kur, më në fund, kujtovë se do ta duronja sundimin tënd të harbuar? Megjithëkëtë, unë durova shumë, më gjatë se ç'mund të durohesh, dhe as që i bëra bisht zgjedhës pranë teje; unë kam përballuar gjatë gjithë asaj kohe rreziqe të përbashkëta dhe të veçanta si vetë me dëshirën time, si me urdhërin tënd. Përditë thureshin biseda për ty<sup>1)</sup> dhe shpesh miqtë e mij më flisnin për pusitë e tua; megjithëkëtë, unë pata besuar për një kohë të gjatë se as në veprat, as në fjalët e tua nuk fshihej ndonjë dhëlpëri, gjersa planet e tua të prapa dualë vetiu s're sheshit. Atëhere edhe unë nuk u çfaqa hapur, duke drejtuar tërë kujdesin tim në dhëlpëritë e tua, gjersa të më qeshtë fati e të gjënja rastin për të fituar lirinë. S'ka, pra, pse që shtë fati e të gjënja rastin për të fituar lirinë. S'ka, pra, pse të të vijë keq tani, kur ti, siç thamë, e ke marrë vetë vehten tënde më qafë ashtu siç u solle. Megjithëkëtë, këto janë pak, o otoman, në krahasim me ato që unë kam shpresuar e dëshëruar. Prandaj léri mënjanë këtej e tutje kërcënimet e tua të rrepta dhe pusho së na përmenduri kaqë herë shëmbëllën e fatkeqsisë hungareze. Çdo njeri ka zemrën e vet, ka orë e vet... Ndërkëq që ne nuk kërkojmë këshilla nga armiku për çka duhet të bëjmë, as kërkojmë paqë prej teje, por fitoren kërkojmë.

Qofsh shëndoshë.

Nga kampi ynë, më 12 Gusht, 1444. (III, 131-132).

1) D.m.th. flitej për veprimet e tua.

Përgjigja me fjalë «krenare dhe bujare», siç thotë Barleti, dhe «besimi shumë i madh» i Skënderbeut, nuk e kënaqën, por përkundrazi, «i kallën një farë frike» Muratit barbar. Megjithëkëtë ky vendosi të dërgonte kundër Shqipërisë një ushteri të vogël prej 9.000 kalorësish të sprovuar me Feriz Pashën në krye, sepse, nga frika e hungarezëvet, s'mund të dërgonte forca më të mëdha, as të vinte, ndoshta, vetë për të marrë hakun. Por Feriz Pasha u dërmua nga dora dhe shpata e trimavet të Skënderbeut, gjithësejt 3500, nga të cilët 1.500 këmbësorë, në një pyll të Mokrës. Barleti na thotë se qëllimi i Muratit dhe i kapedanit të sprovuar të tij, Feriz Pashës, ishte që ta zinte Skënderbenë të papregatitur, në befasi (III, 133); por «Skënderbeu ishte njoftuar për të gjitha këto fill e për pe», prandaj, «ashtu siç ishte në vozitje e sipër gjithëmonë me ushteri të rregullt për çdo të papritur, duke shfrytëzuar rastin e mirë për kohë e për vënd, zuri menjëherë i pari dhe e mbushi me ushtarë të armatosur një luginë të ngushtë që e quajnë Mokër e që ishte e vetmja rrugë kalimi për barbarin» (III, 134). Këtu «tanët», vazhdon Barleti, «po prisnin me një heshtje të pandërprerë gjersa panë se barbari po hynte» në luginë, «plot gëzim dhe se kalorësia ishte e rrethuar nga të katër anët prej qafash plot dushqe të malevet dhe prej shkëmbinjsh thikë». (Po aty). Atëhere u lëshuan mbi armikun, që s'e priste dhe që dërmohet «pothuaj nga vete vështirësitet e vëndit», këmbësorët e Skënderbeut dhe e bënë copë e thërrime.

Kjo fitore, në të cilën spikat si kurdoherë taktika gjeniale e Skënderbeut, «ndonëse shumë më e vogël se ajo e Torvollit», thotë Noli (f. 48), «bëri më tepër bujë në Evropë, ku vajti si një ngushëllim i mirëpritur pas katastrofës së Varnës».

## VIII

### FJALIMI I SKËNDERBEUT PARA NDESHJES ME MUSTAFANE

«Katastrofën e Ferizit», thotë Barleti (III, 135) «e pasoi fati aspak më i kënaqëshëm i Mustafajt. Kur Otomani mori vesh kërdinë e ushtërisë së vet dhe dëgjoi për pritat e Skënderbeut, megjithëse e shihte që ikja e të vetëvet, kishte qenë, në mos e dobishme, e nevojshme, dhe se fati s'i jepët asnjë të

drejtë që t'i qortonte për veprimet e tyre aqë me vënd,<sup>1)</sup> me gjithëkëtë, duke u shtyrë nga një zemërim edhe më i madh kundër Skënderbeut dhe duke mos i gjetur shpirti qetësi as natë, as ditë, e drejtoi tërë vëmëndjen e vet vetëm e vetëm në çdukjen e atij burri dhe asgjë nuk dëshironë më tepër se sa fushat shqiptare, ku mendonte se kish arësyte për të marrë hakun e dëshiruar prej kohe për gjithë ato dëme të vjetra e të reja, pa ditur të keqen që e priste». M'anë tjetër, Murati kishte frikën e hungarezëvet, prandaj «s'mund ta çfrynte dufin e vet» me tërë egërsinë e tij. Kështu dërgoi kundër Skënderbeut 15 mijë ushtarë kalorës, me urdhër që të mos i jipte betejë, por vetëm të shkretonte vëndin, duke hyrë në të parpritur, të plaçkiste, të digjte e të therte. Kështu Mustafaj erdhë e zuri vënd në Otonetë, në Dibër të sipërme, ndërsa një pjesë të ushtrisë e lëshoi për të plaçkitur e shkretuar vendin. Skënderbeu, i cili u informua për planin e Mustafajt edhe nga «një shqiptar, burrë me guxim të madh e me fat të mirë, që u kish shpëtar dueret të barbarëvet dhe që e zbuluonin dhe e bënин të shquhej plagët e shuma e gjaku i freskët» (III, 137), e goditi befas armikun dhe e coptoi. Por, përpara se të veprojë, ai shtron për diskutim e këshillim planin e veprimit, taktikën e tij, në këtë rast. Për këtë ai u mban ushtarëve këtë fjalë të shkurtër.

«Unë e kam bërë zakon, o ushtarë, që të jap këshilla në mbështetje të vetë rrëthanavet. Prandaj tani është nevoja që ne të këshillohem së bashku dhe të nxjerrim prej gjëndjes që kemi përpara ato detyra, që secili nga ju do t'i givkojë më të sigurta e më të ndershme, duke u nisur nga vetë përfundimi, që është mësonjësi i të gjitha gjërat, dhe n'a ia imponuar kujt mendimin me forcë. Ne kishim marrë vesh se barbarët janë lëshuar nëpër fushat tona e po enden si plaçkitës pa asnjë rregull, pa marrë asgjë parasysh, të shpërndarë sa andej këndeje, e se çdo gjëje tjetër ia kanë frikën, kurse armikut jo. E kështu, duke më patur mua iniciator e shok në një qëllim e plan kaqë të dobishëm, ju e çveshët shpatën të gjithë kundër tyre. Tani s'kam përsë të bisedoj me ju se çfarë të re solli në planet tona ardhja në kohë të duhur e këtij burri,<sup>2)</sup> sepse ju e dërguat vetë të tregojë gjithëçka ngjet me barbarët. Një gjë s'do të mundë kush ta mohojë, në dëshironi të merrni parasysh planin e barbarit lidhur me vendosjen e

1) D.m.th. largimi, tërheqja e Ferizit etj.

2) Eshtë ai burri «shqipëtar», që u kish shpëtar duarvet të Tarzatëvet, etj.

kampit e me gjithë ato roje të armatosurish, atëhere do ta kuptioni se ai nuk ushqen kundër jush, siç, ndoshta, besoni, qëllime të një hajduti, por të një armiku nga më dhelparakët. Prandaj duhet që të veproni, me sa mendoj unë, kundër armiqvet më me kujdes e më me urtësi, se sa kishit ndërmënd të vepronit kundër hajdutësh.

Ne nuk duhet ta drejtojmë sulmin e parë kundër plaçkitësve<sup>1)</sup> me qëllim që të mos i japim shkak kapedanit të clodhur për të sulmuar nga kampi dhe njëkohësisht për të fituar atëhere, kur ne vetë të shpërndarë do të ndjekim të shpërndarët, duke u dërmuar me turp prej kundërshtarit, që do të na ndrydhë nga të dy anët. Ne duhet të sulmojmë kundër vëtë fortifikimevet të kampit e në rast se trimëria këmbëngulëse, siç e ka zakon; do t'i asgjësojë ata dhe kapedanin do ta bëjë që të marrë arratinë apo do të mund t'ua tregojë kokë e tij, pasi të jetë vrarë, turmavet të tjera të barbarëvet, atëhere, me të vërtetë çdo gjë do të ketë marrë fund pa derdhurju as pikën e gjakut. Sa për turmën tjetër të hajdutëvet, ata, të mbetur pa ndihmën e shokëvet të vet dhe të rrëthuar hap pas hapi nga ju, kanë për të rënë në dorën tuaj të vdekur ose, në dac, të gjallë. Më në fund, hapni sytë, bashkëluftëtarë, mos ju mbërthejë ndyrazi në vënd lakkia e plaçkës, e cila shpesh e ka zakon që edhe ngadhënjimtarëvet t'ua rrëmbejë nga duart, ndërsa sy e për turpin më të madh të tyre, lavdinë e një armiku të shtrirë përdhe». (III, 137-138).

«Ky plan i kryerimit», thotë Barleti, u pëlqye fort e u aprovua nga ushtarët» (III, 138). Dhe me këtë plan të aprovar unanimisht, duke siguruar kështu unitetin e mendimit dhe të veprimit, që përbën një nga karakteristikat themelore të takikës luftarake të Skënderbeut, ai «e dërmoi» «armikun plotësish në pak orë», siç thotë F. Noli (f. 49) në veprën e cituar të tij. Barleti shprehet në këtë rast kështu: «Ka disa nga ata që thonë se në këtë betejë barbarët u grinë që të gjithë, përvëç Mustafajt me disa nga paria. Megjithëkëtë, mua më duket më afër së vërtetës mendimi i atyre që thonë se kanë pesë mijë. Numuri i të kapurvet thuhet se ka qenë më i vogël, gjithë-gjithë e me zor 300, e këta gati të gjithë të shëmtuar keq e të pavlefshëm nga plagët, sepse ushtarët ishin ja-

1) Këta janë pjesa e shkëputur nga kampi, që ishin dërguar për të plaçkitur vëndin, ndërsa të tjerët qëndronin në kamp bashkë me Mustafanë. Skënderbeu kërkon, pra, që sulmi i tij të drejtohet kundër vëtë kampit, ku qëndronte Mustafaj etj.

shtë masës ndezur në atë betejë e më të prirur për të çfryrë egërsisht, kur shihnin plaçkitjen e të vëtëvet dhe vëndin të shkretuar». (III, 139). Kampi i tërë me flamurët e me gjithë plaçkën ranë në dorë të shqiptarëvet. Pas kësaj, përfundon Barleti, Skënderbeu, «u fut në viset armike dhe me plaçkën që u bë i vuri me kënaqësi në vënd dëmet që patën» (po aty).

Kështu u korr edhe kjo fitore e shkëlqyer duke konfirmuar me përfundimin e saj saktësinë e takikës skënderbegjiane dhe lartësinë e trimërisë shqiptare.

## IX

### FJALIMI I SKËNDERBEUT PARA PËRLESHJES ME VENEDIKASIT NË SHKODËR

Gëzimi i fitores kundër Mustafajt u turbullua nga një lufte e brendëshme. Lek Dukagjini vrau me të pabesë Lek Zharinë, kryezotin e Dajës. Principata e Dajës mbeti kështu pa zot dhe sipas një marrëveshjeje, që Lek Zaharia dhe Skënderbeu kishin në mes tyre, trashëgimtar legjitim i saj ishte Skënderbeu. Por Dajën e kërkonte edhe Lek Dukagjini. Më në fund, me ndihmën e disa dajave, atë e pushtoi një ushteri venedikase. Kështu filloi lufta. Skënderbeu, pasi rrethoi Dajën, u nis kundër Shkodrës, ku e priste një ushteri venedikase e përbërë prej italianësh, dalmatësh e shqiptarësh. Para përleshjes, ai u mbajti ushtarëvet këtë fjalë, ku theksohet mbi të gjitha se lufta e tij është e drejtë dhe prandaj e domosdoshme.

«Në është apo jo e drejtë arësyja e luftës që kemi ndërmarrë, o ushtarë, këtë ne nuk do ta linim për ta shqytuar e vendosur sot, që kemi armët në dorë dhe armikun përpara, sidomos, kur e dini se armët jua kam dhënë unë vetë; prej meje s'kini patur kurrrë shkak të ankoheni se kam lejuar të mëren nëpër kömbë të drejtat tona, apo se u kam rënë më qafë kot të tjerëvet. Por, me qenë se ndër të gjitha punët, që duhet të kryhen, një gjë e mundon shpirtin e njerëzvet dhe e shton shqetësimin e ushtarëvet, d.m.th., para se të cveshin pallat dhe të përleshen me kundërshtarin, ta dinë se nga ç'anë është më tepër e drejta... Unë nuk kam kundërshtim, o qytetarë, që, në rast se ju, me gjykatës cilindo prej jush, e dënoni qëllimin tim si të pavënd e mua më quani një inisia-

tor fort të zellshëm lufte, të marrim sytë dhe të ikim menjëherë, sepse unë s'jam nga ata që t'i têrheq njerëzit në rreziqe pa ditur se ç'bëjnë<sup>1)</sup> dhe t'ua filloj grindjeve të reja me venedikasit, në këtë gjëndje stuhie të mbretërisë sime dhe të punëvet të Shqipërisë, për ndonjë qëllim prej kokëngjeshuri. Por qëllimit tonë s'mund t'i bëhet një akuzë e tillë dhe arësyeja e luftës që kemi përpëra duket sheshit që është e drejtë dhe gjithashtu e domosdoshme; prandaj askujt nuk i intereson më shumë se ju të bëni, me trimërinë dhe guximin e paepur, që luftën tuaj ta tregojë edhe më të drejtë vetë përfundimi i saj fatbardhë, se s'ka gjë më të turpëshme, më kundër dinjitetit mbretëror<sup>2)</sup> për burrin trim, se sa të durojë nga frika që të drejtat e tij të shtihen në dorë nga të tjerët, që të rrijsh, siç i thonë fjalës, duar kryq, kur e sheh se gjithë e drejta qëndron në armët.

Ju të gjithë e dini mirë se ç'dashuri e miqësi të madhe kam patur unë gjatë gjithë jetës me Lek Zaharinë, vdekja e të cilin sot, sa mizore, aqë edhe pikëllonjëse, ka ngritur më këmbë gjithë këto ushtëri. Ne, të shtyrë nga dashuria e flaktë që kishim për njeri tjetrin, lidhëm, me pëlqimin tonë të përbashkët, këtë marrëveshje. Kush nga ne të vdiste i pari pa fëmijë, t'i linte tjetrit, që do të mbetej gjallë, mbretërinë për ta patur në bazë të së drejtës së marrëveshjes.—Ai u nda nga kjo jetë më përpëra... Venedikasit kanë shtënë në dorë mbretërinë e tij, kurse unë kam mbetur vetëm trashëgimtar lotësh. Në bazë të kësaj marrëveshjeje, unë hiqnja dikur vetë dorë nga gjëja ime, se vdekja është një fat i zi për të gjithë dhe mund të më kish rrëmbyer mua të parin. Por tani s'kam ndërmënd të heq dorë nga lufta..., apo pasi të kem fituar përsëri të drejtën e zotërimit të Dajës. Asnjeri, që s'e kanë lënë mëntë, nuk do të ma hedhë mua fajin për këtë luftë, që na e imponon një arësyen kaqë fisnikë. Asnjeri nuk do të çuditet për armët e ngritura..., kundër venedikasvet fqinj, sepse ata na detyruan që t'i rrëmbenim me plot të drejtë dhe gati na i dhanë vetë në dorë. Ne kemi zbritur në shesh të luftës kundër armiqsh, që na kanë rënë të parët më qafë. Prandaj përvishuni qëllimit të bukur për të mbrojtur nderin tuaj me besim të patundur në zëmër.

1) Me këtë Barleti thekson nevojën e vetëdijshmërisë në veprim, e cila është bazë e trimërisë etj.

2) D.m.th. kundër dinjitetit të atij që mbretëron, që drejtton një shtet.

Një plaçke mjaft të madhe lufte mund të mendohej se do t'i sillte fitimtarit pushtimi i Dajës, që kemi përpëra. Por asnjë arësyen e tillë, ju lutem, le të mos ju armatosë ju në këtë luftë; arësyet e tillë janë zakonisht dëshira njerëzish lakmitarë dhe shtytje turme të ulët. Burrat trima le t'i nxisë vetëm zegthi i dashurisë për lavdinë e dëshiruar, megjithëse ju do t'i kini të gjitha, po të fitoni sot. Dhe me të vërtetë, po t'i jat pim dërmën këtij armiku, për së shpejti ata të qytetit, të mbetur pa shpresë për aleatët dhe të thyer nga vetë uria, kanë për t'ju pritur si fitimtarët me dyer të hapura. Sa për fitoren veç, unë s'kam ç'tju them juve, burra që jini mësuar të fitoni. Armiku është i ri, e re edhe lavdia. Por a nuk na e kalojnë ne nga numuri venedikasit? Po. Por a mos vallë ju, ngahera më të pakë, nuk e kini patur gjer më sot lavdinë e luftës kundër armikut? Ushtari i shkëlqyer nuk e quan të denjë fitoren, kur nuk shquhet secili, në trimëri dhe kur secili nuk kthehet në shtëpi i mbuluar me lavdi. C'rëndësi ka numuri më i madh i forcavet të tyre? Ata ndryshojnë nga shpirti po ashtu siç ndryshojnë nga gjuha, nga veshja dhe nga praktika e armëvet. Ata janë një ushtëri llum, e përbërë nga iundrina gjithëfarë gjindjesh, ku ilirikë<sup>1)</sup>, italjanë, shqiptarë<sup>2)</sup>, me zakone të ndryshme, ndjekin të pasprovuar po ata flamurë<sup>3)</sup>. Britma e atyre burrave në luftë nuk do të jetë e njëjtë, nxitjet e komandantëve do të shkojnë krejt kot Prandaj, pra, o burra, shporrini që me sulmin e parë dhe shpërndaini këta të gatëshëm më fort për t'u a mbathur se sa për të luftuar, dhe përtëritni me lavdinë e sotme gjithashtu kujtimin e bukur të gjithë atyre fitoreve kundër barbarëvet. Megjithëkëtë, ne duhet të tregojmë një mëri më të përbajtur kundër këtij armiku dhe një zemër më të prirur nga mëshira. Robrit merrini me vehte të dorëzuar, por mos i përlyeni duart tuaja fitimtare, për shkak të çfrenimit të luftës dhe të valës së zemërimit me gjakun e tyre, pasi të janë dorëzuar, sepse nuk e kemi punën me barbarë apo me njerëz të egër, kundër të cilëvet ne luftojmë me të drejtë për të sprapsur dhunën e për të jetuar në paqë». (III, 145-146).

Kjo fjalë e Skënderbeut u bëri përshtyrje të madhe ushtarëvet, i ndezi fort e u dha shkas që të shprehnin mendime

1) D.m.th. sllavë.

2) Shqiptarë (shiko për këtë F. Noli, «Hist. e Skënderbeut», Tiranë 1962, f. 51).

3) D.m.th. janë nën të njëjtën komandë.

të ndryshme e fort të larta, të cilat është mirë t'i dëgjojmë. Ja si shprehët Barleti:

«Me këtë fjale të matur Skënderbeu ua ndezi edhe më tepër dëshirat ushtarëvet dhe i bëri krejt për vehte zëmrat e tyre, sepse me këtë sjellje të pashoqe ai tregonte qartë kujdes je vetëm për të vetët, por edhe për kundërshtarët.<sup>1)</sup> Atëherë u derdhën rreth e rroull tij radhët e ushtërisë dhe po ngrinin në qill qëllimin e kapetanit të vet. Gjithësecili thoshte se ishte gati të luftonte në çdo rast jo vetëm për t'ia ruajtur por edhe për t'ia rritur lavdinë. Armëvet të venedikasvet nuk duhej t'ua kishin aqë shumë frikën, sa që të harronin nderin e vet, duke i mbiçmuar ato. Do të ishte një fyerje për gjithë popullsitë që kishir, nënë vehte, sikur të lihej pas dore pa u shpaguar, për mungesë gatishmërie, turpi i Dajës. Prandaj s'duhej t'i lëshonte zëmra në atë gjëndje të tronditur e në atë luftë të dyfishtë.<sup>2)</sup> Njerëzit s'kishin për të bërë asgjë sikur të ngadalësonin hovin e vet krenar me gjithëfarë arësyetimësh dhe sikur ta matnin çdo punë me anë të menjimit të thatë. **Burrat** trima duhet të jenë të guximshëm, të hidhen në rrezique ballë përpjetë dhe nuk duhet të zmadhojnë frikën, duke shikuar gjithmonë prapa, as duhet të gjykojnë të këqiat, që njeriu s'mund t'i parashikojë, me mëndje të tronditur. Trimëria është gatuar me domosdojën dhe shumë gjëra mposhten ngahera me zëmërimin dhe me furinë e ushtarëvet, kurse një shpirt i qetë e i çkujdesur s'do guxonte të vepronit kështu... i una e Shqipërisë do të ishte mjaft e siguruar nga vetë besimi i fortë dhe bashkimi me zemër i popullsive.

Këto e shumë të tjera si këto përsëriteshin shpesh nga ushtarët pa ndonjë rregull, ashtu siç ia thoshte zemra secilit, dhe me qëllim që me shërbimin e vet t'i hynte në zëmër kapetanit që po i dëgjonte. (III, 146-147).

1) Për robërit e kundërshtarëvet. Ushtëria kundërshtare përbëhej, siç thamë, edhe nga shqiptarë. Këtu Skënderbeu është në fund të fundit kundër vëllavrasjes.

2) Sepse Mustafaj vazhdonte të kërcënonte Skënderbenë, i cili vihet kështu në mes dy zjarresh. Veniku, me sa dihet, ishte në marrëveshje tanë me turqit kundër Skënderbeut, duke dashur të prishë besëlidhjen shqiptare, të arritur në Lezhë. Por Skënderbeu e përbanoi me sukses armikun nga ié dy anët.

## FJALIMI I SKËNDERBEUT DREJTUAR MBROJTËSVE TË SFETIGRADIT

Sultani Murati, kur mori vesh se lufta e Skënderbeut përfundoi me sukses kundër Venedikasvet, se Mustafaj ishte dërmuar në betejën e Oronikut (gusht 1448), duke rënë edhe vetë rob në duar të arbërorëvet, se përpjekjet e tij të gjertanishme kundër Shqipërisë kishin dështuar që të gjitha plotësisht e me dëme të mëdha, për të, vendosi, i xhindosur e i tërbuar nga zemërimi, t'i jepte fund luftës kundër Skënderbeut me një ushtëri të madhe, aqë të madhe, thotë Barleti «sa me zor të mund ta nxërë Shqipëria» (IV, 174). Skënderbeu, i informuar për këtë plan të Muratit, mori të gjitha masat përsigurimin e vendit. «Për rrezikun që kërcënonte gjithëçka», thotë Barleti, «u mendua thellë dhe u veprua me kujdes të plotë» (IV, 176). Ndërsa masat e tjera, ai shkonte edhe nëpër qytetet e vëndit, duke dhënë këshillat e rastit e duke nxitur ushtarët që të qëndronin të patundur e të paepur. Kështu, në Krujë ai u thoshte ushtarëvet, pasi largoi popullsinë në vënde të sigurta: «Të përballonin me besnikëri detyrat e rënda të atdheut, ta sprapsnin qënërisht armikun..., të qëndronin të paepur» etj. (IV, 178). Kështu bëri edhe në Sfetigrad, në qëndër të qytetit, «ku ishin grumbulluar e po turfullonin luftëtarët më të shumë». (IV, 181).

Në këtë fjalim theksohet sidomos vlera e besimit të patundur, e këmbënguljes së guximshme, e kujdesit dhe e mençurisë së madhe, që duhet të karakterizojnë çdo veprim kundër armikut të madh e të paparë ndonjëherë: 150 mijë osë 120 mijë me vetë Muratin në krye, sipas Barletit (IV, 182). 80 mijë sipas F. Nolit (f. 59). Njeriu mund të arrijë gjithëçka, kur mendon e vepron drejt... Edhe këtu spikatin parimet tak-tike të Skënderbeut.

«Ishte e pamundur, o sfetigradas, që t'ju jepej juve sot një rast më i mirë, të jepej për zemrat e flakta, dhe për ushtarët e zjarrtë një rast më i bukur se sa ky që me plot të drejtë ju është dhënë të rrëmbeni tanë armët për ta lënë të vulosur përgjithmonë me shëmbollën e lartë besnikérinë tuaj edhe kundrejt meje edhe kundrejt mbarë Shqipërisë. Gjer tanë ne kemi luftuar përfitoren, për nderin e mbretërisë; tanë ju duhet të luftoni përfitoren, përlirinë, përmuret e atdheut. Tani

ju duhet tē përpinqeni që lavdet, tē cilat i kini merituar nē sa e sa lufta tē kryera me sukses nën udhëheqjen time, tē mos i ktheni nē turp tē madh nga plogështia; dhe nē pjesën më tē madhe, fati i kësaj varet nga Ju, sepse nga ju do t'i fillojë Murati hyrjes pér Shqipëri. Ju, që t'jua them vetë rrezikun që ju pret, do tē ju sulmojë tē parët tèrbimi barbar, me qëllim që pastaj së këndejejmi, si nga një portë e rrënuar e Shqipërisë, t'i lëshohet gjithë vëndit pér ta dëmtuar më lehtë. Me ju do tē fillojë kjo luftë. Ju, nē rast se e kini nē gjoks trimërinë, nē rast se vlugon **ndër burra trima kujtimi** i lirisë, mund t'i dërmori fuqitë dhe t'i thyeni hundët armikut. Nga ju do tē fillojë Otomani edhe tē dridhet, edhe tē shpresojë. Po tē jetë se do t'ju gjejë, kur t'ju godasë, nē një zjarr tē tillë guximi, si kjo furi e pashoqe që shoh tani ndër ju dhe si këto turfullime tē pamasë që po dëgjoj me gëzim prej jush, atëhere do ta zërë frika pér rreziqe kudo më tē mëdha dhe do ta nxjerrë që këndejej mësimin pér t'i mbajtur larg duart nga qytetet e tjerë tē Shqipërisë. Por edhe ju nuk do t'ju ndrydhë pér një kohë tē gjatë me një rrëthim tē kotë, veçse po tē dojë plaku kokëngjeshur<sup>1)</sup> që t'i fishken këtu fuqitë e veta pér një qëllim tē çmëndur. Dhe me tē vërtetë, gjëndja e qytetit eshtë e tillë, e tillë natyra e vëndit, sa tē mundet tē mos e përfillojë kundërshtarit, sado i egërsuar që tē jetë. Prandaj vendoseni, o qytetarë, që këtë fitore tē papërgjakur e gjithashtu tē bukur ta arrini vetëm me **këmbënguljen** e **guximëshme** dhe me besimin e patundur. Nga përfundimi i trimërisë suaj, gjë që unë e përsëris me kënaqësi, varet nē pjesën më tē madhe edhe besimi i popujvet tē tjerë. Mbi ju do t'i kenë sytë tē gjithë që t'ju lavdërojnë, që t'ju shajnë, që t'ju imitojnë më nē fund, si ta kini ndryshuar mbarë fatin e luftës. Dhe me tē vërtetë, ç'hije do t'u kishte burravet trima tē çfajsonin vëten me anë tē fatit dhe tē pashmangësisë së fatkeqësivit njërezo? Me anë tē arësyes merren përsipër e mbarohen punët më tē mëdha. **Eshtë vështirë** që fati ta bëjë mendimin dhe tē mos i shkojë pas trimërisë.<sup>2)</sup> Ju, pastaj, do t'i kini tē gjitha ato gjëra, që mund tē parashikoheshin me gjykimin më tē saktë dhe që mund tē siguroheshin pér ju. As armë, as ushqime, as roje më tē fuqishme nuk mund tē dëshironi më. Tur-

1) Murati, i cili tani ishte plakur.

2) Trimi e krijon vetë fatin etj. Këtu Barleti ngreh edhe një herë mbi fatin fuqinë e mëndjes dhe tē arësyes njërezo.

ma e pavlefshme<sup>1)</sup> e vegjëlisë nuk do t'ju pengojë, britmat e vajshme dhe tē sulurat shqetësonjëse tē fëmijëvet nuk do t'ju largojnë nga detyrat e përbashkëta, nga kujdesi i armëvet dhe nga mbrojtja e atdheut. Unë ju lashë juve vetëm me muret e atdheut, me altarët e me vatrat, me qëllim që ju tē ndizi vetëm nga zegthat e lavdisë dhe tē trimërisë, nga flaka e mundit dhe e rrezikut dhe nga shikimi i njeri tjetrit. Megjithëkëtë, edhe unë së bashku me ushterinë tē armatosur lehtë do tē jem jo larg jush, spektator dhe nxitës i heshtur i trimërisë suaj. Dhe, sadoqë nuk kam ndërmënd t'i bëj ballë gjithë sulmit tē armikut gjakatar dhe fatit tē mbarë luftës nē një betejë frontale nga dëshira e çmëndur pér t'u përlleshur, prapëse-prapë një pjesë tē madhe tē mundimevet tuaja do t'i marr mbi vehte dhe, me sulmet e dëndura, do tē bëj që përpjekjet e kota tē armikut tē dështojnë. Me tē vërtetë, pér ne, asnë mënyrë luftimi nuk eshtë më e mundëshme, asnë taktkë ushtarakë më e sigurtë pér t'u ndjekur nē mes tē një llumi aqë tē madh njerëzish dhe nē mes tē gjithë atyre mijrave luftëtarësh, se sa ajo që tē mos i japim kurrë kundërshtarit mundësinë pér t'u përlleshur, që tē mos hyjmë kurrë nē lojën e rezikëshme<sup>2)</sup>... edhe sikur ta shikojmë fitoren tē sigurtë. Bari, nē fillim, do tē na japë rast pér tē patur sukses, ai do ta ushqeje guximin tonë me gjakun e tē vetëvet, me qëllim që pastaj, pasi tē na ketë embëlsuar dhe tē na i ketë marrë mëntë me përfundimin njëherë fatbardhë, tē na shtjerrë nē kurth e tē na dërmojë më lehtë. Por ne duhet tē bëjmë **me kujdesin** më tē madh e me mënçurinë më tē madhe që dëshirat e prapa tē Otomanit tē dështojnë dhe armiku i panumur tē korret pak e nga pak, sipas rastit që do tē na japë koha dhe vëndi. Pér mua do tē ishte me tē vërtetë e vajtueshme ajo fitore, që do ta paguanja me kërdinë e ushtarëvet tē mij dhe tetë ose dhjetë mijë armiq tē vrarë do t'i quanja, besomëni, më tepër një pamje tē trishtuar se sa tē gëzueshme, sado e vogël që tē ishte humbja juaj. Unë do t'i lavdëroj fort shqiptarët e mij dhe do t'i nderoj si fitimtarë, po tē jetë se nuk do tē lejojnë që tē thyhen nga **mbreti i turqvet**. Çdo gjë tjetër më pëlqen që ta mendoni më mirë ju vetë, o dibranë,

1) Kuptohet: pér luftë, siç janë fëmijët, pleqtë etj. Këta janë sigeruar duke u larguar nga qyteti nē vënde tē tjerë.

2) D.m.th. nē luftën frontale.

ndërmjet jush, se sa t'jua them unë duke ju këshilluar me ngulm, nga një farë dyshimi i heshtur për besnikérinë tuaj. (IV, 180-181).

## XI

### PËRGJIGJA E SKËNDERBEUT MURATIT

Sulltan Murati erdhi në Shqipëri me atë mizéri forcash që shënuam më lart dhe, pasi e mori Sfetigradin jo me trimëri, por me anë të etjes, duke prerë ujin e qytetit (apo duke ndotur pusin me tradhëti, sipas Barletit), erdhi e rrëthoi Krujën. Përpjekjet e Muratit ishin të shuma dhe të paprera, por përfundimi i pritur prej tij s'dukej gjëkundi. Më në fund ai u detyrua t'i propozonte Skënderbeut paqen me konditë që të pranonte të bëhej «tributar i Otomanit», siç thotë Barleti (VI, 275). Për këtë ai zgjodhi «një burrë me shumë autoritet, i cili e kishte emrin Isuf». (VI, 273). Ky, me një fjalim të gjatë dhe gjer diku plot mburrje, e kanosje, u përpoq t'i mbushte mëndjen Skënderbeut dhe shokëve të tij, «sikur të ish e mundur t'u mbushje disi mëndjen atyre njerëzve të lirë me një mënyrë të tillë» (VI, 273-274). Prandaj ai mori përgjigjen që mund të merrte nga këta «njerëz të lirë», përgjigje, që Barleti e pëershkuar ashtu si di ai (VI, 275-276).

«Barbari s'kishte mbaruar akoma, sepse mbledhja u turbullua nga një murmurimë e madhe që dolli prej shumicës, kur dëgjuan t'u përmëndej puna e tributit; s'e mbajtën dot të qeshurit nga gjëzimi i madh që e shikonin Muratin të lodhur tanimë nga armët e tyre dhe si të mundur me luftë. Të tjerët çfrynin mërishtëm dhe thoshin se, me këtë farë pageje, Murati përpiquej t'i shtinte në dorë dhe t'u a vinte një ditë dalëngadalë zgjedhën si tributarë, gjersa s'mundte si kundërshtarë. As edhe një nuk u ndodh që të pëlgente më tepër atë paqë se sa luftën e përherëshme, apo që të thoshte të paktën se duhej menduar për atë gjë. Sa fort u ngrihet morali njerëzvet kur u venë punët mbarë».

Dhe Barleti gjen rastin të këlthasë me admirim për ata trimë: «Hej, medet, ku ka shkuar tani ai shkëlqim i asaj gjindjeje, ajo bujari zëmrash, ajo farë trimërie të pathyeshme? Shikonin arbërorët mbretërinë të copëtuar, qytetet ca të pustuara, ca të rrëthuara, fushat stërgjyshore të mbuluara nga

armët armike, gratë, fëmijët të tretëshin në frikë e lote larg vështrimit të tyre, trupat e të vetëvet t'u shqysheshin para syvet dhe vëndin të gjithë të kulloste gjak, e megjithëkëtë u pëlgente më mirë të dirgjeshin në atë fatkeqësi dhe të mbrojnë lirinë e përgjakur, sadoqë jo krejt fatzezë, se sa t'i jepnin armikut shënjen më të vogël të zëmërlëshimit! Skënderbeu, pra, i patrëmbur në mes tyre, u kthyte nga barbari dhe, për të mos e dërguar tek Murati me dyshim e ankth në zëmër për shkak të përbuzjes,<sup>1)</sup> i tha, pasi pushoi zhurma:

«Kjo dërgatë e jote nuk është shumë e ndryshme nga ajo, që solli dikur, në rast se mbaj mënd, edhe Ajredini,<sup>2)</sup> i cili, që në fillim pothuaj të mbretërim tonë, kërkoi në emër të Otonanit me letra, të sjella nergut për këtë punë, disa qytete të Shqipërisë dhe një pjesë të Maqedhonisë. Prandaj unë besoj se mjafton përgjigja që muarët atëhere një herë e për gjithmonë, sepse më duket që as fati ynë s'ka rënë aqë poshtë, as juaji s'është ngritur aqë lart, sa që të mund të na i parashtroni sot këto kushte të reja me nder. Sa për humbjen e qytetit të Sfetigradit, përrënimin e murevet të Krujës dhe për shkatërimin e gjithëçkaje në fushë, siç i numurove ti me radhë, ne zor se i quajmë këto humbje; vetëm të jenë gjallë këta kapetanë, të jenë shëndoshë e mirë ushtëria jonë dhe populli ynë; gjithëçka tjetër që na ka humbur, ne do ta kemi, përsëri, besomë mua: gjithë shkatërrimet do t'i vëmë rishtas në vënd. Këto punë të dorës së njerëzvet kështu e kanë, lehtë bëhen e lehtë prishen mjafton që të mos mungojnë mjeshtërit e zotë, duart e forta.

Por thuajmë, të lutem, meqë ju ardhka mirë t'i numuroni humbjet tona, sa ju kanë kushtuar juve këto gjer më sot? Sa ju ka kushtuar humbja e Sfetigradit, megjithëse ne e humbëm atë jo për trimërinë tuaj, por për besimin e kotë<sup>3)</sup> të qytetarëvet? Sa gjak ju ka qëndruar rrëthimi i Krujës? Mbahuni, pra, s'jua kam aspak zilinë. Trima të tillë, me fat të tillë qofshi në shekuj të shekujvet; kështu i pafsha flamujt tuaj

1) Barbari, Isufi, do ta ndjente më thellë përbuzjen, sikur të më përgjigjej Skënderbeu.

2) Eshtë i dërguar i Muratit, i cili i propozoi paqen Skënderbeut që në vitin 1444 (III, 128-129). Skënderbeu ia dha atëhere përgjigjen me letërën e tij, që shënuam më lart.

3) Sipas Barletit, (V, 221-225), Sfetigradi iu dorëzua Muratit nga dibrantë, të cilët e quanin koh të madh të pinin ujin e prishur të pusit nga një qën i ngordhur që e hodhi në pus një tradhëtar.

në Shqipëri. Rrethoini qytetet, sulmoini, suljuni aravet, shkatorni çdo gjë frutore... gjersa lini gjurmë të tillë të fatit tuaj, përmendore të tillë të trimërisë dhe burrërisë suaj<sup>1)</sup>. Prandaj për ne, do të kishte më tepër dobi që t'ju luteshim të mos largoheshit, se sa ta blinim largimin tuaj me atë pare.<sup>2)</sup> Mos ndodhtë, sa të jetë gjallë Skënderbeu, që ta shohë apo ta dëgjojë kush tributare tuajën këtë krahinë. Jo, nuk do të lejonja, edhe sikur të na kthenit gjithë Maqedhoninë dhe gjithë selitë e etërvet tanë, edhe sikur Otomani ta ndante me mua mbretërinë e tij, nuk do të lejonja që të njollosej me këtë turp emri shqipëtar. Prandaj më kot na i grumbullove këtu gjithë ato shëmbëlla të huajsh, më kot na përshkrove fatin e zi të Peloponezit dhe skllavërinë e Azisë dhe të të tjerëve, sepse s'ka asnjë shëmbëll aqë të fuqishme, sa që të mund ta tërheqë shpirtin e lirë në një turp të tillë». (VI, 276).

## XII

### FJALIMI I SKENDERBEUT PASI DÉRMOI MURATIN

Sulltan Muratit përgjigja e Skënderbeut, të cilën ia shpuri i dërguari i tij, Isufi, në çadrat, të vendosura «në Tiranë të vogël», ia shtoi shumë «hidhërinë dhe smundjen<sup>3)</sup> prej pikëllimit» (VI, 277). Duke parë, pra, se përpjekjet e tij të vazduara shkonin kot, u detyrua pas humbjesh të kërdishme të largohej nga kryekështjella e Arbërisë i turpëruar ose, sipas Barletit (VI, 281), i ngarkuar në qivurin e vdekjes. I biri dhe pasardhësi i tij, Mehmeti II, i zënë me punët e fronit dhe me andralla të tjera gjetkë, e la Shqipërinë për pak kohë të qetë. Skënderbeu, i cili nuk linte pa shfrytëzuar asnjë rast të mirë për të plotësuar gjer në fund qëllimin e tij të shenjtë e të lartë, — çlirimin e plotë të vëndit dhe rikrijimin e gjendjes së dikurshme të Shqipërisë apo ringjalljen e shekujuvet «aqë të dëshiruar të të parëvet» (VII, 295) pasi mbaroi punë me rindërtimin e qytetevet dhe të murevet të dëmtuara, pasi

1) Thuhet me ironi të bukur.

2) Me tributin, që do t'i paguante Muratit.

3) Sipas Barletit, Murati ishte i sëmurë dhe vdiq rrëzë mureve të Krujës nga pikëllimi i madh, që i shkaktonin fitoret e Skënderbeut (VI, 272, 281).

ndërtoi edhe një kështjellë të re në Modrisë, vendosi të marshonte kundër Sfetigradit ose Beratit për t'i çliruar. Për këtë ai bëri një mbledhje në Krujë, ku u kthyte pas një ekspedite në viset armike dhe ku parashtri planet e tij. Barleti thotë tekstualisht kështu:

«Me të ardhur në qytet, Skënderbeu, duke dashur që të bënte ndonjë gjë të shënuar dhe t'i zgjeronte, po të mundte, në atë gjëndje të punëvet dhe në ato andralla të Tiranit, kufitë e mbretërisë së vet, thirri menjëherë parinë që ndodhej atje dhe disa nga radhët e ushtrisë dhe filloj të fliste para tyre dhe të shprehte mendimet e mëposhtëme për nevojat e luftrës dhe llojin e detyravet, që duheshin bërë». (VII, 294-295).

Mendimet dhe detyrat, që shpreh Skënderbeu këtu, janë nga më të lartat. Ai thotë se «burri trim duhet të dijë të përfitojë nga rasti», se arbërorët tani duhet «të ringjallin shekujt aqë të dëshiruar të të parëvet»... Me këto detyra do të shpëtojnë edhe rininë nga plogështia dhe përtacia dhe këtë ai e quan «gjënë më të bukur». Me një fjalë, detyra e tyre ndaj lirisë së atdheut kërkon që ata të vërtiten në mes të djersës dhe të gjakut dhe jo të rrinë në qetësi e plogështi, gjersa ato heu s'është çliruar i téri dhe rreziku s'është larguar krejtësisht. Konkretisht, ai propozon që të marshojnë në drejtim të Sfetigradit ose të Beratit për t'i çliruar nga zgjedha turke, megjithëse ishte duke afëruar dimri.

Kështu edhe në këtë fjalim, i cili nuk është i gjatë, shprehë si duhet, me stilin karakteristik të Barletit tonë të zjarrtë, tiparet dhe aspiratat më të larta e më të ndritura të popullit tonë dhe tregohet mbi të gjitha roli primar i tij në vepren e madhërishme të Skënderbeut, baza e saj popullore, kur kryetrimi ynë, ky «Kapedan popullor», u thotë të pranishmëvet: «Unë nga ana ime s'guxoj t'ju zotohem për asgjë pa mundin dhe djersën tuaj». Ja fjalë e tij:

\* \* \* \* \*

«Mjaft më, mendoj, kapedanë dhe ushtarë kryetima, kemi pushuar gjer më sot larg armëvet, larg luftës dhe vetë trimërisë, të dhënë pas dasmës së pazakonëshme<sup>4)</sup>, mjaft e kemi festuar fitoren kundër Muratit, duke kaluar kohën me argëtime private dhe publike dhe me rindërtime e ndërtime qytetesh të reja. Ka kaluar një vit tani, që kurse unë po vyskem në plogështi si kurrrë ndonjëherë, që kurse ne s'kemi parë ndonjë armik me sy dhe s'kemi dhënë ndonjë provë trimë-

4) Skënderbeu ish martuar në pranverë të vitit 1451, pasi dërmoi Muratin në rrëhimin e parë të Krujës (1450).

rie. Dhe thuajse një mënyrë e tillë gati jete ju pret, në qoftë se nuk do të frysëzohi nga mendime të tjera dhe nuk do të doni të përfitonit nga rasti i fatit të mirë, që na është paraqitur përmes qëllime më të mira. Dhe me të vërtetë, Barbari, i zënë, siç e kini marë vesh, me luftën persane,<sup>1)</sup> e ka harruar Shqipërinë, na ka harruar ne bashkë me armiq të tjerë. Paqja dhe pushimi kanë mbetur përmes ju, që t'i gjëzon sa të doni. Por a ka gjë më të turpshme përmes burrat trima se sa të mos dinë të përfitojnë nga rasti, gjë përmes cilën sidomos njerëzit duhet të jepin llogari? Për kundrazi, rasti i mirë duhet të na nxisë përmes rrëmbyer armët, përmes ndërmarrë edhe punët më të vështira, kur armiku është i zënë gjetkë, kur, më mirë të themi, juve ju janë hapur rrugët përmes ku të doni, pa derdhur pikën e gjakut.

Dy janë kryesisht rastet përmes sukses në luftë; kur armikun e shikon ose të zënë me të tjerë, ose të dërmuar. Se në ç'gjëndje ndodhen punët e Mehmetit, këtë, pa patur nevojë t'i bësojmë tjetër kujt, na e tregoi delegacioni<sup>2)</sup> i tij që sapo u largua. Tribut na kërkoi, i pabesi, që, po t'ia jepnin, do të na sillte paqen me kënaqësinë më të madhe. Ne ia mohuam me guxim të gjitha. Tani na mbetet të tregojmë se me ç'mendim, me ç'qëllim ia mohuam, apo mos duhet ta durojmë kështu përgjithmonë humbjen e Svetigradit? A mos duhen gjallitit gjithë ato dëme, gjithë ato shkatërrime, që kemi pësuar nga Murati? Ku vanë kërcënimet tona krenare, planet tona të mëdha dhe aspiratat e larta?... Gjer ku i kemi përzënë turqit me bisedime të kota ndërmjet nesh? Vonë me këtë mënyrë, kemi përmes vënës në vend ndërin e dikurshëm të Arbërit, vonë kemi përmes ta fituar lirinë<sup>3)</sup> dhe përmes ringjallur shekujt që të dëshiruar të të parëvet tanë, përkundrazi, ne po humbasim përmes ditës diçka nga ato që kemi, gjersë nuk mendojmë jo vetëm të zmadhojmë mbretërinë tonë, por as të marrim hakun përgjithë këto fatkeqësi.

Por ç'është e vërteta, planet tona i ka penguar gjer tanë nevoja, i kanë penguar zjarre më të mëdhenj dhe çaste ngjarjesh nga më të vështirat. Tani duhet përpjekur, ushtarë, që të mos na i pengojë ato plogështia dhe pakujdesia jonë. Armiku duhet kërkuar dikur, duhet kërkuar me ngulm e nuk

1) Lajme thonin se Mehmeti ishte në luftë me Beratit.

2) Murati kish dërguar një delegacion, i cili i propozoi Skënderbeut paqë me kusht që t'i paguante sulltanit tribut etj. (shiko: VI, 274-275).

3) D.m.th. lirinë e gjithë Shqipërisë.

duhet pritur ngahera, mjaftron që ju të doni, të dëshironi. Arsyet përmes ta vënë në veprim trimërinë nuk na mungojnë, as rasti përmes një lavdi fort të madhe. Ja, Svetigradi prej kohës së shumës, ndoshta, rrëthimi i vitit të kaluar dhe përfundimi i keq që patëm; por unë s'kam ndërmënd që t'ju hedh në një stërmundim si ai dhe në një rrezik aqë të dukeshëm; nga ana tjetër, besoj se e kanë pakësuar shumë vështirësinë në këtë rast gjithë ato fitore tonë, vetë vdekja e Muratit dëgjëndja e tanishme e armiqvet. Veç kësaj, nuk do t'ju mungojnë përdredhoret e çdo lloji dhe mjetet e tjera, të cilat do të bëjnë që afrimi i juaj përmes qytet kundër armikut të kryhet, sa të jetë e mundur më tepër, pa derdhur gjak. Sa përmes tjerat, do të na mësojë vetë çasti dhe armiku, kur ta kemi përpëra. Unë nga ana ime s'guxoj t'ju zotohem përmes asgjës, pa mundin dhe gjakun tuaj<sup>4)</sup>. Dhe burri trim e bën këtë sakrifisë e s'do t'ia dijë; aqë më pak i trëmbet para se ta bëjë.

Por, në qoftë se ju ia kini aqë fort frikën Svetigradit, jo larg janë qytete dhe kështjella të tjera të armiqvet, me të cilat mund të vihet në vend ky dëm dhe të përbushet dëshira jonë. Në një largësi të barabartë që këndeje dhe, ndoshta, më të vogël se sa Svetigradi, ndodhet qyteti i Belgradit,<sup>2)</sup> siqurisht jo i padenjë përmes dështimit dhe gjakun tonë, po të mbajmë parasysh shpërblymet dhe lavdinë. Më tepër se kujt do duhet të më vijë turp mua, sepse po mbushet viti tani që po komandoj këtu bashkë me ju dhe po i shikoj gjithë ato seli të të parëvet tanë, gjithë ato qytete të njerëzve të një gjaku me ne dhe gjitha ato stolira të mbretërisë shqiptare, përmes që kemi pësuar, përmes fatkeqësitet e juaja dhe ç'ka unë e quaj gjënë më të bukur, do të shpëtojë nga plogështia dhe përtacia. Unë do të mendonja se do të na duhej të marrshonim edhe sikur të mos kishim përmes bérë gjë, se do të na duhej më mirë të marrshonim, se sa të svetërojmë shpirtin e ushtarëvet duke luftuar me fshatarët kufitarë dhe me bagëtinë... Papa, Alfonsi<sup>3)</sup> e sa e sa princër... gjithë atë pare e

1) Me këtë shprehje Barleti vë në dukje rolin primar të masave, të popullit, në veprën vigane të Skënderbeut.

2) Beratit.

3) Mbreti i Napolit, me të cilin Skënderbeu kish miqësi.

gjithë ato dhurata shumë të mëdha nuk na i dërguan që të rrimë në shtëpi dhe ta kalojmë kohën pa bërë gjë, me gos-tira, në mes këngësh e dëfrimesh dasmore, por që, të armatosur me përkrenare, të vërtitemi në mes të djersës dhe të gjakut» (VII, 295-296).

«Këto fjalë të zjarra të Skënderbeut», thotë Barleti, «nuk i pasoi si zakonisht brohoritja e menjëherëshme e të pranishmëvet... kështu që dukej qartë se zëmrat e tyre nuk puqeshin me vullnetin e tij». Me gjithë këtë «asnjeri s'guxonte, duke shikuar njeri tjetrin, të nxirrte zë nga turpi për të kundërshtuar dhe njëkohësisht për të mos u quajtur më përtac dhe më frikacak se të tjerët» (VII, 296). Arësyet e këtij qëndrimi, pra, të të pranishmëvet nuk janë as frika, as plogështia, por të tjera, objektive, të cilat i pranon më në fund edhe vetë Skënderbeu. Këto arësyet i parashtoi atëhere me forcë bindëse e me dashuri e besim të pakufishëm ndaj kryetimit Vranakontit, i cili u ngrit e tha:

«Ne, o kapedan shumë i sprovuar, që të ta rrëfej unë i pari arësyen e kësaj plogështie, na detyron t'u largohemi me kaqë turp planevet të tua jo ndonjë frikë, as ndonjë ligësh-tim zëmre, as fati i zi i Sfetigradit, që provuam, por vetëm stina e vitit, nga e cila varet zakonisht pjesa më e madhe e punëvet që duhen bërë, stina, them, na këshillon të mos e bëjmë këtë. Ja, pak kohë mbetet nga vjeshta; zor të mble-dhim ushtarë, zor të plotësojmë nevojat e tjera për rrëthim dhe t'u afrohemë murevet, sepse koha e keqe e dimrit do të na mbështjellë me një tok të papritura. Me qellin do të na duhet të luftojmë, me tokën. Shirat, akulli, dëbora do ta pen-gojnë ushterinë... për lavdi dhe do të mbrojnë armikun. Dhe me të vërtetë kjo stinë, megjithëse e papërshtatur për çdo gjë, dëmton sidomos rrëthimin e qytetevet, sepse pengesat që sjell nuk janë të njëjtë për ne dhe për kundërshtarët. Ata do të luftojnë me ne të mbyllur brenda murevet dhe të mbrojtur nga forcomat dhe me njerën dorë do të na godasin, me tjet-rën do të ripërtërijnë me lehtësi fuqitë e tyre, sepse çdo gjë e kanë me shumicë të madhe. Neve, përkundrazi, do të na duhet të përdorim vetëm këmbënguljen tonë dhe guximin, sepse, sa për përdredhoret, ne e pamë mirë, në Sfetigrad e në qytete të tjerë, se sa pak rëndësi kanë, dhe sigurisht, në kohë dimri, ato fare pak rëndësi do të kenë. Prandaj unë mendoj se ne duhet t'u largohemi këtyre përpjekjeve të kota dhe kërdisë së ushtarëvet dhe se burrat trima duhet ta presin kohën si lundërtarët. Ky vonim nuk e ul aspak guximin tonë, as

shton atë të armikut. Sa për luftën persane, në më lejohet të shpreh atë që mendoj, unë fare pak shpresë kam sot në të, sepse ose do të jetë puna vetëm për një lajm të kotë të asaj lufte, ose persët do t'i shtyjnë gatitjet e saj për një stinë më të përshtatur. Por, në qoftë se ty të duket mendimi yt më për nder e dobi të të gjithëvet, ne nuk dalim kundër planevet të tua. Ne do të të ndjekim me gjithë zemër kudo që të na shpiken. Fjalët, veprat, vetë kohën do t'ia përshtatim vullnetit tënd. Me ty e lehtë do të jetë për ne dëbora, i butë dimri dhe e ëmbël fort gjithëçka dhe as mundimet, as vësh-tirësitë, as ndonjë lloj rreziku s'ka për të na rënduar nën udhëheqjen tënde» (VII, 296-297).

Kjo përgjigje e urtë dhe burrëore e Vranakontit, e cila përfundon me shprehjen e besimit dhe të dashurisë së pakufi ndaj kryetimit, e bëri Skënderbeun ta shtyjë fushatën për më vonë, duke i u bindur me gjithë qef dëshirës dhe gjykimit të bashkëluftëtarëvet, «si popullor që ishte». Barleti thotë fjalë për fjalë kështu: «Kastrioti s'e pati zor, kur vuri re dëshirën e të vetëvet, të anonte nga ky mendim, si popullor që ishte dhe sidomos, sepse shikonte se shumë gjëra nga ato që u thanë ishin të vërteta. Prandaj e shpërndau mbledhjen dhe ushterinë dhe i la të gjithë të lirë të ktheheshin në shtëpi, ndërsa ai vetë bashkë me Hamzanë dhe me pak kalorës shkoi në Petralbë»<sup>1)</sup> (VII, 297).

### XIII

#### FJALIMI I SKËNDERBEUT PARA BETEJËS SË POLOGUT

Sulltan Mehmeti, pasi mbaroi punë me andrallat e tij gjekë, i u drejtua Shqipërisë, ashtu siç e kishte thënë Vranakonti. 12 mijë kalorës të zgjedhur me Hamza Pashën në krye erdhën e u futën në luginën e Mokrës në vitin 1452, me qëllim që të pushtonin kështjellën e Modrisës dhe të futeshin së andejmi në pjesët më të brendëshme të Shqipërisë. Por Skënderbeu, i cili ishte lajmëruar mirë për këto veprime të armikut dhe kishte zënë me ushtëri, në heshtjen më të madhe dhe pa gdhirë ende mirë, një anë të Modrisës, «u lëshua», pasi u dha shënja e u ngrit një britmë vigane, «si ndonjë rrebesh

1) Gur i Bardhë, në Mat.

mbi kuajt e burrat gati të këputur dhe i dërmoi e i sheshoi- (VII, 298). Kërdia qe e madhe: «u zunë të gjithë flamurët ushtarë; 7 mijë u gjetën të vrarë, kurse kuajt, në pjesën më të madhe, të shpuar e të prishur». (VII, 299). Vetë Hamza Pasha u zu rob. Skënderbeu u kthyte fitimtar në Krujë, ku u prit me gëzim e brohorë nga populli sidomos, sepse kjo fitore e parë kundër Mehmetit të egër ishte një ugur i mbarë +se ai kundër shqiptarëvet me Skënderbeun në krye do të pësonte të njëjtin fat që pësoi edhe i ati» (VII, 299). Dhe populli s'u gënjeve në gjykimin e tij: Mehmeti, me përjashtim të Beratit, hëngri kurdoherë dru nga Skënderbeu dhe populli ynë.

Një vit më vonë, më 1453, vjen kundër Shqipërisë një ushteri e re prej 15 mijë. Skënderbeu nuk priti që ajo të futej në Shqipëri, por e sulmoi në fushën e Pologut. Para se të hidhej në sulm, ai u foli kështu ushtarëvet:

«Sa turp, ushtarë! robërit tuaj paskan marrë zemër, paskan rrëmbyer përsëri kundër jush armët! Na paskan ardhur mbeturinat e mbuluara me turp të ushtërisë hamziane, të pikëlluara dhe tërë ankime kundër jush se s'paski qënë miq të mirë sofre, sepse miku më i mirë i sofrës do të ishte atëhere, kur të mos linte asnje thërrime<sup>1)</sup>. Por, me sa shoh, paska ardhur edhe ushteri e re<sup>2)</sup> me kapetan të ri: E ç'gjë tjetër veçse një lavdi e re<sup>3)</sup>. Nuk do t'ju them, «bjeruni» o shqiptarë, por «lidhini», ashtu siç e kini zakon, që të mos thonë këta armiq se nuk i mundet ju, por Modrisa dhe luginat e Mokrës, në rast se neve sot na ikën nga duart, për shkak të zemërlëshimit apo të plogështisë sonë, ai fat i bukur që kemi patur prej një kohe aqë të gjatë dhe tanë së fundi. Në shesh të hapur, në fushë jemi, sheshit le të duket trimëria. Hall këmbësorësh, që t'ju vonojnë, që t'ju pengojë, s'kini. Të gjithë jemi fare të lirë; asgjë s'kemi përvëç shpatës dhe armiqvet, nënumur, ndoshta, më të shumë. Por, në mos u gabofsha në shpresat e mia, ju do t'i numëroni më mirë vetë të shtrirë, si kontrollorë të zellshëm të trimërisë suaj». (VII, 304).

Edhe në këtë betejë, e cila bëhet në fushë të hapur dhe jo në gryka e lugina, Skënderbeu u mbulua me lavdi të madhe.

1) Skënderbeu bën shaka të bukur, duke e krahasuar luftën me një gasti. Ushtarët trima s'duhet të lënë gjurmë armiku të gjallë. Mbeturinat e ushtërisë turke i krahason me mbeturinat tryze.

2) Në këtë ushteri bëjnë pjesë përvëç forcavet që shpëtuan në betejën e Modrisës dhe robërvet që u lëshuan nga Skënderbeu, edhe forca të reja me kapetan të ri.

3) D.m.th. një fitore e re. Me këtë shpreh besimin në fitoren.

Barleti na thotë se vetë armiqtë, duke marrë parasysh pikërisht faktin që lufta u zhvillua në kondita vëndi të barabarta për të dy palët, «pa e thënë me gojë, por të detyruar nga nevoja», arrinin gjer atje, sa të pohonin «se fuqia e tanëvet ishte e pathyeshme». Kurse Mehmeti, «që ishte tronditur fort nga mbrekullia e asaj lufte, shtangu nga një farë habie që s'e la pa i shtënë frikën». (VII, 308).

#### XIV

### FJALIMI I SKËNDERBEUT PARA FUSHATËS PËR CLIRIMIN E BERATIT

Nga mezi i verës 1455 Skënderbeu, duke mbajtur gjithmonë parasysh qëllimin dhe aspiratat e larta të popullit të vet për clirimin e gjithë Shqipërisë, organizoi fushatën kundër Beratit. Para se të nisej, ai u mbah ushtarëvet këtë fjalm, në të cilin thekson nevojën e kësaj ndërmarrjeje clirimtare, shpreh besimin në trimërinë, mënçurinë dhe urtësinë e tyre dhe i siguron me çdo mënyrë përfitoren. Por, siç dihet, parashikimet këtu nuk u vërtetuan dhe ushtëritë e Skënderbeut u tërroqën me humbje, por jo pa luftuar trimërisht: «Skënderbeu kishte dhënë prova që zor t'u besonje» (VII, 333), thotë Barleti, në këtë luftë, prova «të një trupi gati hyjnor dhetë një trimërie të pathyeshme». Populli nuk e humbi aspak besimin ndaj tij, përkundrazi, ai besonte se, me praninë e Skënderbeut, mund të ngjalleshin edhe të vdekurit» (VIII, 338), ndërsa vetë Skënderbeu ishte i sigurt se forcat e tij ishin të mjafta «për ta kaluar gjithë lavdinë e mëparëshme» (VIII, 341).

Ja fjala e tij:

«Ky është i njëmbëdhjeti vit, o ushtarë, që ne s'bëjmë asgjë tjetër, siç e shikon, veçse përpjekje përfitës<sup>1)</sup> në Shqipëri, përfitës dituar vatrat e të parëvet, përfitës shtënë përsëri në dorë dhe përfitës mos e lëshuar më zotërimin e atdheut,... Tani më në fund ju duhet të orvateni e të bëni çmos që të mos mbetet më këmbë armiku këtu, që frenë dhe zgjedhën, të cilat me aqë lavdi, pas sa e sa luftrash të rre-

1) Lufta e madhërishme, titanike, e Skënderbeut bëhej përfitës vdekje. Pas vdekjes së tij, shumë e lanë atdheun e dashur, duke u shpërndarë në dhe të huaj, si edhe vetë Barleti. Përfitës largimin e kësaj mënyyre kombëtare luftonte kryetimi ynë legjendar në krye të popullit të tij.

zikëshme dhe vuajtjesh plot mundime, i flakët tek, t'ua vini edhe më me lavdi të tjerëve, atyre që ju patën vënë. Por, ne na pengoftë fati ynë që t'ia arrijmë kësaj, të pakën të tregoni se juve ju patën munguar fuqitë, por jo **guximi** dhe **shpirti këmbëngulës**. Prova të tilla të mjafta, ndoshta, përkëtë, ju i kini dhënë gjithë botës dikur edhe më parë, në kohë të Muratit, që unë e kujtoj me kënaqësi dhe kur ju, duke harruar... prindërit, gratë, fëmijët, qetësinë, rehatinë, dhe gjithëçka tjetër, **përveç** nderit që s'vihet me gjë dhe lirisë së **padhunueshme**, ja hodhët atij poshtë, si të ishin më të fëlliturat, kushtet e një paqeje jo të pandershme. As Tirani fort gjakatar, që kishit para syvet, as ushtëria e tij aqë e tmeruar, që s'ju hiqej nga mëndja, s'mundën të tronditnin zëmrat tuaja krenare dhe gjokset kushtuar për gjithëmonë lirisë, të vendosur që ja të binit si askush së bashku me lirinë, ja ta shtrëngonit atë armik aqë të madh të pranonte me përdhunë fitoren tuaj të shkëlqyer... ne të gjithë e pamë fare qartë se si Murati, në të njëjtën kohë pothuaj, mënjanë kërkonte tribute dhe m'anë tjetër po jepete shpirt për gëzimin tonë dhe të sa e sa njerëzve në botë. Atëhere Shqipëria u la dhe mbeti në dorë tonë, atëhere ne patëm me të vërtetë shënjën ugurmbarë të lirisë, së cilës i duhej ngjitur<sup>1)</sup> pas me plot dëshirë, dhe atëhere, duke shkelur nëpër atë gjak ende të freskët, duhej ndërmarrë ky triumf, që po gatisin tani, dhe duhej madhuar lavdia juaj.

Po pse qahemi për punë të shkuara, sidomos kur ato mund edhe të përligjen me të drejtë? Sot ndoshta ju pret një lavdi më e madhe; fitime më të mëdha ju presin, sepse për ju janë ruajtur. Juve ju ka ecur fati jo vetëm kundër t'et<sup>2)</sup>, por edhe kundër të birit. Mbreti i ri e ka dhënë tani provën edhe të guximit,... ashtu siç juva desh zëmra juve. Tribut na kërkoi së pari ky prijes i shquar<sup>3)</sup>, i stërvitur sigurisht mjaft nga shëmbëlla që pat më shtëpi<sup>4)</sup> prej armëvet tuaja, dhe me njerën dorë pothuaj mbante qivurin e t'et, me tjetrën lypte paqën prej jush. Këtë paqë, megjithëse të kërkuar nën mbulesën e nderuar të tributit, ai mund ta kish vetëm po t'ia jepnit ju dhe ashtu si t'ia jepnit ju.

1) Skënderbeu ankohet dhe gjer diku qorton për planin që propozoi, por që s'u vu menjëherë në zbatim, duke u shtyrë për tanë në pranverë.

2) Murati II.

3) Thuhet me ironi.

4) Nga kërkesa që bëri Murati, i thyer nga armët e Skënderbeut.

Dikush mund të thotë se Tirani e kurdisi atë plan për shkak të luftavet persane, jo nga frika. C'mund të them unë përkëtë? Pamvarësish se a e pati nga frika apo e kurdisi, ju kishit për t'ia hedhur kërkësën poshtë me po atë guxim dhe me po atë qëndresë. Dhe me të vërtetë, kështu nga ju, ju ja hodhët poshtë të gjitha dhe asnjeri s'është i penduar përkëtë. Pastaj Mehmeti deshi ta nxirrte atë tribut i armatosur; ai lëshoi për tek ju tagrambledhësit<sup>5)</sup> dhe ju ia paguat përbukuri, ia numëruat tributin, që kërkonte me aqë dëshirë, në lugnat e Mokrës, ia numëruat, para pak kohe, në fushën e Pologut. Ku është, ju lutem, ku është ajo koka e Debresë<sup>6)</sup>, e mbytur ende në gjak të freskët? Ky do t'ishte një flamur për ju që duhej ta shpinit dhe ta ngulnit para portavet të Belgradit<sup>7)</sup>.

Këto të gjitha duhet të vlejnë shumë për t'ju dhënë zemër dhe krahë; sa për të tjerat, që kanë të bëjnë me luftën, koha dhe vendi do të na i mësojnë si jo më mirë. Prandaj askush të mos më nxjerrë si kundërshkak as «gatitjet më të mëdha të armiqvet, as ardhjen tmerronjëse të Otomanit. Kur të jetë nevoja për armët, ne, me to në dorë, do t'u bëjmë ballë rreptë dhe me zemër të patrëmbur. Kur të jetë puna për mënçuri dhe urtësi, ne s'do të kërkojmë, të shtyrë nga lakkia e çmëndur për lavdi, që të fitojmë emër me kërdinë tonë. Asnjeri nuk do të mundë të na nxjerrë fajtorë daç po luftuam, daç po ikëm, në qoftë se ia fillojmë më rregull, si mund ta mbani mënd se si vepruam në rrëthimin e Sfetigradit. Ne e rrëthuam atëhere qytetin dhe u shkakëtuam vuajtje të rrëthuarvet, gjersa e patëm lehtë këtë punë; por, kur lajmet për ardhjen e Muratit po bëheshin përherë dhe më të dëndura, ne s'e lamë vehten sa të na rrëthonin, unë jo vetëm që s'prita sa të vinte armiku i panumur, por s'ka dyshim se s'prita as sa të bëhej rrëthimi më i dëmshëm për ju se sa për të rrëthuarit<sup>8)</sup>.

Me të njëjtën mënyrë duhet ta bëjmë ne edhe rrëthimin e Belgradit<sup>9)</sup> dhe kështu do ta bëjmë, me sa do të varet nga mëndja jonë si njerëz. Katër do t'i bëjmë sytë rrëth mure-

1) D.m.th. ushtërisë që dërgoi për të pushtuar Shqipërinë.

2) Debrea: Kapedani turk në fushën e Pologut.

3) Berati.

4) Sepse, po të pritni pa ikur me njëherë e sa të vinte Murati, do të rrëthoheshin vetë e do të viheshin në mes dy zjarreve.

5) Belgradi = Berati.

vet, me kujdesin më të madh do të ruajmë se mos na vijnë armiqjtë, kështu që ju të jeni të siguruar prapa shpine dhe të luftoni pa asnje frikë. Po erdhën, ne ose do t'u lëshojmë rrugë, ose do t'i përballojmë, si ta sjellë rasti dhe si ta dojë puna, si ta vendosni ju vetë. Gjithë planin e rrethimit ne do t'ia përshtatim dëshirës suaj. Në qoftë se... këmbëngulja e armiqvet do të na mbajë me shpresë apo me rrena për të zgjatur, ne s'do të plakemi për këtë rrëzë murevet; në mos na detyroftë ndonjë arësy e rëndë për ta vazhduar luftën apo në mos na shpëntë gjetkë, rrethimi ynë do marrë fund bashkë me vjeshtën. Por as trimëria juaj s'ka për ta pritur vjeshtën, as unë s'kam për t'ju kthyer juve, në qofshi burra, pa lavdi dhe duar zbrazur në shtëpi, sepse, besa besën çdo të bëjnë gjithë këta krahë, gjithë kjo teknikë mjeshtërore dhe gatitje luftarake, që kemi kundër tyre? Çdo të bëjë kjo lule mbretërore<sup>1)</sup>, ajkë ushterie, e zgjedhur thuajse nga gjithë Apulia, që ju është dërguar juve ose, më mirë, që ka marrë rrugën e mërgimit dhe ka ardhur në Shqipëri për këtë çështje? Të gjitha këto duhen peshuar mirë nga ju, ushtarë, me urtësinë më të madhe, duhet patur qartë parasysh arësyja e tyre dhe duhet vënë kështu në vend të paktën humbja e Sfetigradit, e Shqiptarve. Ne s'kërkojmë ndonjë gjë të huaj, s'përpinqemi për lavde të reja, por që të na kthehet trashëgimia e vjetër<sup>2)</sup> dhe të na lahet turpi i ri<sup>3)</sup>, e jo vetëm neve, por thuajse gjithë shqiptarëvet. Mos vallë ky qytet nuk është... i njerrëzvet të një gjaku me ju? Të gjithë pothuaj<sup>4)</sup> e mbanë mënd se pas vdekjes së Theodor Koronës, që mbretëronte n'atë vënd, Murati, i cili ia kish vënë që më parë synë, e shtiu atë në dorë bashkë me qytete të tjerë me dhëlpëri të urryer. Me sa mar vesh, qyteti është akoma plot me banorë të dikurshëm. Këto rrethana, në mos gabohem, do t'ju japin dorë shumë përpjekjevet tona, armiku do të sulmohet nga brënda dhe nga jashtë dhe juve ju pret ndoshta fitorja pa pikë gjaku. Ata presin çlirimin dhe përkrahësin e planit të tyre. Të zhytur në errësirë të pafund, do të vrapijnë menjëherë tërë zjarr drejt dritës, që do t'ju shpini ju dhe drejt emrit të lirise, që do të dëgjojnë. Përpara, pra, shkojuni në ndihmë atyre, që po presin trimërinë tuaj. Me të madhe krenohet Hungaria për Belgradin e vet pranë brigjevet të Danubit dhe ndër

1) Janë forcat ndihmësë të dërguara nga mbreti i Napolit, Alfonsi.

2) Belgradin = Beratin.

3) D.m.th. turpi që patëm me humbjen e Stefogradit.

4) E thotë lidhur me moshën e tyre.

shembujt më të ndritur të trimërisë së vet e sjell këtë qytet për të provuar dobësinë e armiqvet. Mos vallë, ne do të durojmë, për turp të madh të gjithë Shqipërisë, që Belgrad<sup>1)</sup> ynë të mbahet gjithnjë nën zgjedhën e armiqve më mizorë kështu ndër sy tonë dhe mu në zemër tonë?» (VII, 314-317).

Kjo fjalë e Skënderbeut u prit, si gjithmonë, me një klihmë gëzimi, që u ngrit nga të katër anët.

## XV

### FJALIMI I SKËNDERBEUT PARA PËRLESHJES ME HAMZËN

Disfata e Beratit bëri bujë në Shqipëri dhe jashtë saj, por ajo nuk e uli aspak vendosmérinë dhe besimin e Skënderbeut në forcat e veta. Përkundrazi «duke mos pranuar me atë shpirt të pamposhtur dhe me atë zë të madhërishëm, se ishte turp e poshtërim për Shqipërinë, ajo ngjarje, siç e kishin kuptuar njerëzit, dhe duke thënë se forcat e tij ishin të mjafatë për të vënë përsëri fatin në dorë dhe për të kaluar madje gjithë lavdinë e mëparëshme», ai i «përcillte të gjithë në shtëpi fort të gëzuar». (VIII, 341).

Gjithashtu edhe besimin dhe dashurinë e popullit ndaj Skënderbeut nuk e tronditi kurrëasnje fatkeqësi. Përkundrazi, populli, pas kësaj disfate të Beratit, besonte se «me prani në e Skënderbeut mund të ngjalleshin edhe të vdekurit» (VIII, 338).

Disfatën e Beratit e pasoi tradhëtia e Moisiut, por as kjo nuk mundi të trondisë besimin dhe dashurinë e popullit ndaj kryetimit të vet, sepse «fytyra e Kastriotit», thotë Barleti, ishte ngulitur aqë fort në mëndjen e secilit dhe emri e mbretëria e tij ishte skalitur aqë thellë në gjokset e të gjithëvet, sa që do të ishte më lehtë, siç i thonë, t'i shkulnje nga duart Herkulit topuzin, se sa të fshinje nga zëmrat e zjarria të vegjelisë dashamirësinë dhe dashurinë për Skënderbenë» (VIII, 334). Dhe bijtë e këtij populli, me një dashuri e besim të tij më të pashlyer ndaj kryetimit të tyre, i dhanë dërmën Moisit, i cili, i dërmuar, u kthye më në fund i penduar në gjithë atdheut dhe i ra më këmbë Skënderbeut me brez në qafë, duke kërkuar falje dhe duke e larë turpin e tradhëtisë me tri-

1) Berati.

mërisa të tjera dhe me jetën e vet. Por pas tij, doli në skenë Hamza, i nipi i Skënderbeut, i cili ënderronte t'i zinte vëndin të ungjitet e të vinte në kokë kurorën e mbretit të Shqipërisë (IX, 359). Ky, nën komandën e përgjithëshme të Isaak Pashës dhe me 50.000 ushtarë turq, erdhë kundër atdheut dhe Skënderbeut për të plotësuar qëllimin e kobshëm të tij. Skënderbeu e priti si zakonisht duke marrë masat e duhura me kujdesin më të madh. «Çështja», thotë Barleti, «u shoshit, siç ndodh, në shumë mbledhje ushtarake» (IX, 358). Me këtë rast edhe Skënderbeu mbau fjalimin e tij, në të cilin përcaktion taktilën më të përshtatur që duhet ndjekur për të përballuar me sukses rrezikun dhe për të siguruuar fitoren.

Ky fjalim është nga më të bukurit e më të pasurit në përbajtje. Këtu Skënderbeu, pasi thekson se pësimet në Berat janë bërë mësime të vlefshëm, ngre lart vlerën e urtësisë dhe të mënçurisë, e cila duhet të jetë në bazë të çdo veprimi në luftë. Prandaj ai e shtron planin e tij për diskutim e shoshitje kolektive dhe kërkon nga të gjithë që të mendojnë me urtësinë më të madhe etj. «Është nevoja, pra», u thotë ushtarëvet, që ne të ngrihem i në majën më të lartë të urtësisë, të një urtësie që sështë parë ndonjëherë, të mendojmë se me ç'mënyrë edhe vëndin ta shpëtojmë nga rreziku, edhe lavdinë e mëparëshme dhe emrin e madh, që kemi gjer më sot nga sa e sa vepra trimërore, ta ruajmë dhe ta rritim edhe më me ndonjë fitore të shënuar e të papërgjakur, gjë që ndodh rrallë» (IX, 362). Dhe fitorja në këtë rast qe e shkëlqyer dhe me të vërtetë e rrallë. Të vrarët ishin 30 ose 20 mijë, thotë Barleti, robrit 1500, kurse «plaçka e kuajvet dhe e gjëratet të tjera qe e pabesueshme» (IX, 376), ndër këto edhe njëzet flamurë ushtarakë. Hamza vetë u zu rob. Kjo është fitorja shqiptare dhe kërdia turke në betejën e Albulenës, shtator 1457.

Populli e priti Skënderbeun fitimtar me gjëzim si asnjëherë. Plani i kryetimit tonë u vërtetua shkëlqyeshëm në praktikë si kurdoherë. Ja fjala e tij:

«Ndërmjet gjithë gjëratet të tjera që ka në këtë botë për të munduar e mbajtur në ankth zemrat e njerëzvet, në një larmi kaqë të madhe të gjëratet njerëzore, ne shikojmë, o ushtarë, si më kryesoret këto të dyja: shpresën dhe frikën. Ajo është më e qeshur dhe me një natyrë më të lartë, që të mos them më të lehtë; kjo është më e urtë dhe më pak e përgjakur, sepse, megjithëqë i zvarit pakëzë dëshirat e njerëzvet, e ka zakon më në fund të kujdeset për to dhe t'i rregu-

llojë si jo më mirë. Që këndeje ka rrjedhur edhe mundësia që ne të dëgjojmë se kapetanët e vjetër, që ia kishin frikën çdo gjëje, fitonin zakonisht më mirë se ata që s'trëmbeshin për asgjë. Që këndeje ai fenikasi me emër<sup>1</sup>), Kuint Fabin<sup>2</sup>), që të vetët e pandehnin të ngathët dhe tepër frikaman, e quante armikun më të rrezikëshëm për të, kurse Terenc Varronin<sup>3</sup> më tepër të rrezikëshëm për atdheun dhe për popullin romak.

Por për ç'arësy e kemi quajtur ne frikë, me një mënyrë kaqë të pazakontë dhe dorështrënguar, atë, që do të duhej ta thërrisin me emrin më të veçantë: urtësi? Thirreni veç si t'ju vijë mbarë, kështu apo ashtu, unë s'e vë edhe shumë në diskutim. Vetëm një gjë s'mund të mohojë kush, se që andej e ka burimin disiplina e lashtë, rreptësia e vjetër e ushtërisë, e cila ngroh dhe ushqen edhe vetë shpresën dhe kurrë s'vepron në tym, por të bën t'i mbash syltë katër përpëra, prapa dhe anash dhe e peshon me të njëjtin kandar të ardhmen dhe të tashmen. Tani mund ta kuptioni fare mirë se ku rreh fjala jonë kaqë frenonjëse dhe me vend. Unë kam dashur që, përpëra se të vë në zbatim ndonjë mënyrë të re në këtë luftë, të flas më parë me ju dhe të di mirë vullnetin e seicilit, kështu që ose unë të vij pas mëndjes suaj, ose ju pas simes (siç ka ndodhur gjithmonë me ne). Ju e dëgjuat, e dëgjuat me veshët tuaj<sup>4</sup>) se çfarë ngjarjesh tronditëse dhe çfarë luftash po gatiten kundër nesh. Ja, Pasha i Romës së re<sup>5</sup>) po na troket te derë me gjithë lulen e Evropës dhe fuqinë e mbretërisë otomane. Mua s'më mungon guximi, ashtu si s'më ka munguar kurri, që ta provoj në çdo rast fatin me të dhe jo pa lavdinë tuaj; por unë kujtoj se, kundër një armiku kaqë të madh, duhet të shtiem në punë më fort urtësinë dhe mënçurinë se sa vrullin dhe zjarrin e zakonshëm të zëmrës.

Kërdia që la nam e Ali Pashës, gjithë fitoret e shënuara gjer më sot, guximi i fituar dhe i përforcuar në gjithë ato suk-

1) Hanibili.

2) Kuit Fab Maksimi (275-203) kundërshtari më i rreptë i Hanibalit. Ky është mbiqajtur «ngurues» (latinisht: cunctator) për taktilën e tij që ta ndiqte armikun pa u përleshur me të hapur.

3) Terenc Varroni. Konsull romak. Kundërshtar i taktilës së matur të Kuint Fab Maksimit, u bë shkakëtar i kërdisë romake në Kanë më 216 para e.r., duke sulmuar Hanibalin sheshit.

4) Nga zbulonjësit e Skënderbeut dhe të arratisurit e ndryshëm, që vinin tek ai.

5) Roma e re = Stambollë.

sese, na bindin se ne jemi të zotët për t'i bërë ballë sheshit dhunës me forcat tona dhe me zëmrat tona. Por luftavet s'u dihet, ato janë të paqëndrueshme... gjithëmonë për plane të reja, duhen rrugë të reja...

Unë e mbaj mënd se më parë nga ushtarët kërkonja vetëm trimëri, duke lënë më nj'anë me mospërfillje çdo shkak të ja-shtëm, dhe se juve ju zotohesha me bindjen më të patundur për gjithë të mirat..., po të më jepni fjalën për guximin tuaj krenar. Por ajo kërdia jonë e Belgradit<sup>1</sup>), të cilën e kujtoj dhe do ta kujtoj gjithmonë me tmerr, i ka ndryshuar shumë mendimet e mia dhe më ka bërë që t'i çmoj me një mënyrë fare të ndryshme ngjarjet njerëzore... Ç'do të ndodhte, sikur ajo ditë të ishte më e gjatë apo sikur Sebalia të kish patur më te-për zëmër? A nuk do të shëmbej Shqipëria nga themellet? Ne shpëtuam atëhere më fort nga të epërmis se sa nga ne vetë.<sup>2</sup>) Të shpërndarë, të plagosur, të rraskapitur ishim ne, që po mbaronim nga uria dhe etja e paparë ndonjëherë. Ç'mbetej tjetër, veç se t'ia jepnin të këputur duart fitimtarit për të na i lidhur? Na mbrojti nata... dhe na dha neve mundësinë për të ikur dhe për të marrë frymë. Në shumë vise vëndi ishte lehtë të dëmtuhej; fshatarët ishin të shpërndarë kudo, pa ditur gjë për fatin tonë; plaçka priste, si të thuash, fitimtarin; por ai asgjë nuk rrëmbeu, asgjë nuk mori, sepse kishte shumë më tepër hallin për nderin që fitoi dhe kishte frikë, ndoshta, nga ata që vetë i trëmbeshin atij shumë.

Unë nuk i them këto për të trëmbur ndonjë nga ju, por më fort që t'ju këshilloj dhe të këshillohem me ju se me c'më-nyrë duhet të bëjmë që këto ndërmarrje kaqë të mëdha të dë-shtojnë dhe të dërmohen nga ne, se me c'mënyrë duhet të kërkojmë ndonjë fitore të shënuar, pa e paguar me gjakun dhe me gjënë tuaj. Numuri i armiqvet është shumë i madh dhe kurrë gjer. më sot s'është parë më i madh në Shqipëri, veçse kur ka qenë puna për rrethim qytetesh.<sup>3</sup>) Nëqoftëse ne e pre-sim atë me flamuj të ngulur në fushë të hapët, përfundimi i luftës mbetet i dyshimit.<sup>4</sup>) Por zëmër, zëmër! Puna mund të na shkojë mbarë dhe ashtu siç na e do zëmra ne. Fitorja do të jetë

1) Beratit.

2) E vërteta është se, sikur Seballia të kishte më tepër guxim, gjëndja e punëvet të Shqipërisë do të ishte vënë në një situatë shumë kritike.

3) Skënderbeut i kujtohet, ndoshta, mbi të gjithë, rrethimi i Kru-jës nga Murati.

4) Kuptohet: «për ne» (ka rrezik, pra, që ta humbasim luftën në fushë).

gatuar me lotë dhe pikëllimi për mundësinë s'do të jetë shumë i ndryshëm nga ai i të mundurit. Mos ramë pak pranë Belgradit<sup>5</sup>)? Mos duhet vënë vallë në vënd ajo humbje me të njëjtën mënyrë? Sa ushtarë në lule të moshës, që me zor do të mund t'i kemi përsëri pas shumë vjetësh,<sup>2)</sup> sa burra nga tri-mat u vranë atje? A nuk do të shuhej pa tjetër menjëherë Shqipëria, po të ishte se ne kërkoni, me një plan kaqë të gu-ximshëm<sup>3</sup>), vetëm fitore lavdiplotë? Duhet, pra, që ne të luftojmë sot me një mënyrë që të jemi në gjëndje të luftojmë edhe nesër dhe s'mund t'i bësh në këtë mes llogaritë njësoj për vehte dhe për armiqtë. Për Tiranin është më e vogël humbja, çmohen më pak dyzet e pesëdhjetë mijë të vrasë, se sa për mua njëqind<sup>4</sup>) nga ju. Jemi të pakë, prandaj duhet ta ru-ajmë me kujdesin më të madh vehten dhe, në mos e bëfshim këtë nga meraku për kokën tonë, ta bëjmë të pakën për hir-të gravet e të fëmijëvet, jeta dhe Jiria e të cilëvet varet ve-tëm ngajeta juaj.

Unë e di numurin sa jeni, i njoh fytyrat dhe emrat e të gjithëvet, një për një, dhe kjo më bën që të kujdesem e të jemë në hall më tepër për shpëtimin tuaj. Megjithëkëtë, unë nuk do ta mohoja se duhej përballuar fare sheshit dhe sy ndër sy fati i kësaj ndeshjeje, sikur të kishim mundësi që t'i jepnim fund luftës me Otomanin vetëm me këtë betejë; unë, sikur të kishim shpresë për ndonjë mbarim të vuajtjevet dhe cili-tjeve tona, do ta vinja vetë me gjithë qef në rrezik kokën ti-me bashkë me trupin tuaj për t'i siguruar pasardhësvet qetë-sinë dhe paqen e përherëshme. Por armiku ngrihet gjithmonë mbi ne me forca të reja, luftra ngahera të reja na presin. Isaakut të perënduar një tjetër Isaak do t'ia zerë vëndin. Ne do të derdhim djersë ngahera në luftra të reja, do të rrëthohemi nga rreziqe të reja. Për këtë, me c'më duket, është destinuar Shqipëria, për këtë kanë lindur zverku dhe koka jonë. Prandaj, duhet ta mbledhim mirë mëndjen, të jemi nikoqirë me fuqitë to-na, ta ndajmë pasurinë e trashëguar më mënyrë që të kemi ngahera mundësi t'ua lajmë borxhin kreditorëve<sup>5</sup>) që na mbij-në çdo ditë përpara. Megjithëkëtë, edhe këtyre do t'u jepet

1) Beratit.

2) Gjersa të rriten të vegjilit e të vinë në moshë për ushtar.

3) D.m.th. me luftë në fushë të hapët, siç e tha më lart.

4) Skënderbeu thotë këtu një të vërtetë historike, që tregon rolin dhe fuqinë e popullit tonë, të udhëhequr nga kryetrimi i tij, në luftën kundër Turqisë.

5) D.m.th. t'u jasjmë përgjigjen e merituar armiqvet, të cilët kuj-tojnë se kanë të drejta mbi Shqipërinë.

fund. As tē mirat, as tē këqiat s'janë tē pérherëshme pér një-rezit. Do tē merrni edhe ju frymë dikur. Armikut do t'i vësh-tiren tërë këto ndërmarrje tē kota dhe do tē heqë më në fund dorë nga urrejtja e vazhduar, ndërsa ju do t'ju kënaqë atëhe-re kujtimi i gjithë këtyre mundimeve dhe rreziqeve.

Tani le tē vazhdoj, siç më takon, mendimin tim. E kisha fjalën pér fitoren e pavënd e tē dëmshme. Çdo tē ndodhë, si-kur tē mundemi? Ku mbetet shpresë më pér mbrojtje? Me ç'mënyrë do tē kemi ndihmë? Mos, vallë, armiku i përgjakur dhe fitorja e tërbuar<sup>1)</sup> do tē presë, gjersa ne tē ripërtërijmë forcat e tē sulemi me ushtëri tē re? Do tē na sulmojë, s'do tē na ndahet gjer në pikën e fundit dhe, pasi tē na ketë dërmu-ar ne, do t'u kthehet pastaj qytetevet e krahinës së pambro-jtur, pér tē çfryrë tërbimin e vet gjer në fund. Dikush nga ju do tē thotë, ndoshta, se ardhja e tyre duhet pritur me anë pu-sish, jo me luftë sheshit. Edhe unë këtë mendim kam, por, sa pér kohën, mendoj ndryshe<sup>2)</sup> nga ju. Unë jam i mëndjes se ata duhen futur në kurth atëhere, kur s'do ta prisnin, kur, tē çfre-nuar pa masë nga ndonjë fitore, s'do tē kishin më asnë frikë pér kurth. Tani ata, me mësimet që kanë marrë nga ç'kanë parë ndër tē tjerët dhe nga ç'kanë pësuar vetë, po vinë nga Kon-standinopoja me një dyshim tē parreshtur pér këtë dhe me sytë katër që me kohë. Veç kësaj, ata kanë me vehte edhe ni-pin e mallkuar e murtajën e shtëpisë,<sup>3)</sup> i cili do t'i mësojë si duhet t'i parashikojnë dhe t'u ruhen pusivet, që ai vetë u ngrinte dikur bashkë me ne. Eshtë nevoja, pra, që ne tē ngji-temi në majën më tē lartë tē urtësisë, tē një urtësie që s'është parë ndonjëherë, tē mendojmë se me ç'mënyrë edhe vendin ta shpëtjmë nga rreziku, edhe lavdinë e mëparëshme dhe em-rin e madh, që kemi gjer më sot nga sa e sa vepra trimërore, ta ruajmë dhe ta rritim edhe më me ndonjë fitore tē shënuar e tē papërgjakur, gjë që ndodh rrallë. Megjithëkëtë, ky mendim neve do tē na shkrepë në kohën e ditën, kur ta kemi armikun para syvet. Tani, me qëllim që fjalë jonë tē arrijë atje ku synon, i duhet hequr para së gjithash armikut qđo rast tërbimi dhe fitoreje, duhen shpënë në vënde tē siguruara njerë-zit e cdo moshe dhe sekxi, duhen siguruar gjithashtu qytetet me përforcime trupash e me ushqime pér qđo rast tē papri-tur... Veç kësaj, kush ia di planet e fshehta Tiranit? A thua

1) D.m.th. më thjesht: «Armiku i tërbuar nga fitorja».

2) Kjo do tē thotë se tē tjerët kishin çfaqur mëndimet e tyre më parë nëpër mbledhjet ushtarake.

3) Hamza, nipi i Skënderbeut,

se ai, që prej kohësh po digjet pér këtë shpagim dhe pér gjakun shqipëtar, nuk do tē vijë prapa, pas Pashës? Unë besoj se, ndoshta, po, dhe kam frikë pér më shumë gjëra nga ç'duhet. Eshtë mirë ta kemi tē gjithë këtë frikë, që tē mos trëmbemi pastaj pér asgjë.

Në qoftë se ne do tē tregojmë një kujdes tē tillë pér vën-din tonë, në qoftë se nëpér fusha s'do tē ketë asnjë gjë nga ato që begatojnë dhe ushqejnë njerëzit nëpér qytete, që i kallin datën armikut e ne na shpëtojnë nga halli që tē mendojmë pér to, ne do tē dalim pa dyshim fitimtarë. Dhe atëhere, unë, po qe se ju do tē veproni me armët e mëndjen tuaj sipas vull-ne-tit tim, do t'ju lë armikun në dorë, pér ta grirë me nge brën-da murevet, dhe emrin e mëndjemprehtësinë shqiptare do ta bëj sot... më tē tmeruar nga ç'imbahet, ndoshta, mënt që prej stërgjyshërvet tanë. S'dua t'i bëj qefin vehtes, as juve, por, në qoftë se mund tē zotohesh pér diçka në punët njerëzore, unë ju, zotohem e i marr përsipër këto që thashë. Megjithëkëtë, mendoj se këto eshtë më mirë tē bëhen se sa tē thuhen me fjalë. Ndërkajqë, le tē mos e humbasim kohën kot nga dëshira pér tē folur me fjalë tē zbrazëta, se pér ushtarin s'ka humbje më tē madhe; le t'u përvishemi tē gjithë me radhë detyravet që kemi seicili pér tē forcuar qytetet e pér tē pritur armikun. Unë nuk u jap asnë uredhër tē tjerëvet përpara se t'ia jap më p'ré vehtes. Nga ana tjetër, nuk kundërshtoj e nuk quaj tē pavlerëasnë, send që do tē çmohej se do tē ishte pér dobinë dhe nderin e tē gjithëvet». (IX, 359-363).

Pér përshtypjen që bëri kjo fjalë e Skënderbeut dhe pér vëmëndjen, me tē cilën u dëgjua, Barleti shprehet kështu: «Këtë fjalë, që mori fund me kulmin e heshtjes dhe tē vëmëndjes së tē gjithëvet, Tanushi dhe Vranakonti, tē cilët kishin kohë që po e ndiqnin tërë veshë e mënt, e shoqëruan me lav-dërimet më tē mëdha para tē pranishmëvet, duke u ngritur më këmbë dhe duke thënë se Skënderbeu i kishte argumentuar tē gjitha çështjet me një saktesi aqë tē plotë, se mëndja dhe urtësia e tij hyjnore i kishte shoshitur ato aqë mirë, sa që s'mbetej më vënd pér ndonjë tjetër as tē mendonte, as tē shtronët diçka, që tē synonte në tē mirën e përbashkët apo vehtiake». (IX, 363).

Kjo fjalë e Skënderbeut bëri gjithashtu që «turmës guxim-tare» dbe ushtarëvet tē pangopur, që s'i trëmbeshin as numu rit tē madh tē armikut, as lajmët se ai po vinte, që vuanin se ai po vonohej e thonin se forcavet tē tij u duhej dalë përpara me vendosmëri para se tē arrin, duke u krenuar pér trimë-

rinë dhe besën e vet (IX, 369), kjo fjalë, pra, béri, që «turmës guximtarë t'i pushonte tërë ai zjarr» dhe që ajo të kalonte «nga guximi i çfrenuar në një farë frike, që të bën të ruhen fort» (IX, 363). Dhe ushtarët guximtarë tani, pas kësaj fjale, «i kërkonin hapur kapedanit dhe i luteshin» që t'i çfaqte më çkoqur planet e veta, që t'u tregonte më hollësish se me «ç'ményrë kish vendosur t'i jepte fund luftës me armikun». Por Skënderbeut «duke vënë buzën në gaz, u thoshte se për të do të ishte mjaft, po të kishin besim tek ai». (Po aty). Me këtë frazë të fundit plot kuptim Barleti vë në dukje se gjithëcka në veprën e madhërishme të Skënderbeut varet nga populli i udhëhequr prej tij, nga besimi reciprok i tyre, të cilat i trëmbeshin edhe sulltanët më të mëdhenj të Turqisë, Murati II dhe i biri i tij, Mehmeti II.

Ky plan, pra, i Skënderbeut, plan plot mënçuri e urtësi, besim e vendosmëri, guxim e trimëri, solli atë fitore të shkëlqyer, për të cilën Barleti thotë: «Përshtypja që bëri lajmi i asaj ngjarjeje, kur u përhap në gjithë vëndet fqinjë si edhe në viset më të brëndëshme të Italisë dhe në principatat e tjera... që aqë e madhe, sa që zor se mund të kish qenë më e madhe, kur u kthyel<sup>1)</sup> Murati apo kur u korr ndonjë fitore tjetër plot sukses» (IX, 378). Dhe ai vazhdon: «Më në fund edhe vetë Mehmeti nuk e priti atë ngjarje me një admirim më të vogël; përkundrazi, ai e pranoi fitoren shqiptare duke pohuar pas pak me shumë turp frikën e vet». (Po aty).

## XVI

### PËRGJIGJA E SKËNDERBEUT PROPOZIMIT TE MEHMETIT PËR ARMËPUSHIM

Pas kërdisë që pësoi Isaak Pasha në betejën e Albulenës, siç e pamë më lart, sultan Mehmeti, i shtrënguar edhe nga vështirësi e andralla të tjera, i kërkoi Skënderbeut një armëpushim prej disa vjetësh. Këtë kërkësë ai e bëri me anë të sanxhakbeut Meshit, i cili ishte zënë rob bashkë me të tjetrët në betejën e lartpërmëndur dhe i cili u la i lirë për t'u kthyer pranë Sulltanit, pasi pagoi 15 mijë florinj për vehte dhe 40 mijë për të tjerët. I dërguari, që i solli Skënderbeut parat, kishte me vehte edhe një letër nga vetë Mehmeti për

<sup>1)</sup> D.m.th. i mundur nga Kruja.

tek Meshiti me porosinë që ta përfundonte armëpushimin. Barleti na thotë se «lajmëtarë», d.m.th. i dërguari «u nis shumë më i gjëzuar nga kjo porosi se sa nga shpresat që kish prej parevet që mori për të liruar vehten dhe shokët, sepse ai kujtoi se tani s'do të kish më të bënte për ca kohë me gjoks shqiptari dhe se turqit do të merrnin pakëzë frymë nga gjithë ato kërdira». (IX, 379).

Propozimin Meshiti ia bëri Skënderbeut «në të numëruar e sipër» të parevet, por kryetrimi ynë «s'e priti të vazhdonte, më tutje, por ia preu me këto fjalë»: (IX, 380).

«Unë s'i kam hedhur sa e sa herë poshtë kërkësat tuaja për paqë, edhe atëhere kur punët e mia i kam patur keq, me mendim që t'i pranoj tani, kur ato më shkojnë mbarë. Kjo s'do të thotë, sigurisht, se unë s'e mbaj parasysh karakterin e paqëndrueshëm të gjëndjes njerëzore, por cilado qoftë kjo, fati im tani, me të vërtetë i lumtur, më ka shkuar aqë mbarë e ma ka mbushur shpirtin me një shpresë t'atillë, sa që të guxoj t'i premtoj vehtes se do të jem zot i tij i përherëshëm dhe të kem gjithash tu besim në vehten time se do të jem ngahera përbuzës krenar i miqësisë suaj. Ka mundësi që ai ta ndrojë fytyrën e vet lozonjare<sup>1)</sup>, dhe të bëjë që ne të kërkojmë ndoshta nga ju një paqë poshtëronjëse, por çfarëdo që mund të ngjasë, ne s'do ta ndryshojmë për këtë sot qëndresën tonë këmbëngulëse të mëparëshme, që e kemi të vendosur<sup>2)</sup>. Ne e quajmë shumë poshtëronjëse çfarëdo besëlidhjeje me ju, gjersa vazhdojnë nga çdo anë dhunimet e panumurta... rrënimet dhe gjaku ende i freskët, në të cilin janë zhitur tani gjithë Greqia dhe toka hungareze<sup>3)</sup>. Mos vallë kështu, me paqën e sotme, do ta vëmë ne në vënd humbjen e perandorisë së Peloponezit<sup>4)</sup>? Mos do ta nxijmë vallë ne kështu, me një armëpushim prej frikamanësh me ju, fitoren e re belgradase dhe lavdinë hungareze? Le t'i gjëzojë Mehmeti besëlidhjet atje ku i ndez; ne e kërkojmë paqën ashtu siç e kemi filluar, me armë dhe me shpatë, sidomos kur jo vetëm dhunimet dhe pa-

<sup>1)</sup> D.m.th. të ndryshojë, sepse është, e paqëndrueshëm etj.

<sup>2)</sup> Me këtë Skënderbeut vë mbi fuqinë e fatit vendosmérinë e njëriut, fati është në dorë të njeriut etj.

<sup>3)</sup> Skënderbeut me këtë përgjegje paraqitet si mbrojtës i lirisë të të gjithë atyre vëndeve, që i reziston në Evropë rrezikut turk. Barleti na thotë se, duke njoftuar princërit dhe mbretërit e ndryshëm të Evropës për fitoren e shkëlqyer të Albulenës, bashkë me dhurata të ndryshme, u dërgoi edhe «këshilla për bashkim» dhe «lutje të zjarrita që të zgjoheshin nga gjumi» etj. (IX, 381).

<sup>4)</sup> Peloponezi — Moreja, siç e thotë populli, u pushtua definitivisht nga Mehmeti më 1460.

besia juaj, por vetë natyra na ka bërë ne armiq të juaj dhe na ka armatosur me një urrejtje të përjetëshme kundër jush... prandaj unë kërkoj nga ju jo aqë ndonjë lavdi të re se sa shpagimin për gjakun e shtëpisë sime dhe për skllavërimin tim e të Shqipërisë njëkohësisht. Dhe kurrë s'kam për t'u dhënë fund këtyre përpjekjeve plot mundime dhe rreziqe, gjersa t'u le në dorë qytetarëvet të mij ja gjendjen e dikurshme, ja shpirtin tim që ju e mëreni aqë fort.. (IX, 380).

## XVII

### PRITJA E SKËNDERBEUT NË RAGUZË DHE FJALA NE SENAT PËR NDER TË TIJ

Me vdekjen e Alfonsit, mbretit të Napolit dhe mikut të Skënderbeut, Ferdinandi, i biri i Alfonsit, u ndodh në kon-dita të vështira. Për të shpëtuar nga rreziku, Ferdinandi kërkoi ndihmën e Skënderbeut, i cili ia dha të plotë. Gjatë rrugës për në Itali, Skënderbeu kaloi në qytetin Raguzë të Dalmacisë, ku u prit me nderime të mëdha nga populli dhe nga senati, në verë të vitit 1461. Në pritjen zyrtare, që iu bë në senat, u mbajt për të edhe një fjalë nga një raguzinas me emrin David. Kjo fjalë tregon qartë e bukur emrin e madh, që kish fituar kryetrimi ynë në gjithë botën, dhe shkëlqimin që i kish dhënë atdheut të vet, Shqipërisë sonë, si një «yll i bukur e i ndritur i Arbërisë» (X, 395).

Mendova se nuk do të ishte pa vend të përfshihet ndërmjet fjalimevet dhe letravet që Barleti vë në gojën e Skënderbeut, edhe përshkrimi i kësaj pritjeje në Raguzë dhe fjalimi i Davidit në senatin e Raguzës. Ja si flet Barleti:

— Kur Skënderbeu arrii në Raguzë, u derdh i gjithë qyteti dhe i dolli përparrë një mizëri populli për ta pritur me duartrokitje dhe gëzim shumë të madh. I përcjellur prej tyre, ai hyri në qytet dhe u prit me nderime dhe bujari. Të nesërmen, pasi u bënë, sipas zakonit, kretime zyrtare... i ra qytetit rrëth e përqark, ndërsa ditën tjetër vazhdoi duke vizituar arsenalet navale, kështjellën dhe gjithë fortifikimet e qytetit. Dita e katërt, përkundrazi, kaloi me lodra të ndryshme dhe me sehire gjithëfarësh. Të nesërmen e shpunë në senat, ku u nderua me shumë dhurata të ndryshme dhe ku u lavdërua zyrtarish para mbledhjes nga një farë Davidi, shkrimitar raguzian, i cili i u drejtua Skënderbeut, siç thonë, me këto fjalë-plot lavde:

„Nuk e di, o princ i ndritur Skënderbe, se c'hyll mund të dilte dhe të dukej sot më i ndritur e më i shkëlqyer për qytetin tonë dhe për popullin e Raguzës, se c'diejl më vezullojnës e c'hyjni më mirëdashëse dhe më përkrahëse se sa pamja dhe prania jote plot mirësi. Me të vërtetë, sot, kur ti hyre në qytetin tonë, çdo gjë ndriti e shkëlqeu për ne, çdo gjë u kthye në gëzim e lumburi. Qielli, i errësuar dhe i mbuluar me re, u kthjellua, u ndrit e u bë pasqyrë nga pamja jote. Toka gjithash tu, kur ti po shkëlqenje në të, u duk se ngazëlllohej, kënaqej e buçiste vetiu nga klithmat e gëzimit që lëshonte. Qytetarët të gjithë e populli i tërë u vu re se po të shikonin e të vështronin... Gazi dhe hareja buçiste dhe oshëtinte kudo më të katër anët, si në festë. C'është e vërteta, ti na ndrite, na zbardhe ne dhe qytetin tonë, vatrat dhe shtëpi-të tona, si ndonjë rreze fort e ndritur e diellit. Prandaj, sa po u hap lajmi se ti zbrite në brigjet tona, të gjithë qytetarët, pleq, të rinj, vajza, gra, të rritur, fëmijë, të shëndoshë, të ligur e sakatë vrapijan kush e kush më parë e grumbuj-grumbuj për të parë ty e për t'u kënaqur me pamjen e praninë tënde, se emri yt, o princ fort i ndritur, është i dashur e i dë-shiruar jo vetëm këtu dhe në Shqipëri, por edhe në të gjithë Italinë.

✓ C'të them më? Ne besojmë se ti ke lindur e ke dalë mbi dhe që të nderosh e t'u japësh shkëlqim, që t'u dalësh zot e të mbrosh jo vetëm atdheun tënd me emër atje në Shqipëri e në Maqedhoni, selinë dhe mëmën e mbretërvet të mëdhenj dhe të kapetanëvet të pathyer, por edhe Dauninë<sup>1)</sup> dhe Italinë... Ja, emri yt tanimë, o princ fort i ndritur, po merr dhenë kudo; ja, të gjithë ty po të thërrasin për ndihmë dhe për mbrojtje, ty po të quajnë shpëtimtar, mbrojtës dhe çlirimtar. Ja, mbretërit dhe udhëheqësi i gjithë dheut po të lusin për të shkuar në mbrojtje dhe ndihmë të tyre. Ja, Piu<sup>2)</sup> bashkë me Sforcën, dukën e Milanezëvet, dhe Ferdinandin, mbretin e Sigelisë dhe të Apulisë, po dërgojnë tek ti përfaqësonjësit e vet për t'u shkuar me të shpejtë në ndihmë dhe për të cli-ruar Italinë.

O, lum atdheu që të nxori ty, një burrë kaqë të madh! O, lum prindërit, që të lindën ty! O, lumë bashkëluftëtarët, që të vinë ty pas dhe të kanë në krye si udhëheqës, drejtonjës, prijës dhe kapetan, që gëzojnë, që kanë dhe kënaqen me një mbret kaq të madh.

1) Krahinë e Italisë, pjesa Veriore e Apulisë.

2) Papa.

Do të shkosh në Apuli, o mbret tmeronjës dhe i pathyeshëm, do të shkosh, o hyll i ndritur e i bukur i Arbërisë<sup>1)</sup>, në Itali, do ta çirosh atë, do ta mundësh armikun. Ti ke mundur Muratin me nam, mbretin shumë të fuqishëm të turqvet që i dha sa e sa herë dërmën krenarisë dhe fuqisë hungareze; ti ke mundur Mehmetin, djalin e tij, që ka vënë nën zgjedhësa e sa mbretër, sa e sa prijës e sovranë... që ka shtruar sa e sa mbretërrira, që ka qënë tmeri i gjithë botës, që ka zënë, vrarë dhe dërmuar sa e sa prijës të tyre, sa e sa princër e perandorë. Vetëm ti, me të vërtetë, je bërë tmeri i turqvet, vetëm ti ke ditur t'i thyesh turqit. I lumur do të shkosh, o princ i pathyeshëm, më i lumur do të kthehesh. As Aleksandri yt shqiptar, as ai Pirroja, mbreti rrufe i shqiptarëve dhe mjeshtri i luftravet, nuk u kthyen fitimtarë nga Italia ashtu, siç do të kthehesh në atdhe i lumur e fitimtar ti, o mbret i fuqishëm e bujar. Ja, populli dhe qytetarët e tu raguzinas po ngrejnë për ty një altar, ja, si... hyjnë po të shërbejnë e të nderojnë; ja, për ty, që të kthehesh fitimtar e shëndosh' e mirë... Ja, qytetin, familjen, fëmijët, çdo gjë që kanë, që zotërojnë, vehten e tyre më në fund, ty po t'i kushtojnë e ty t'i lënë në dorë». (X, 394-395).

## XVIII

### FJALA E FERDINANDIT PËR SKËNDERBENE

Skënderbeu i dërmoi armiqjtë e Ferdinandit, dhe, e vendosi atë përsëri në fron. Kjo ishte një fitore tjetër e shkëlqyer e Skënderbeut tonë dhe e ushtarëvet trima të tij, e korrur jo më në malet e grykat e tyre në Shqipëri, por në fuhat e hapura të Agulizë, në Itali. Mbreti Ferdinand, për të shprehur mirënjohjen e tij ndaj kryetrimit tonë, para se ta përcillte për në atdhe, «thirri në një mbledhje të gjithë kërët dhe kapedanët», thotë Barleti, «dhe foli kështu» (X, 414). Edhe në këtë fjalë të mbretit Ferdinand theksohen disa nga tiparet më të larta e më të ndritura të Skënderbeut tonë dhe të ushtarëvet të tij. Edhe kjo fjalë, si ajo e Davidit në Raguzë, është një hymn për Skënderbenë, për popullin dhe Shqipërinë. Prandaj po e shënojmë këtu.

«Megjithëse unë i jam falur dikur emrit tënd, o princ i

ndritur Skënderbe, prapë se prapë unë po të falem ty sot si asnjëherë tjetër, sepse unë pasqë dhe provova vetë me sytë e mij, në punë e sipër, më shumë çka më tepër nga ç'thonë dhe nga ç'tregojnë zakonisht për ty. Dhe s'është çudi, ti e ke zanafillën nga stërgjyshër e nga një vënd i tillë, siç është sigurisht Shqipëria e pamposhtur apo Arbëria... në të cilën kanë lindur e lulëzuar gjithmonë sa e sa prijës nga më fisionikët e nga më të pathyeshmit, sa e sa udhëheqës e kapedanë nga më kryetrimat e më energjikët, të cilët duke luftuar me rreptësinë më të madhe, shtruan edhe mbarë botën. Këtyre pastaj ua zunë vendin me radhë pasardhësit e tu edhe ti, o princ i pathyeshëm... me qëllim që të bënje gjithë këto vepra të ndritura dhe gati të pavdekëshme.

E ç'të përmënd më parë për ty, o princ i ndritur, dhe për veprat e tua fort të ndritura? Se si ti, i dhënë peng fare fëmijë nga prindi yt, bashkë me vëllezërit e tu, pranë Muratit, sundimtarit të turqvet, dhe i çemëruat pas pak prej këtij kapedani ushtërie, i shpartallove dhe u dñe dërmën ushtërivet më të fuqishme të armiqve<sup>2)</sup> në Azi dhe në Evropë; se si ti para po atij sundimtarit otoman, i ndërsyer në ndeshje -një nga një-<sup>3)</sup> nga burrat më të fortë dhe nga kapedanët më trima, ia arrite kurdoherë një fitoreje të shkëlqyer dhe të pashoqe; se si ti, me zgjuarësinë dhe urtësinë tënde të rrallë, u shpëtovë kurdoherë me trimërinë më të mësive dhe me mënyrën më të shkëlqyer gjithë pusivet të kurdisura dhe kurthevet të fshehta, që ai pasi çduku më parë me helm vëllezërit e tu, i ngrinte përherë e më shpesh kundër teje dhe se si ti, me atë mjeshtërinë tënde të pashoqe dhe me lartësinë e shpirtit tënd të pathyeshëm, ja shkëputë atij nga çwart brenda një kohe të shkurtër tërë mbretërinë tëndë stërgjyshore dhe atërorë dhe u bëre për bukuri vetë zot i saj; se si ti, me një grusht të vogël, oqë ta them kështu, u dhe arrati gjithë atyre ushtërive nga më të fuqishmet dhe nga më të mëdhatë dhe gjithë forcavet të panumurta të tij; se si i kape dhe i vrave kapedanët dhe komandarët e tij dhe se si e shpure më në fund vetë prijësin Murat, turrur kundër teje me tërë forcat e veta shumë të mëdha, në një vdekje të mjeruar dhe sënumë të turpëshme, përveç këtyre, se si i dërmovë ti në luftë ushtëritë shumë të mëdha dhe sënumë të forta të Mehmetit, i cili u ka sjellë gjithë ato të zeza dhe dëme aqë të mëdha, u ka bërë gjithë ato padrejtësi e dhunime... këto të gjitha unë i lë më nj'anë. Ti, o princ Skënderbe, je ai që, pas pohimit tënd dhe pothuaj të së gjithë shokëvet të tu,

<sup>1)</sup> Shqipëria.

<sup>2)</sup> D.m.th. të armiqve të Muratit

<sup>3)</sup> S., p.sh. në ndeshjen me skythasen me Jelijon dnë Zanipien.

të cilët kanë marrë pjesë ngahera bashkë me ty në të gjitha fushatat dhe betejat, ke vrarë vetë me dorën tënde duke luf-tuar mbi tri mijë turq. Unë them, o trim i trimavet, se as-kush s'ka parë ndonjëherë një njeri më të gatshëm e më të shpejtë se ty në nje betejë të stuhishme dhe të papandehur.

Ti je, them, ai, që sa e sa herë të ka ndodhur të përlleshesh me armikun në fushë të hapur e me flamujt përpara të çpalosur. Por unë po lë mënjanë, o princ, i pathyeshëm, meritat e tua të tjera burrëore dhe vepra të tjera të shuma dhe gati hyjnore, të cilat do të shkonte gjatë t'i përmëndnja. Me këto ti, i vetmi në shekullin tonë, mund të matesh pa dyshim me tërë lashtësinë.

Po vij më në fund tek ato, që pak më parë i pashë vetë mirë me sytë e mi.

Kur ti, o princ i pathyeshëm, erdhe fluturinë nëpër det këtu tek ne, duke lënë mënjanë qdo vonesë, armiku, i cili na kishte rrëthuar me pahisore dhe ushtëri nga qdo anë, mori arratini vetëm sa dëgjoi emrin tênd, para se të të shikonte me sy, duke lënë rrëthimin e qytetit<sup>1)</sup>. Kjo u tregoi të gjithëvet frikën që pati ai prej teje. Pastaj, duke e ndjekur atë me trimërinë tënde të pashoqe dhe me përvojën tënde të rrallë, si edhe me trimërinë e pabesueshme të kapedanëvet dhe të ushtarëvet të tu, ti e theve, e dërmovë dhe ia arrite një fitoreje dhe triumfi të shënuar kundër tij me betejë të rregulltë dhe me flamuj të çpalosur në fushë të hapur. Mua më vure përsëri me nder, me lavdi e me madhështi të pazakontë në fronin mbretëror, më solle përsëri pagën e qetësinë në të gjithë mbretërinë dhe shtetin tim. Prandaj unë nuk shoh se me çfarë të mirash, me çfarë shpërblimesh, me çfarë çmimesh, me çfarë nderimesh dhe me çfarë gjëresh të tjera të meritura mund t'u përgjigjem shërbimevet të tua kaqë të shuma dhe kaqë të mëdha ndaj nesh, nuk di se me ç'mënyrë mund të të çfaq ndonjë shenjë të mirënjohjes sime. Kështu, mbretërinë dhe pushtetin tim, qdo gjë që më ndodhet, qdo gjë që kam apo zotëroj, qdo gjë që të kem, pasi të ndahem nga kjo jetë, unë e lidh me ty; ty do të të kem gjithmonë në vend të shpëtimtarit dhe të prindit. Të gjitha gjërat tona, pra, akoma edhe jetën, shpirtin vetë dhe në se diçka më e lartë dhe më e fuqishme ishjhet në të, quaji se janë në dorën tënde dhe në zotërimin tênd. Gjithë fuqia dhe mbretëria jonë qoftë gjithmonë e përbashkët me ty dhe me njerëzit e tu; asgjë mos qoftë e ndarë, e veçuar prej teje, pushteti i të mbretëruarit për nje-

1) Eshtë fjalë për qytetin e Barit.

rin dhe tjetrin nga ne të dy le të jetë i përbashkët, i ndarë në pjesën dhe përpjeste me barabarta. (X, 414-416).

Pas këtij fjalimi të Ferdinandit u bënë «kremitë» dhe manifestime të ndryshme, «u zhvilluan lodra heshtëtarësh, ndeshje gjithëfarësh» për nder të Skënderbeut. Më rëndë fund «Skënderbeu u nda nga mbreti me të puthura të shuma dhe të dëndura, që i jepnin njeri tjetrit, dhe me lot në sy, që a shkonin rrëke të dyvet» (X, 416-417). Kur arriti në atdhe u prit me gaz e galdim nga populli «që ishte derdhur nga qdo anë», dhe kështu, me gaz e galdim, hyri në qytetin mbretëror të Krujës, ku qdo gjë e gjeti të gjëzuar e të lumur». (X, 417).

## XIX

### LETËR E SKËNDERBEUT, ME TË CILËN I PËRGJIGJET MEHMETIT

Gjatë kohës, që Skënderbeu ndodhej në Itali, «Mehmetit, thotë Barleti, i eci fati», ai kish pushtuar mjaft vënde në Azi dhe në Evropë. «Dhe kështu», vazhdon Barleti «barbari, i fryrë nga një rritje aqë e madhe e fuqisë, u kthye nga Skënderbeu për ta shtypur, qëllim që s'e hqite nga mëndja kurrrë». (XI, 419). Por Skënderbeu ishte i pathyeshëm dhe i pamposhtur nga turqit. Ai i dërmoi njerin pas tjetrit kapedanët dhe ushteritë turke që dërgoi kundër tij Mehmeti dhe më në fund edhe vetë Mehmetin, i cili u kthye i turpëruar, si dikur i ati Murat, në Konstantinopojë. Kështu Skënderbeu dërmoi në Mokër Hasan beun me 30 mijë ushtarë, duke e zënë rob në Verë të vitit 1462, Isuf beun me 18 mijë në fushën e Pologut dhe pas tij, në shtator 1462, Karaxhabeun me 40 mijë, në Livad afër Ohrit.

Këto fitore të njëpasnjëshme dhe të ndritura të shqiptarëve, «të lindur për fitore» (XI, 421), siç u thotë Skënderbeu ushtarëvet të tij, e detyruan Sulltan Mehmetin II, këtë sundimtar «të lindjes dhe të perëndimit», siç e quante vehten, t'i kërkonte paqë Skënderbeut, «meqenëse Skënderbeu s'mund të mposhtet me asnjë mënyrë me anë të armëvet». Prandaj Mehmeti mendoi «ta fuste në grackë, po të mundej, me anë të dredhivet e të pusivet dhe ta prishte me anë të mashtrimit otoman». (Po aty).

Mehmeti i dërgoi Skënderbeut një letër, me të cilën i pro-

pozonte që të lidheshin me miqësi për jetë midis tyre (XI, 424). Ai i vinte dy kushte kryesore: të lejonte Skënderbeu kallimin e lirë të ushtërisë turke përmes tokavet shqiptare në drejtim të Venedikasvet dhe t'i jepote Mehmetit si peng besnikërie të birin, Gjonin e vogël. Skënderbeu i dërgoi<sup>1)</sup> atëherë këtë përgjigje:

«Gjergj Kastrioti, ndryshe Skënderbeu, princi i arbërvet dhe i shqiptarëve, i dërgon shumë të fala Mehmetit, prijësit të turqvet.

Letra jote, o prijës i ndritur, m'u dorëzua. Aty ti shkruan se je prekur nga një dashuri shumë e madhe për mua dhe nga një ndjenjë dashamirësie të admiruar, gjë që thua se shpjegohet me atë miqësinë tonë të dikurshme<sup>2)</sup>. Kjo miqësi, që u rrit e zuri rrënje nëpërmjet të shoqërimit tonë të gjatë, duke u kthyer në një veti të pashlyer të natyrës sonë, do ta ruajë për gjithmonë fuqinë dhe forcën e vet. Por, meqenëse tani ajo është si e fjetur për shkak të ndarjes sonë prej një kohe të gjatë, t'u pa e udhës që ta zgjosh nga gjumi, me qëllim që të fillojmë të bëjmë ndonjë paqe e besëlidhje të re ndërmjet nesh. Për këtë ti ke propozuar këto kushte: që ushtëria jote të ketë rrugë të lirë përmes mbretërisë sime, për të plaçkitur vendin e venedikasvet.

Këtë kërkesë tënde, o prijës i ndritur Mehmet, nuk do të ishte sigurisht as e drejtë, as e denjë për mua që ta pranonja, sepse venedikasit janë aleatë me mua dhe të lidhur fort me hallkën e miqësisë. Sa për dëshirën që të kesh si peng pranë teje birin tim Gjon, me qëllim që paqa ndërmjet nesh të jetë e qëndrueshme, unë do ta bëja këtë ndoshta me gjithë qef, o prijës, Mehmet, po të ma lejonte dashuria atërore. Por, duke qenë se ai është bir i vëtëm për ne dhe kërtinjë nga mosha, ta largosh nga përqafimet e prindërve tanë, kur duhet të forcohet e të mbruhet me zakonet tona, s'ka se si të mendohet e dobishme as për të, as për ne. Përkundrazi, atë çka kërkon nga unë për tregëtarët e tu, që të mund të shkojnë ku të duan e të bëjnë tregëti lirisht e pa rrezik në për mbretërinë time, atë e aprovojnë dhe e pranojnë të gjithë kapelanët dhe krerët e mij. Edhe unë një gjë dëshiroj fort, që mbartja e mallravet dhe zhvillimi i tregëtisë për secilën nga palët tona të mund të bëhet lirisht me të dy anët.

Përveç këtyre, ti më këshillon me të madhe që unë të vij

1) Me të dërguarin e Mehmetit.

2) D.m.th. kur Skënderbeu ishte në oborr të sultanit.

pianë teje, madje pa asnjë frikë e merak, me qëllim që, duke parë njeri tjerin dhe duke u shoqëruar së bashku, të nxierrim mallin për gjithë kohën që kemi qenë larg njeri tjetrit. Unë e çmoj fort në këtë rast o prijës i pashoq, mirësinë tënde, bujarinë tënde, dhe do ta përqafonja me guxim këshillën tënde, sikur të ma lejonin tani punët e mia dhe qeverisja e mbretërisë sime. Por ç'të bëj? Djali im, siç e thashë, është fare i vogël dhe aspak i aftë për timonat e pushtetit. Njerëzit e mij, siç e di, s'janë kurrë të qetë, ata janë popuj krenarë dhe të pafre, sa që edhe për mua vetë është shumë zor që t'i drejtoj. Megjithëkëtë, unë do të vij tek ti, ashtu siç më porosit, mjaf-ton që të gjej kohën më të përshtatur për të ardhur.

Qofsh shëndoshë e paç dashuri për mua.

Nga kampi ynë, 30 Maj, njëmijë e 461.. (XI, 425-426).

«Si mori letrën e Skënderbeut dhe pasi e lexoi mirë e mire, barbari Mehmet», thotë Barleti, «i dërgoi një tjetër të tillë». (XI, 426). Me këtë letër të dytë Mehmeti pranonte paqën me kushtin e vëtëm, që pëlqeu Skënderbeu, dhe ndër të tjera i thoshte këtij: «Dhe ty këtej e tutje do të kem dhe do të të quaj gjithmonë: princ i arbërvet dhe i shqipëtarëve» (XI, 426). Paqja u shpall me gëzim të madh për të gjithë, por ajo nuk vazhdoi shumë. «Dhe kjo paqë», vazhdon Barleti, «u ruajt gjer në një farë kohe me besnikëri nga të dy palët; por barbarët pastaj, që s'janë kurrë për t'u zënë besë, sepse nuk e mbajnë besën, u bënë shkakëtarë për dhunimin e naqës» (XI, 427). Dhe Skënderbeu u detyrua t'i shpalte luftën Mehmetit të pabesë.

## XX

### LETËR E SKËNDERBEUT, ME TË CILËN I SHPALL LUFTËN MEHMETIT

Arësyet që u prish paqja e mësipërme, sipas Barletit, janë së pari mësimjet turke në tokat e Skënderbeut. Turqit, thotë Barleti, «hynë të parët në tokat e Skënderbeut dhe pastaj nxuarë që andej një plaçkë shumë të madhe» (po pastaj nxuarë që andej një plaçkë shumë të madhe). Së dyti, turqit plaçkitën viset e venedikasvet në Peloty.

ponez. Skënderbeu ka aleancë tanë me venedikasit. Papa i Romës, Piu II, po organizonte kryqëzatën kundër turqvet, me mendim që të vinte në krye të saj si komandant të përgjithshëm Skënderbeun... dhe me qëllim që t'i zbonte turqit nga Evropa. Këto fakte u kallën drithmën barbarëvet. «Prandaj, vazhdon Barleti, ndër barbarët po ziente kudo sjala se po të dilte në një fushatë të tillë Skënderbeu, fitorja pa dyshim që do të ishte e tij, ndërsa përshtetin dhe fuqinë e Otomanit të gjithë thonin e pohonin se do të thyhej e do të binte në dëshpërim. Kaqë e madhe ishte dridhma, kaqë e madhe ishte lemeria që i kish zënë nga emri i Skënderbeut, kaqë i lemerishëm, kaqë i tmeruar ishte përturqit emri i tij». (XI, 435-436).

Skënderbeut i u kërkua nga venedikasit, me anë të Gabriel Trivizanit, që t'i shpallte luftë Mehmetit (XI, 427). Për të shqyrtuar çështjen, ai thirri në një mbledhje bashkëluftëtarët e tij, jo sepse «s'ishte i prerë në mendimin e vet, por sepse e kishte zakon që të mos bënte asgjë pa u këshilluar me ushtarët». (XI, 430). Më në fund, me nxitjen edhe të Pal Engjëllit, Kryepishkopit të Durrësit, i cili «gëzonët besim e respekt të madh nga Skënderbeu dhe nga Skënderbegasit dhe kishte influencë të madhe mbi ta» (po aty), u vendos që t'i shpallei lufta Sulltan Mehmetit.

Mehmeti, «i trëmbur gjer në palcë» (XI, 435), kërkoi përsëri me letra e njerëz të dërguar tek Skënderbeu që të binte përsëri në ujdi me të e të ruanin paqen, duke e justifikuar se plaçkitjet e tokavet të Skënderbeut ishin bërë paralejën e tij etj. (XI, 427) dhe duke e kërcënuar më në fund se, po të mos pranonte paqen, do të kishte pasojë të rënda dhe do të pendohej përgabimin e tij (XI, 436-437).

Skënderbeu ia dha përgjigjen me këtë letër, në të cilën, ndër të tjera, i thotë:

«... Gjergj Kastrioti, ndryshe Skënderbe, princ i arbërvet dhe i shqipëtarëve, i dërgon shumë të fala Mehmetit, prijësit të shkëlqyer të turqvet.

Ti po u çuditke, o prijës Mehmet, që ushtarët e mij, pasi hynë, siç thua, kundër besëlidhjes në tokat e tua, duke shkelur kushtet e paqës sonë, muarrë që andej një plaçkë shumë të madhe. Shkakëtarë përgatitur këtë ti sjell venedikasit, të cilët i quan armiqjtë e tu më të tërbuar dhe shton se këto gjëra pak të prekin ty, si prijës shumë i fuqishëm që je dhe

që, për shkak të dashurisë fort të madhe ndaj meje, i duron të gjitha pa u turbulluar dhe madje, meqë dhe e bëra këtë i gabuar nga këshillat e të tjérëvet, m'fal të gjitha, mjaftron që ta siguroj me be dhe të lidh me po ato kondita marrëveshjen, që kishim më parë ndërmjet nesh. Dhe përgatitur këtë më shtyn me të madhe, më këshillon e më nxit që ta pranoj këshillën tënde, sepse, në rast se nuk do të dua të vuaj pësojat e zemërimit tënd nga dëshira që t'u bëj qefin venedikasvet, ajo do të jetë në radhë të parë e dobishme, përmua dhe përgatitur pasardhësit e mij. Përveç këtyre, me qëllimi që të më trëmbesh më tepër, po e bën tërkuzë, duke numëruar me radhë, njerin pas tjetrit, fiset, popujt, mbretërit, princërit, që janë dërmuar e shtruar prej teje.

Po ç'farë gjëje të papritur, po të pyes, paska nö këtë mes, o prijës Mehmet, përsë po çuditesh kaqë shumë? Dhe së pari përsë po çuditesh që ushtarët e mij bënë kundër vënët tënd atë që shpesh herë më parë eshtë bërë mbi gjënë e tyre nga ushtarët e tu, gjë përgatitur të cilën me të drejtë u vinte shumë keq dhe qaheshin kundër meje? Përkundrazi, në rast se ata muarrë masat e veta, duke u shpaguar përgatitësinë e bërë me një farë pafrenësie, siç e ke zakon të thuash ti, dhe duke e larë dëmin me dëm. Pa bërë pafrenësi të re, atëherë s'ka asgjë, përgatitur të cilën ti të çuditesh dhe të më akuzosh mua. Unë po e them hapur të vërtetë. Unë do t'i kisha bërë zap vetë ushtarët e mij, megjithëse të cënuar shumë rëndë, dhe do t'i kisha qetësuar zëmrat e tyre aqë fort të ndezura përgatitë shpagimi, sikur t'i, prijësi më i pasur dhe më bujari<sup>1)</sup> ndër të gjithë, të ishe kujdesur që t'u ktheshin atyre gjithë ato që humbën<sup>2)</sup> dhe sikur ta kishe ndëshkuar në këtë rast, siç ishte e drejta, qethurjen e të tuvet, të cilën po e mbulon me velon e pafrenësisë — dëshira zortë denja përfëmijë. Kobet vec, megjithëse kudo janë të rënda, në punët ushtarake duhen gjykuar shumë të rënda. Çfarë, të lutem? Mos do që këtë pafrenësi të të tuvet të ta shpëjgoj unë, sidomos pas dëmit aqë të madh që ata pësuan, megjithëse, ti vetë i kishe në dorë edhe t'i frenoje më parë, edhe t'i dënoje më pas, si e kryen atë punë. Por ne s'kemi ç'të të themi ty më tepër, o Mehmet fort i mençur, përveç këtyre fjalëve tona, të cilat ti na i ke servirur gjer më sot dhe na i

1) Thuhet me ironi.

2) Kuptohet: nga plaçkitjet e gjësë së tyre prej ushtarëvet të Mehmetit.

ke shitur pér bukuri, duke e mbuluar gjithëmonë dredhinë me çfajësimë dhe nën maskën e drejtësisë. Megjithékëtë, pér fajin që u hedh venedikasvet, ndërsa mua më nxirr të larë, i mbuluar prapa miqësisë dhe dashurisë sonë të dikurshme. pér Herkulini<sup>1)</sup> s'ke aspak të drejtë.

Më kot, pra, e ke, o prijësi im, që të ma mbushësh mua mëndjen të heq dorë nga miqësia me ta.

Por as kërcënimet e tua, o prijës otoman, që po i zbras këtu, po i lëshon e po i vjell kundër meje si pas zakonit barbar, s'kanë pér të më trëmbur mua, sepse, edhe të pësosh, kur e do puna, edhe të bësh trimërrira, është arbërore. S'ke pér të ma shtënë frikën mua, një mbretthi të vogël, as venedikasvet të mij. Cili qënka ky sundimtar, siç e quan vehten ti, kaqë i madh i Lindjes, i Perëndimit dhe i gjithë visevet të botës? Me të vërtetë, këtu më bëre që të qesh. Po qeshin gjithashtu edhe princërit e tjerë... Si ia veshe me kaqë lehtësi, që të mos them me kaqë paturpësi, sundimin e gjithë botës vehtes? Ç'janë këto fjalë të zbrazura? Ç'farë zotëron në Azinë e madhe? Asgjë, sigurisht. Mos janë të tuat ato që ndodhen në Azi të vogël? Aspak. Ç'ke në Europë përveç Thrakës, Misisë, një pjesë të Greqisë dhe të Peloponezit, të Mitilenës dhe të krahinës së Taurikës? Në Afrikë këmba jote s'ka shkelur kurrë. Mos është vallë ky sundimi i gjithë botës?

Por shtiru, shtiru, o prijës Mehmet, se gjithë bota, që nga ana e anës së oqeanit, ka rënë skillave në këmbët e tua; nga kjo veç nuk duhet të krenohesh aqë shumë, sa të mos i përfillësh gjithë të tjerët. Pusho, pusho së mburruri dhe nxirr mësimë, po qe i zoti, nga shëmbëllat e shënuara të pa-qëndruëshmërinë njerëzore. Me të vërtetë, ku janë asirët, që e patën dikur në dorë sundimin e gjithë botës? Ku janë medët? Ku persët? Ku grekërit? Ku më në fund romakët, zotërit e botës?

Më i madh sigurisht se ti ka qënë ai Tamerlani, mbreti i Skythasvet, tmerri, siç shkruajnë, i njerëzisë, i cili, pasi e dërmoi në tokat e Armenisë<sup>2)</sup> së bashku me 200 mijë stërvitë.

1) Është shprehje betimi.

2) Është fjalë pér disfatën që pësuan turqit më 1402 në betejën pranë Ankarasë nga Tamerlani (Timuriengu).

gjyshin tënd, Bajazitin e dëgjuar, që kish patur sa e sa sukse se të mëdha në luftë, dhe pasi e kapi në arrati e sipër, e solli si triumfator të lidhur me pranga para qerres së vet. Në ushterinë e tij thonë se kanë qenë një milion e dyqind mijë njerëz, më i madh se Kserksi dhe Dariu, nga ushtëritë e të cilëvet të vjetrit thonë se janë mbuluar detrat e tharë lumenjtë.

Megjithékëtë, të gjithë u çdukën, o prijës Mehmet . . . Prandaj mësoje dhe dije se edhe ti njeri je. Mos ki shumë besim në mizërinë e fuqivet dhe të ushtërivet, se historia na e dëshmon që shpesh ushtëri të mëdha janë prapsur nga ushtëri të vogla<sup>1)</sup>. Prandaj jo pa të drejtë është thënë: «Mos e lumno trimërinë e kapelanit, vecse kur të vijë triumfator».

Pastaj mos të duket se duhet dyshuar, o Mehmet, që çështjen më të drejtë e ndihmon vetë e drejta? Dhe ti e di, e di mirë se kudo ke përdorë dhunë, se të gjitha i ke shtënë në dorë dhe i mban me dredhi e padrejtësi. Pér këtë arësyë mua nuk më mungon guximi, o prijës otoman, që jo vetëm të të dal përpara ty, një sundimtar kaqë të madh, kur më sulmon, por edhe të të grish i pari pa frikë dhe tërë zëmër në fushë dhe të shpresoj e t'ia arrij... një fitoreje të shënuar kundër teje. Edhe ne kemi ushtarë që dinë të qëllojnë, të marshojnë përpara, të hidhen në mes të betejës.

C'më flet, pra, pér nevojën e paqes, se duhet siguruar përsëri ndërmjet nesh? Më kot kërkon të më shtiesh në dorë me dhelka të tilla. Pér mua, shumë e dyshimtë është besa jcte dhe krejt e urryer dashamirësia, sepse, pér çdo gjë që më flet, pér çdo gjë që më zotohesh, ti vepron gjithëmonë duke ndjekur zakonet e të parëvet të tu, me mënyrë të mbuluar e dredharake, ti i bën të gjitha me qëllim që të më shëmbësh e të më lësh pa mbretëri. Megjithékëtë, unë u kam shpëtuar gjer më sot . . . gjithë pusivet të tua, gjithë dredhivet e dhelëpërivet të tua. Por pér së shpejti, pér së shpejti, siç shpresoj, do t'i lash ti duart nga gjithë këto, kur as dredhítë e tua, as dhelëpëritë s'kanë pér të të lehtësuar, kur as zgjuarësia otomane, as mburrja jote prej barbari, s'kanë pér të të vlejtur. Dhe nuk i ushqej vetëm unë këto ndjenja kundër teje... Prandaj, unë në mbështetje të miqësisë sonë të dikurshme, sadoqë ti e ke dëmtuar atë, rëndë dhe e ke dhunuar krejt, mendova prapësëprapi, o prijësi im, që të të bëj

1) Kjo është një e vërtetë sidomos pér historinë e popullit tonë.

të ditur për këto gjëra, me qëllim që, pas një farë këshillimi më të kujdesur, të mbledhesh mëndjen e të marrësh masat për vehten tënde dhe për mbretërinë tënde.

Nga çadrat tona. 25 Qershori njëmijë e 463». (XI, 437-440).

Kjo përgjigje e Skënderbeut, i cili besoi tani se kishte ardhur më në fund koha e dëshiruar prej tij që të bashkoeshin të gjitha forcat që mund ta lagonin rrezikun turk nga Ballkani dhe Europa në përgjithësi, e tërboi dhe e ktheu në një bishë edhe më të egër sulltan Mehmetin egërsirë. Ai i ndezi dhe u dha zëmër ushtarëvet të tij me një fjalim të gjatë e plot kërcënime. Ndërsa kohë Papa Piu II, i cili ish nisur nga Roma me forcat dhe kish arritur në Ankona, vdiq sapo hodi këmbët në këtë qytet. Gjithë ushteria që kish me vehte, u shpërndau. Ky lajm e pikëlloi Skënderbeun dhe ushtarët e tij. Por Skënderbeu, ky «kapedan shpirtmadh e trim mbi trima» (XI, 447) nuk u trëmb, as u trondit, por u dha zëmër e shpirt të gjithëve, «si i patrëmbur e i pathyeshëm që ishte» (XI, 452), me fytyrë të qeshur e me besim kurdoherë të patundur në fitoren. Gjithë kapetanët që dërgoi kundër tij Mehmeti, si dhe vetë Mehmetin, ai i dërmoi e i griu si ngahera. Kështu ai i dha dërmën Sheremetit në Ohër, Ballabanit, i cili, për të justifikuar vehten para Mehmetit egërsirë, detyrohet ta quajë Skënderbeun «rrufe e vetëtimë», Jakupit dhe vetë Mehmetit. Gjatë këtyre përleshjeve dhe betejave fitimtare Skënderbeu, si zakonisht, i këshillonte dhe i ndizte ushtarët dhe bashkëluftëtarët e tij me fjalë e këshilla të ndryshme, sipas rastit. Këto fjalime janë të shkurtër, por plot kuptim. Prandaj po i rrjeshtojmë këtu.

## XXI

### FJALA E SKENDERBEUT PARA PERLESHJES ME BALLABANIN

Sulltan Mehmeti, kur mori vesh kërdinë e Sheremetit në betejën e Ohrit, u tërbua dhe nisi kundër Skënderbeut Ballaban Pashën me 18 mijë ushtarë, një renegat shqiptar nga Badera e Matit. Skënderbeu, duke mbajtur parasysh trimërinë dhe zotësinë e kundërshtarit të tij, që Barleti e

krahason me Tideun e Homerit (XI, 439), meqë ishte i pakët nga trupi, por luftëtar shumë i madh, i këshillon ushtarët para ndeshjes në fushën e Vajkalit, pranë Ohrit, të ruhen e t'i bëjnë sytë katër, sidomos të mos rrëmbehen e futen në grykat e Vajkalit.

«Bashkëluftëtarë të mij, unë kam të dhëna të sigurta se armiqëtë kanë për qëllim që të na ndërsejnë sot për betejën. Por, përpara se të vinë, ne le ta luajmë kampin që këndej dhe le të zëmë të parët kodrinën që është përballë nesh, me qëllim që të mund të jemi më të siguruar. Por kini mëndjen, sepse armiku, kur të na shohë se po largohemi që këndej, do të kujtojë se ne, meqë jemi më të pakë njëherë. Por ju, o burra kryetrima, qëndroini me trimëri summit të tyre, kthehuni kundër tyre, lëshohuni me vrull e pa frikë mbi ta, kalluni tmerrin dhe jepuni arratinë. Unë s'kam dyshim aspak se ne do t'i dërmojmë ata menjëherë. Por ruhuni, o ushtarë të mij trima fort e të pashoq, ruhuni, ju lutem, që, kur këta të kenë marrë arratinë dhe ju t'i ndiqni duke i grirë e bërë copë, të mos futeni me asnjë mënyrë në ato gryka e biga të Valkalise,<sup>1)</sup> të mos bëni këmbë më tutje, sepse atje janë fshehur pritat e barbarëvet. Unë e di, o ushtarë të mij fort të dashur, e di, them, mëndjen e barbarëvet, i di manevrat dhe dredhitë, me të cilat merret me të madhe kjo farë race njerëzish. Këto gryka e ngushtica, pra, që shikoni, o ushtarë të mij të pashoq, janë plot me luftëtarë, që po na presin në pritë. Po hytë atie, s'ka dyshim se s'do mbetet asnjë i gjallë. Mjaftohuni, pra, me fitoren, duke i ndjekur gjer te grykat». (XI, 450).

Besimi i Skënderbeut në fitoren u vërtetua, por edhe porosia e tij u harrua nga tetë «burra luftëtarë shumë trimë», të cilët, «të rrëmbyer nga furia . . . dhe vrulli i luftës, shkuant më tej nga c'duhej». (XI, 451). Kështu Ballabani u raund, por edhe tetë oficerë të dëgjuar të Skënderbeut, ndër të cilët edhe Moisiu, u zunë robër dhe u ropën të gjallë nga Mehmeti në Kostandinopojë, ku ia shpuri si peshqesh Ballabani i dërmuar.

Sulltan Mehmeti i lajmëruar për këtë, bërtiti nga gjazi-

1) Sipas Barletit, (XI, 449) Skënderbeu kishte vetëm 5500 ushtarë.  
2) Valkalia ose Valkali = Vajkali.

mi: «Tani e pranoj me të vërtetë, tani e kam të sigurtë, që Skënderbeu është përmbysur» (po aty). Por Skënderbeu ruk u përbys. Përkundrazi ai, «i zëmëruar më fort nga kjo ngjarje se sa i dëshpëruar, si i patrëmbur dhe i pathyeshëm që ishte», (XI, 452) u lëshua menjëherë mbi viset armike . . . Me këtë shpirt të paepur e vrull të pandalëshëm Skënderbeu i dha dërmën Ballabanit, sepse ai lëshohej mbi armiqës «si rrufe e vetëtimë», sepse «me praninë e tij pushonte çdo furi, merrte fund çdo përlleshje» (XI, 454). Mehmeti, kur morri vesh edhe kërdinë e Ballabanit, ra përsëri në hall e s'dinte ç'të bënte, «të vinte ndonjë tjetër apo Ballabanin në krye të ushtërivet të veta kundër Skënderbeut, i cili ishte krejt i pathyeshëm dhe i pamposhtur, gjersa kishte mundur në luftë sa e sa kapedanë e komandantë si të vet, si të babës Murat dhe kishte shpartalluar e dërmuar me një grusht forcash vetë Ballabanin», komandantin më të shquar të tij. (Po aty). Më në fund, i bindur nga Ballabani, ai vendosi të dërgojë kundër Skënderbeut dy ushtëri njëkohësisht nën komandën e Ballabanit dhe të Jakupit. Këto ushtëri kishin një plan që të vinin në Shqipëri kundër Skënderbeut nga dy drejtime për ta vënë në mes dy zjarresh e për ta dërmuar. Por edhe ky plan i Mehmetit, i propozuar dhe i marrë përsipër për t'u zbatuar nga dinaku Ballaban, dështoi. Sëpari, të dy ushtëritë nuk arritën dot në të njejtën kohë në Shqipëri, por njeri, Jakupi, më vonë se tjetri, Ballabani. Skënderbeu, i cili ishte informuar për këtë plan të armikut, i goditi me shpejtësi njerin pas tjetrit dhe i dërmoi. Para përlleshjes me secilin nga këta, ai u mban ushtarëvet nga një fjalim.

## XXII

### FJALA E SKËNDERBEUT PARA PËRLESHJES SE KËRDISHME ME BALLABANIN

Në këtë përlleshje, e cila u bë në Vajkal, Ballabani kishte 24.000 ushtarë, kurse Skënderbeu 12.000. Para se të nisej kundër Ballabanit ai u foli ushtarëvet shkurt kështu:

«Unë kujtoj se do të ishte turp dhe e tepërt, o bashkë-luftëtarë të mij fort të dashur, që të thurnja sot për ju një fjalë të re dhe të gjatë, se ne na duhet të luftojmë jo me ndonjë armik të ri dhe kapedan të ri, por me atë armik që

është mësuar të mundet dhe të shpartallohet lehtë prej jush. A nuk është ky, o ushtarë, ai Ballabani, kapetan i Otomanit,<sup>1)</sup> i astë, siç e dini më tepër për shatë dhe për pluar e bujqësi, se sa për armë dhe për punë të luftës, të cilin ju jo njëherë, por shpesh e kini dërmuar dhe ia kini arritur fitores mbi të me plackë shumë të madhe? A nuk është kjo ushtëri armike, që kini përparrë syvet, një mbetur i kërdisë së mëparëshme? Po, ato mbeturina po i sjell me vehte për ju kapetan Ballabani, si viktima që ju ka taksur e ju ka borxh... Të gjithë këta barbarë, që po shikon tani... do të jenë pas një ore pothuaj ja robër tuaj, ja, po deshët, të ratë dhe të shuar krejt prej jush, sepse ne, siç shpresoj, do t'i mbyllim ata këtu brënda pahisores si dhentë në vathë dhe do të vendosim e vemë gjithëkund rrëth e qark nëpër malet; kodrinat e shtigjet ushtarët tanë, me qëllim që të mos mund të dalin oëkënde. Të gjithë, pra, bashkë me kapetanin e tyre Ballaban ju falen juve sot si kurban. Prandaj, ushtarë, tregohuni burra, merrni zëmër, merrni flakë nga lavdet e të parëvet, ndizuni nga zulma<sup>2)</sup> e veprat trimërore, qëndroni të fortë si lisat, ndiqni gjurmët, imiton i vepurat e tyre. Mpriheni hekurin kundër barbarëvet, armiqjet tuaj shekullorë, shiloni kuajt, ngjeshti shpatat, rrëmbeni shigjetat, merrni mburojat, merrni të gjitha masat që vlejnë për betejën e për fitoren, ndiqni armiqëtë. Ndrydhini, dërmoini të pabesët, shtypini me këmbë, shkatërroni dhe çfarosini krejt, se, ja po ua mbathin». (XI, 459).

Pas këtyre fjalëve të paka, me të cilat Skënderbeu kërkon nga ushtarët e tij që të tregohen pasardhës të denjë të të parëvet të tyre, Barleti shton:

«Pasi u dha fund këtyre fjalëve, Skënderbeu po i ftorë të gjithë me radhë një nga një para tij, po i blatonë secilit e po i lutej fort që të merrte prej tij sidomos ato gjëra, që do të përdoreshin për kafshët. Ai ua jepte të gjitha me emblësi dhe pa kursim, kurse ushtarët po hanin sedër me modesti që të mos merrnin asgjë më tepër nga c'duhej; ata „ik vonoheshin asnjë grimë dhe nuk mbeteshin prapa llamujvët; ata ecënë natë e ditë dhe mezi pushonin aqë sa është nevoja natyrorre e trupit, duke e ngrënë bukën me rrëmbim. Ballabani ndodhej po thuaj 15 mijë hapa larg që andej. Kështu Skënderbeu po afrohej dhe, kur arriti pranë luginës, këi ki-

1) D.m.th. i Mehmetit otoman.

2) Lavdia.

shtë ngulur çadrat Ballabani, zuri majën dhe kodrinën e luginës dhe, pasi nguli atje çadrat, e mylli dhe e rrëthoi armikun si me gardh, duke vënë kudo nëpër qafat e malevet ushtarë në formë kurore. Duke drejtuar ushterinë nëpër vendë të larta, ai zuri grykat e ngushta me qëllim që të myllite kalimin dhe ta zinte ushterinë nga krahët apo nga prapa shpine. Kështu ai ia punoi armikut me të gjitha mënyrat e luftës». (XI, 459-460). Dhe Barleti vazhdon:

«Të nesërmen u mbajt një mbledhje, në të cilën qenë të pranishëm edhe Tanush Topia, Zahari Gropa dhe Pejko Manueli, kapedanë të kampit. Shumica anonin nga mendimi që të shtyhej koha e përleshjes, gjersa ta çlodhnin ushterinë e këputur nga udha dhe pagjumësia dhe Tanushi të merrte njëkohësisht pak ditë për të njohur armikun. Skënderbeu jo vetëm që përpiquej t'u mbushte mëndjen, por edhe kundërshtonte me tërë fuqinë dhe ngulte këmbë që planin e tij, të cilin shpejtësia e kishte bërë të sigurt, të mos e kthenin në rrezik me anë të të vonuarit. «Gjersa Jakupi po vonshet si i mpirë, pa ditur asgjë për këto ngjarje, ushteria e Ballabanit ka mundësi të shkatërrohet me lehtësi. Përkundrazi, po e shtymë për të nesërmen, ne do t'u japim atyre kësh që të bashkohen dhe do të bëjmë që puna jonë e sigurtë të vihet në dyshim përsa i përket përfundimit të saj. Duhet dhënë menjëherë shënja dhe duhet dalë menjëherë në betejë dhe duhet përsituar nga gabimi i armiqvet...» (XI, 460).

Këto fjalë të Barletit tregojnë më së miri gatishmérinë e ushtarëvet të Skënderbeut, sedrën e madhe të tyre dhe fuqinë e paepur të shpirtit e të trupit për të duruar çdo mundim e lodhje dhe për t'u lëshuar kundër armikut, kur e do puna, edhe atëhere, kur janë të raskapitur e të këputur me besim të patundur në fitoren dhe në kryetimin e tyre. Ato tregojnë gjithashtu mëncurinë taktike të Skënderbeut dhe rëndësinë që ai i jepte shpejtësisë si një moment vendimtar në taktikën ushtare, e cila, siç ka thënë gjetkë, shpesh i përbys planet dhe siguron fitoren. Dhe plani i Skënderbeut siguroi edhe në këtë rast një fitore të shkëlqyer e të rrallë. Barleti na thotë se Ballabani, kur e pa se me gjithë përpjekjet e tij «fitorja ishte pa dyshim e shqipëtarëve dhe se nuk mund t'i bënte ballë më betejës, i dha kalit dhe ua mbathi sa mundi më shpejt dhe gjithë ushteria, gjithë radhët, të përziera dhe të ngatërruara, muarrë arratinë duke u shpërndarë sa andej këndej nëpër luginë, nëpër fushë e nëpër

male, ashtu siç ia lejoi secilit. Të pakë qenë ata që e ndiqën kapedanin pas dhe që mundën të dilnin gjallë bashkë me të nëpër mes të kërdisë dhe të pështjellimit; gjithë barbaret e tjerë ose u vranë, ose u zunë të gjallë. Me të vërtetë, po që se provonte kush të dilte nga lugina, duke ikur pa u vënë re nëpër mes të pështjellimit dhe tërbimit të ushtarëvet, ai vritej nga ata që kishin zënë majat e malevet dhe kodrinat. Dhe kështu ushteria e Ballabanit u dërmua atë ditë dhe pothuaj u shkatërrua krejt». (XI, 462).

## XXIII

### FJALA E SKËNDERBEUT PARA PËRLESHJES ME JAKUPIN

Jakupi arriti ashtu siç e kish parashikuar Skënderbeu. Barleti thotë: «Këtë fitore kaqë të madhe dhe të ndritur e pasoi menjëherë një furtunë e re dhe një ardhje e re e ushtërisë armike. Dhe me të vërtetë, Skënderbeu s'kishte dalë ende me ushterinë nga lugina, ushtarët s'e kishin ndarë ende në mes tyre plaçkën e ushtërisë së Ballabanit, trupat e armiqvet, të shtrira përdhe, po dergjeshin ende duke përpëllitur, kur lajmëtari i së motrës Mamicë, nga qyteti i Petrelës,... ia mbriti fluturimthi me një letër tek Skënderbeu. Me këtë letër ajo e njoftonte të vëllanë se Jakup Acnauti, kapedan dhe udhëheqës ushterie i prijesit Mehmet, së bashku me gjashtëmbëdhjetë mijë kalorës, kishte hyrë përmes rrugës së Belgradit<sup>1)</sup> në Shqipëri dhe se i kishte ngju tanë çadrat në Tiranën e vogël, pranë lumit që quhet nga banorët Argilat..., ish një burrë trim e luftëtar që edhe hera të tjera kish kryer pranë Mehmetit dhe në dobi të tij, si në Azi, si në Europë, shumë veprë të ndritura». (XI, 462).

Skënderbeu edhe këtë «furtunë të re» e ktheu me mëncurinë dhe zotësinë e tij dhe të ushtarëvet të tij në një fitore të dytë të shkëlqyer dhe të denjë për emrin dhe lavdinë e atdheut. Beteja, e zhvilluar në fushën e Kasharit dhe në agim të diellit, përfundoi në kërdi të plotë për armikun, duke rënë i vrarë nga dora e Skënderbeut të pathyeshëm edhe vetë Jakupi. Para kësaj përleshjeje, Skënderbeu u mbaj-

1) Beratit. Jakupi hyri në Shqipëri nga Jugu, kurse Ballabani nga Veriu.

ti ushtarëvet fjalen e mëposhtëme, e cila është gjithash tu një hymn i vetivet dhe shpirtit të lartë të tyre, të këtyre bij luanë të popullit tonë, që mbrojnë burrërisht atdheun.

„Megjithëse edhe herë të tjera nxitja e ushtarëvet prej kapedanit apo komandantit është parë fare pak e nevojshme, sot sigurisht kjo detyrë përmua mendoj se është edhe më pak e nevojshme kundrejt jush, o bashkëluftëtarë të mij, sepse, kur kali, si i thonë një fjale, është duke vrapuar dhe nget me të katra, është e tepërt dhe pa vënd që t'i japësh me manuza. Dhe me të vërtetë, unë e shoh, o ushtarë të mij fort të dashur, se secili prej jush, pa urdhër të komandanit, pa porositë e kapedanit, qëndron i gatshëm me gjithë zëmër, mban rregullin, u shkon prapa flamujvet dhe bajraqe-vet të veta, bën e rri roje, kryen detyrat dhe shërbimet prej ushtari me sedër; unë e shoh se ju jeni tërë kujdes, të pa- fjetur e të palodhur ditë e natë, që s'rrini kurrë pa punë, kurrë në plogështi e pushim, por që jeni të ndezur e fort të gatshëm pa zegtha e manuza dhe të patrëmbur e të pam- poshtur përm ballë çdo gjëje që vlen përfitoren dhe që ndih- mon përm tia arritur fitores, që sulmoni veç kësaj dhe shtypni armikun me zëmër e trimëri të pazakontë, që s'e humbni kurrë besimin, as shpresën përfitore. Prandaj, në qoftë se i është lejuar dikur kapedanit apo komandantit të kreno- het përf ushtarët e vet, kjo gjë mua më është lejuar në çdo kohë përf ju, sepse me ju, sadoqë kemi qenë gjithmonë më të pakë se armiqtë, megjithëkëtë kemi dalë kurdoherë mbi ta.

Sot ne, ashtu siç e dëshironit ju me të madhe, ia kemi arritur një fitoreje të shkëlqyer dhe të rrallë kundër Ballabanit, armikut tonë më të egër, i cili, me autoritetin dhe besimin e madh që gëzonte pranë Otomanit, arriti të ketë kundër nesh dhe t'i jeplet çdo gjë që kërkoi prej tij dhe çdo gjë që i desh zëmra. Dhe me të vërtetë, pasi mbloodi një ushteri shumë të madhe dhe të freskët dhe u lëshua kundër nesh me tërë forcat, me qëllim që të plotësonte dëshirën e vet dhe të mund të mbante fjalen që kish dhënë<sup>1)</sup>, përfitoren e sigurtë që do të arrinte mbi ne, kujtoi se do të na zinte në

1) Ballabani e kish siguruar Mehmetin se me planin e tij do ta thyente pa tjetër Skënderbeun (XI, 457). Dhe rreziku, siç gjykon edhe Barleti (XI, 458), ishte i madh përf Skënderbenë.

befasi dhe do të na mbërthente me dy ushtëri nga më të më- dhatë, se do të na dërmonte dhe shkatëronte me dhëpë- ri e prita. Por, me ndihmën... dhe trimërinë tuaj, ndodhi që ne t'i lëshoheshim atij të parët dhe ta shuanim së bashku me tërë ushterinë e tij, duke i dhënë dërmën e duke bërë kërdi në të. Tani, përkundrazi, që ne, si i thonë fjalës, ende s'i kemi larë duart<sup>2)</sup>, tani që s'ka mbaruar ende gostia e s'janë ngritur ende sofrat, Jakup Arnauti, si ndonjë gostar i mirë e fort bujar, dëshiron ta shtrojë drekën së njëzaj dhe të mos i mashtrojë mysafirët e vet, por t'i presë mirë dhe si askush tjetër përmos i marrë uria, duke sjellë ushtë- rinë e vet si tepëricë<sup>3)</sup>. Ja, ushtarë të mij fort të dashur, para se të dilnim nga lugina, para se t'i lanim duart tonë, të ndotura nga gjaku armik, para se të thanim shigjetat e të pastronim armët dhe para se t'i fusnim në mill e në kë- llëf, na erdhë Jakupi përm t'ju sjellë juve blatimet e veta, peshqeshet dhe dhuratat e kushtuara, d.m.th. ushterinë dhe tepëricat e dërguara kundër jush nga Otomani, me qëllim që të shijoni apo të kapërdini prej tyre çdo gjë që do të dëshironit.

Kështu, pra, shokë dhe burra kryetrima e fortë të lumur, le të shkojmë në dasmën, ku na fton Jakupi, ku na grish, me qëllim që, pasi të hamë dhe ngopemi sa të velemi, të marrim edhe me vehte. Le të hiqemi, pra, qëkondëj, le të dali, le të vrapojmë kundër Jakupit dhe ushtërisë së tij, e cila është pa dyshim e pakët<sup>3)</sup> dhe vetëm e dërmuar. Me të vërtetë, në rast se ne e bëmë copë Ballabanin bashkë me 24 mijë vetë, përsë nuk do të shkojmë në thikë Jakupin me 16 mijë, sidomos në këtë zjarr tuaj luftarak, kur s'e kini pu- shuar ende furinë e luftës, kur s'i kini shuar ende ndjenjat dhe vrullin luftarak? Mua më duket, o ushtarë, se po e sërh Jakupin të më sillet para syvet i vrarë prej jush dhe i dërmuar së bashku me tërë ushterinë e tij. Prandaj le të shpejt- tojmë kundër tij, le të nxitojmë të mbushim e të ngopim oreksin tonë dhe përpinquni tani me tërë forcat që të kthehi në shtëpi, pranë vatravet, fëmijëvet dhe gravet tuaja, të

1) Kuptohet: nga gjaku armik.

2) Barleti flet me figurë, duke e krahasuar luftën e turqvet me një sofër e gesti vërf ushtarët trima të Skënderbeut, me një dasmë përt ta.

3) E thotë në krahasim me ushterinë e Ballabanit.

ngarkuar e plot e për plot me plaçkë e pasuri armikës.  
(XI, 462-463).

Fjalën Skënderbeut ushtarët ia muarrë nga goja dhe e pritën edhe kësaj radhe, si kurdoherë, me gatishmëri të paparë, megjithëse s'kishin mbaruar ende mirë punë e s'ishin çlodhur nga beteja dhe fitorja kundër Ballabanit. Barleti, duke vazhduar me figurën e bukur të tij, thotë: «Ushtarët, para se Skënderbeu të mbaronte mirë së foluri, u ndezën nga një zjarr aqë i madh për t'u përleshur, sa që të gjithë bërtiten njëzëri se duhej vrapuar kundër armikut për të kaqzëdirë tepricat e drekës, që Jakupi i kish sjellë për t'i shtruar» (XI, 463-464). Dhe shqiptarët i kapërdinë si jo më mirë armiqës e tyre: 24 mijë, thotë Barleti, ishin ushtarët e vrarë në këto dy beteja dhe 6 mijë robrit. Ata që shpëtuan u çfarosën më të ikur e sipër nga malësorët e egërsuar.

Për kërdinë e turqvet në këto beteja Barleti thotë këshfu: «Kurrë s'janë vrarë nga Skënderbeu pothuaj në të njëjtën kohë e betejë kaqë armiq dy ushtërish» (XI, 464). Kur se Skënderbeu, për mbeturinat e këtyre ushtërivet që po largoheshin -pa flamuj, pa ndonjë rregull-, d.m.th. si një ushtëri e shkatërruar dhe e dërmuar dhe që mund të çdukej e gjitha nga faqja e dheut, po të ndiqej nga ushtëria fitimtare shqiptare, tha: «Le të mbeten disa lajmëtarë të kërdisë së armiqvet dhe të trimërisë sonë, pas fitores që arritëm mbi ta» (XI, 465).

Pas këtyre fitoreve të ndritura e të njëpasnjëshme, Skënderbeu u kthye «tërë gaz e gallim» në Krujë, ku u priti si ndonjë triumfator me brohori e klithma gjëzimi nga populli që s'i gëzohej dot.

#### XXIV

### FJALIMI I SKËNDERBEUT NË MBLEDHJEN E PRINCERVET

Lajmi i kërdisë së Ballabanit dhe Jakupit i shtiu dridhmen Mehmetit, për të cilin Skënderbeu ishte bërë një «datëkallës i tmerruar» dhe i cili kishte frikë tani se mos, për shkak të emrit të dëgjuar të kryetrimit tonë, «që tanimë kish marrë dhenë e mbahej kudo në gojë, gjindja dhe popujt

e tij ngrinin krye dhe e vrissnin apo e rrëzonin nga fronti» (XII, 467). Prandaj, pasi dështuan përpjekjet e tij për ta vrarë Skënderbeun me kurihe të kurdisura e me mënyra të pabesa (XII, 468), vendosi të vinte vetë kundër Krujës me 200 mijë ushtarë. Ai e rrethoi Krujën, por s'bëri dot gjë dhe u detyrua të largohej me turp, duke lënë për të vazhduar rrëthimin Ballabanin me 80 mijë ushtarë. Skënderbeu para këtij rreziku, «thirri nga të katër anët princërit, shokët che të konfederuarit» (po aty), dhe u foli si më poshtë, duke kërkuar ndihmën e tyre dhe duke shprehur besimin e patundur në fitoren.

«Unë besoj se ju e kini fare të qartë, o princër dhe bashkëluftëtarë të mij fort të dashur, se për ç'arësy ju kam thirrur këtu dhe se ç'kam ndërmënd të bisedoj sot me ju. Dhe me të vërtetë, ju që të gjithë e dini se me sa tërbim dhe me sa egërsi është përbetuar... kundër nesh ai sundimtari i turqvet, Mehmeti. Këtij unë mendoj se duhet t'i qëndrojmë si burrat dhe të luftojmë me të rreptë, qoftë edhe sikur të qëllojë të vdesim.

Të parët e tij përbysën së pari Azinë, pastaj, duke u hedhur në Europë, çdukën nga faqja e dheut me mënyra të poshtra sa e sa mbretër e princër... Ky, përkundrazi, duke ndjekur gjurmët e tyre, pasi i ktheu, si i thonë fjalës, kicat<sup>1)</sup> kundër nesh si mbeturit të të parëvet të vet,<sup>2)</sup> po përpjigjet ta vjellë tërbimin e ta çdukë krejt emrin tonë. Ky, Mehmeti, them, shumë i egër, i cili, si prej ndonjë fati, është bërë për mua një armik pothuaj i përherëshëm, po orvatet me forcën e fuqinë më të madhe të më çdukë krejt mua dhe tërë mbretërinë time. Ky, duke u larguar që këndeji si ndonjë i xhindosur e krejt pa shpresë për shkak të pikëllimit e hidhërimit, pas sulmit që bëri para pak kohe me tërë ushtërinë e vet kundër meje dhe që s'i doli ashtu siç e priste, vrav dhe çduku me hekur tetë mijë burra nga të mitë,<sup>3)</sup> pa zënë gratë dhe fëmijët, burra që i ranë në dorë duke i zënë besë fjalës së tij apo, më mirë, pabesisë së tij. Këta, po të ishin

1) Anijet (drejtimin e anijevet).

2) D.m.th. si të vetmit që kishin mbetur pa u çdukur nga të parët e tij.

3) Janë 8 mijë burra të Kidnës në Dibër, asër Drinit. Sipas F. Nolit, (Hist. Skënd. Tiranë 1962, f. 111), gratë, pleqtë dhe fëmijët ishin 20 mijë.

gjallë dhe t'i kisha unë tanë, më siguri që nuk do të ishte aspak nevoja të lypnja ndihmën e tjetëkujt.

Duke u larguar, pra, o princër të pathyeshëm, Mehmeti qëkëndej, la për rrëthimin e Krujës këtë Ballabanin, që kemi para syvet, komandantin e ushtërisë së vet, së bashku me këto forca, me qëllim që ta mbajë atë të rrëthuar dhe ta ndrydhë me anë të një rrëthimi nga më të egërët dhe për një kohë aqë të gjatë, sa të bjerë në dorë të tij. Sikur të ngjiste kjo gjë... nuk do të ishte sigurisht mirë, siç kujtoj unë, as për ju, as për gratë dhe fëmijët dhe as për gjithë punët tuaja. Dhe me të vërtetë, mua më kujtohet ta kem thënë shpesh se ky armik i tërbuar e fort i egër asgjë tjetër nuk kurdis, asgjë nuk bluan në mëndje dhe nuk pret, veçse të na shtypë e të na çdukë të veçuar e të ndarë, të rrëmbejë dhe t'i marrë për vehte mbretëritë dhe shtetet tona. Prandaj, o princër fort të dashur, mos lejoni që ky tiran i pabesë është armik i përbashkët për të gjithë të na verë neve zgjedhën e pabesisë dhe të prapështisë së vet,... që të marrë nënërr këmbë mbretëritë dhe shtetet, që të heqë në skllavëri gratë dhe fëmijët tanë. Prandaj ju këshilloj të gjithëve, ju lus e ju përbetoj që të vraponi t'i delni pa vonesë përpëra armikut, i cili ndodhet para dhe në prak të portavet dhe po shpejtën e nxiton me tërë fuqitë që të na shtypë. Prandaj ju bëj thirrje... për ndihmë dhe mbrojtje... ju ftoj e ju lus që ta përzemë, që ta nxjerrim jashtë nga qyteti ynë, nga mbretëria, nga atdheu këtë Ballaban që shikoni, armikun tonë të përbashkët, i cili pa dyshim, po më shtypi mua, edhe juve s'do t'ju lërë pa ndëshkuar, sepse Shqipëria është në armiqësi me turkun, kështu që, pas fatit tim, do të vijë pastaj edhe i juaji dhe i të gjithëvet.

Ne e kemi çveshur shpatën kundër egërsirave; duhet përgjaku i tyre, ose duhet derdhur yni. Por unë ju siguroj që, me ndihmën dhe përkrahjen tuaj, po t'i kem, këtë Ballaban burracak, pa asnjë vlerë dhe më të humburin e njërrzvet... që vetë është turpëruar shpesh herë më parë, siç e dini, prej meje, është shpartalluar e dërmuar me kërdira të panumura, pasi t'i jap tanë arratinë së basiku me gjithë ushtërinë e tij, t'jua dorëzoj juvë të gjallë apo të vdekur, si ta ketë fatin, dhe t'ia arrij kundër tij një fitoreje të shënuar e fort të ndritur.

Ju e dini, o etër fort bujarë, se unë s'kam kërkuar gjer

më sot asnjë ndihmë apo përkrahje nga ju, por ju kam mbrojtur e ju kam shpëtar juve, mbretëritë dhe pushtetin tuaj, gjithëmonë i vetëm, me forcat dhe ushtarët e mij. Por tanë, i dërmuar prej gjithë atyre luftrave, i shkuruar prej gjithë atyre fushatave, duke qëndruar pa pushim me armë së bashku me ushtarët e mij për një kohë aqë të gjatë, janë shkundur pothuaj e s'kam më fuqi, sepse pjesa më e madhe e tyre dhe ata më trimat kanë rënë në luftë, të tjerët janë zënë duke luftuar me rreptësi shumë të madhe, ose janë bërë të pavlefshëm për luftë, duke mbetur me trup të gjymtuar nga plagët e shuma. Për këto arësyte është nevoja, shokë, që unë t'ju drejtohem juve dhe të kërkoj ndihmën tuaj, me qëllim që të shpëtoj e të mbroj qytetin tim dhe juve njëkohësisht nga ky armik i përbashkët që kemi te dera dhe para syvet. Prandaj, ndihmomëni me kohë, ndiqmëni pas dhe fitoni, siç e kini zakoh ngaherë të bëni, me mua në krye. Të lëshohemi kundër kësaj ushtërie turke dhe armike, ta sulmojmë dhe menjëherë, siç shpresoj, do t'ia arrijmë fitores mbi të, do të marrim prej tij me vehte armë, flamuj, ar, argjend, plackë të majme...

Përpëra, pra, së bashku me mua për një punë kaqë të madhe, sepse... shpresoj se me ndihmën tuaj të gjithë do të dalim fitimtarë dhe ju do të kthehi më shtëpi, pranë vatravet tuaja, triumfatorë të ngarkuar plot me të mira e me lavdi për vehte e për të gjithë. Unë, me të vërtetë, s'ju kam gabuar kurrë, s'ju kam lajthitur kurrë. Tani është koha, shokë, që ne të shpëtojmë dhe të çlrojmë vehten dhe mbretëritë tona, gratë, fëmijët, alteret dhe vatrat nga tirania dhe nga zgjedha e robërisë dhe e skllavërisë barbare, të arrijnë fitoren mbi armikun me lavdi e triumf të paparë... (XII, 470-472).

Përmënyrën se si e pritën dhe se si iu përgjigjën kësaj fjale të Skënderbeut princërit shqiptarë, Barleti thotë:

„Si foli kështu Skënderbeu, të gjithë ata princër e kapedanë, duke marrë zëmër nga kjo fjalë dhe duke këcyer e vrumulisur nga gëzimi, bërtiten vetiu njëzëri se duhej vënnë përpëra armiku me tërë zotësinë e me tërë fuqitë që kishin, pa kursyer as edhe gjakun, për të mirën e për shpëtimin e atdheut, për paprekshmërinë e Skënderbeut; se duhej lëshuar me trimëri e pa frikë kundër kampit turk; se i duhej shkuar pas me një mëndje dhe me një zëmër dhe së i duhej bindur në çdo gjë Skënderbeut, prijësit, kapedanit,

çirimtarit, princit dhe mbrojtësit të atdheut dhe të të gjithëvet. Dhe kështu të gjithë ia besuan dhe ia lanë vehten bashkë me tërë forcat dhe ushterinë e vet në dorë Skënderbeut». (XII, 472).

Pas kësaj u vendos dhe u caktua me urdhër që të mbledhë nga çdo anë një ushtëri sa më e madhe dhe sa më e fuqishme. Njëkohësisht, gjatë kohës që po kryhej kjo punë, Skënderbeu u nis për në Romë me qëllim që të kërkonte ndihmë... Skënderbeu, «i veshur», thotë Barleti, «me mallotë të zakonëshme ushtarake dhe me rrøba shumë të thjeshta» (po aty), u prit me nderime të mëdha e me brohoritje entuziaste. Ndihma që pati ishte vetëm ndihmë në të holla. Skënderbeu nga Roma, siç thotë F. Noli (v.c, f. 112), shkoi tek Ferdinandi, nga i cili pati gjithashtu ndihmë në të holla, dhe mendonte të shkonte edhe në Venedik, por puna s'priste, prandaj u kthyesh shpejt në atdhe. Këtu gjeti të mbledhur «një ushtëri shumë të madhe dhe forca të papara e të fuqishme», thotë Barleti (XII, 476). Me këtë ushtëri, të ndarë më trish, Skënderbeu u drejtua kundër Ballabanit në Prill të vitit 1467. Natën e 26 Prillit zuri rob të gjallë Jonuzin (= Jonuzin), të vëllanë e Ballabanit, bashkë me të birin Heder (= Hajdar). Të nesërmen u vra edhe Ballabani vetë nga një krutan, që quhej Gjergj Aleksi. Turqit u shtrënguan ta heqin rrëthimin dhe të largohen duke u tërhequr në fushën e Tiranës. Këtu turqit i propozuan Skënderbeut t'i jepnin «armët, kuajt e sdremet» mjafton që t'i linte të lirë të shkonin në Turqi. Skënderbeu, i cili nga ana e tij ishte i mendimit se duhej evituar përlleshja, thirri në mbledhje kapedanët dhe ushtarët e vët me qëllim që ta shqyrtonin çështjen dhe të vendosnin. Të gjithë u shprehën njëzëri se armiku «duhej sulmuar dhe se duhej luftuar me të shumë rreptë», kurse Skënderbeu, me qëllim që t'u mbushte mëndjen për të kundërtën, u mbajti një fjalim të shkurtër, por pa ia arritur qëllimit.

## XXV

### NGA FJALIMI I SKËNDERBEUT PAS VRASJES SE BALLABANIT

«Unë e kam njobur që kuri, o burra kryetrima dhe bashkëluftëtarë të mij, burrërinë, unë e njoh mjaft mirë trimërinë dhe qëndresën tuaj, me të cilën e kini tmerruar

gjithëmonë keq barbarin, e kini thyer në lufë, e kini bërë që të marrë arratinë, dhe as që kam frikë se juve sot ju mungon guximi, se ky armik gjithashtu, që kemi para syvet, s'ka për t'u shpartalluar dhe për t'u dërmuar prej jush. Por duhet mbajtur përasysht, o ushtarë të pashoq, duhet sjellur shpesh në mëndje ajo fjalë e të urtit: «Të kërkosh në kohë të qetë stuhinë, është çmënduri. Përkundrazi, t'i kundërshtosh asaj për çfarëdo arësy, kur të shtrëngon koha apo nevoja, është urti». Neve na erdhi fitorja vetë,<sup>1)</sup> pa hekur, pa përlleshje, pa vrassje. Qyteti u lirua nga rrëthimi. Ballabani, armiku ynë, që na solli gjithë ato mjerime dhe që na kërcënonët cdo ditë, mbaroi. Ushtëria e tij ua mbathi. Jemi në paqë, jemi në qetësi, cdo gjë po na qesh me buzë në gaz. Përse të kërkojmë luftën? Përse të dëshirojmë stuhinë e keqe? Përse të provojmë fatin e verbër dhe të pasigurtë? Ju e dini sigurisht, o ushtarë, se sa i pandreqëshëm, sa i pakorigjuëshëm ësntë gabimi i Marsit<sup>2)</sup>. Dhe me të vërtetë, në qoftë se gabimi bëhet në raste të tjera, ai mund të qortohet e të ndreget. Por, pas gabimeve në beteja, s'mbetet më vënd për ndreqje. Prandaj ata kapedanët e vjetër fort të lavdishëm nuk kanë dashur aqë që ushtëritë të janë të panumura, sesa që të janë të stërvitura në armë... kundërshtarë nuk duhet ta nënçnosh, kurrë... Përkundrazi, edhe pasi të ketë marrë fund lufta, pasi të jetë arritur fitorja, nuk duhet patur më pak kujdes se sa në fillim. Dhe nuk duhet ndeshur apo përleshur ndonjëherë me armikun pa menduar mirë.

Kjo fjalë plot këshilla të urta, por frenonjëse e Skënderbeut, nuk mundi aspak t'i qetësonte ushtarët, burra që «janë lindur për armë dhe që çfryjnë me armë». Kundërshtimi i tyre ka qënë i fortë dhe i vështirë për t'u përmbarajtur, por megjithëkëtë ata nuk u treguan të pabindur e rebela. Ata vepruan ashtu siç mendoi Skënderbeu, por ata e akuzuan më në fund atë si fajtor që barbarët ikën pa u ndëshkuar. Ja se si e përshkruan Barleti qëndrimin e tyre të admirueshëm:

«Me këto fjalë të Skënderbeut, zëmrat e ushtarëvet nuk mundën të qetësohen aspak; përkundrazi, ata u bënë edhe më të guximshëm dhe u egërsuan më tepër kundër ar-

1) Sepse turojt, pasi u vra Ballabani, u tërhoqën dhe e lanë Krujën pa kundërshtuar, vetë.

2) I luftës, gabimi në luftë.

mikut, u rrëmbyen më keq nga tërbimi dhe u ndezën e u xhindosën edhe më tepër. Pastaj ia dhanë një klithme e britme nga çdo anë dhe një zhurmë e madhe u bë e kampi i tërë buçiti: «Duhet marshuar pa frikë kundër armikut, që po merr pa tjetër arratinë dhe që tanimë është dërmuar, sihe duhet lëshuar me rreptësinë më të madhe mbi të... Dhe hovi e vrulli i këtyre me zor mundi të frenohej e të bëhej zap nga kapedanët dhc krerët e kampit, duke u lejuar që menjëherë, sa po të ishte siguruar qyteti i Krujës me grurë dhe ushqime, ta ndiqnin armikun siç ua donte zëmra dhe të sulmonin kampin e tij. M'anë tjetër Skënderbeut kishte dhënë urdhër që t'u mbylleshin barbarëvet vëndet e kalimit, rrugët e shtigjet, me qëllim që të mos mund të ikën e të mos u vinte ndonjë ushqim apo ndihmë.

Ndërkaqë, ndërsa ushtarët skënderbegas po merreshin me kujdes prej tri ditësh me sigurimin e qytetit, Skënderbeut i erdhë lajmi se barbarët, të cilët e kishin ngritur kampin në Tiranë, të shtrënguar nga uria ekstreme, ishin larë së andejmi fshehurazi gjatë asaj<sup>1)</sup> nate, me shënjen e rojes së dytë<sup>2)</sup>, . . . dhe se s'kishin mundur megjithëkëtë t'u shpëtonin rojevet,<sup>3)</sup> por, pasi bënë me ta dhe me banorët një përlleshje shumë të madhe, ia hapën më në fund rrugën vehtes dhe duallë me kërdi veç me vrasje të paparë të njërzvet të tyre dhe me humbje shumë të madhe të stremevet.

Kur e muarrë vesh këtë, ushtarët skënderbegas u zëmëruan keq dhe duke çfryrë kudo dhe u qanë me të madhe kundër Skënderbeut dhe ia hodhën atij tërë fajin që barbaret kishin ikur pa u dënuar. Më në fund ata u qetësan me përkëdhelje dhe dhurata të shuma dhe Skënderbeu i ra me kalë gjithë vëndit dhe i zuri ose i vrau gjithë rojet turke dhe barbare që ndodheshin atje. Dhe kur i tërë vëndi fitoi paqen e qetësinë, Skënderbeu, pasi i përuroi shokët fort dhe u dha sa më shumë dhurata, u nda prej tyre me fytyrë të qetë e të gëzuar, ndërsa ata . . . u kthyen në shtëpi të kënaqur e tërë gaz, Kështu ai vit që për Skënderbegasit i shënuar dhe i gëzuar». (XII, 479).

1) Kuptohet: që erdh pas ditës së tretë.

2) Roja e dytë = roja e dytë e natës. Roja e natës ishte triorëshe dhe ndarrohej katër herë çdo natë duke filluar nga ora gjashtë e mbrëmjes.

3) Janë rojet që Skënderbeu kish vënë për të zënë rrugët e shtigjet me qëllim që t'u hiqej barbarëvet mundësia e kalimit.

## FJALET DHE KËSHILLAT E FUNDIT TË SKËNDERBEUT NË LEZHË PARA VDEKJES SE TIJ

Sulltan Murati egërsirë, pas dështrimit të fushatës së tij kundër Shqipërisë, siç e pamë më lart, vendosi të vinte përsëri vetë kundër Skënderbeut me një ushtëri shumë të madhe dhe të fuqishme, që e mblođhi nga të katër anët, dhe me qëllim që të lante turpin që hëngri. Ai erdhë kësaj radhe nga ana e Elbasanit dhe e ngriti së pari kampin në fushën e Saurës. Që këndejej u drejtua kundër Durrësit, me qëllim që ta pushtonte, dhe pastaj, pasi s'bëri gjë, erdhë e rrëthoi Krujën (XIII, 481-482). Por edhe kjo fushatë e tij dështoi dhe ai u detyrua të largohej përsëri nga Shqipëria «me turp, tërë vrer e trishtim» (XIII, 483).

Gjatë kësaj fushate, Mehmeti ndërttoi fortesën e Elbasanit (= qyteti i Valmëvet, siç e quan Barleti), duke ngushtuar e forcuar kështu, siç thotë Noli, «hallkën e hekurt rrëth Krujës». Përveç kësaj, para largimit, ai sheshoi fortesën e Cirilevet në kep të Rodonit, të cilën Skënderbeu nuk e kishte përfunduar.

Skënderbeu, për të larguar rrezikun që shtohej me ndërtimin e fortesës së re (Elbasanit), vendosi të mbledhët një ushtëri të re, të madhe, me qëllim që të nisej për pushtimin e asaj fortese. Për këtë ai thirri në Lezhë «kuvendin e kapedanëvet» për të kërkuar ndihmën e tyre. Por në këtë kohë ai u sëmur rëndë nga ethet dhe, duke ndjerë se i kish ardhur dita e fundit, thirri në mbledhje «gjithë shokët dhe princërit që kishin ardhur tek ai, të deleguarit e venetikasvet... si dhe kapedanët dhe krerët e kampit të tij». (Po aty). Këtyre të gjithëve ai u foli me mirësi, duke u thënë ndër të tjera këto:

«Virtuti më i lartë dhe besa e vërtetë, o princë fort bujarë dhe ju, o bashkëluftëtarë të mij shumë të dashur, kujtoj se është . . . jo vetëm ta duash dhe ta kesh gjithëmonë para syvet atdheun dhe shtetin, ku secili ka lindur dhe është edukuar, por edhe ta mbrosh e ta shpëtosh edhe me gjak.

Janë mbushur tridhjetë vjetë tani, o bashkëluftëtarë të mij, që kurse unë shpëtova nga duart mizore dhe të ndyra të

prijësit të turqvet Murat dhe gjeta shpëtim në mbretërinë e të parëvet dhe të prindërvet të mij. Që prej asaj kohe unë kam bërë gjithëmonë dhe kam mbajtur mbi shpatulla për mbrojtjen e gjithë interesave tonë... luftra të paprera kundër gjindjes së pabesë dhe tèrbimit otoman. Dhe të gjitha... na kanë shkuar mbarë, na kanë dalë me sukses e siç na e ka dashur zemra; dhe mua, kapedanin dhe bashkëluftëtarin tuaj, s'më kini pritur ndonjëherë të mundur apo të dërmuar në luftë të vërtetë, por gjithëmonë, le të më lejohet edhe mua ta them, fitimtar mbi armikun. Mua s'më kujtohet të jem goditur ndonjëherë, vetëm se në një rast me shigjetë në këmbë të djathët nga një farë barbari, të cilin e bëra aty për aty copë e fërtle para syve të të gjithë ushtërisë dhe ia flaka kokën të gjakosur ndër këmbët tuaja. Tjetër herë kurrë, sigurisht, siç e dini, këto gjymtyrë dhe ky trup i im, i hedhur në gjithë ato luftra e rreziqe, nuk e ndjeu shpatën armike apo dhëmbjen e ndonjë plage. Por tani, që e kam rrökullisur, siç ndodh zakonisht me jetën njerëzore, vitin gjashtëdhjetë e tre të moshës sime dhe kam marrë tatëpjetën e përqërisë, tani, o shokë, o bashkëluftëtarë të mij, shikoni, po mbaroj i mbërrthyer nga sëmundja e rëndë që më ka rënë dhe i këputur krejt, pa pikë fuqie natyrore në vehten time.

Unë po e ndjej tanimë, o bashkëluftëtarë të mij, po e ndjej, them, se ka ardhur koha që unë duhet të vdes, të largohem nga kjo botë. Dhe ju betohem, ky mendim, ose më mirë kjo domosdoshmëri nuk më trondit mua me asnjë mënyrë. Unë nuk i shtrohem me pahir kësaj zgjedhe... Nuk duhet të na vijë keq aspak, nuk duhet të vajtojmë asnjë çikë, sepse nuk pësojmë kundër ligjit; përkundrazi, në bazë të ligjit, ne kemi lindur që të vdesim të gjithë dhe kësaj domosdoshmërie s'ka kush i shpëton. M'anë tjetër unë e dij se, çka është e domosdoshme për të gjithë, s'mund të jetë e vajtuëshme për njerin. Më në fund, balta duhet t'i kthehet baltës; ne duhet t'i bindëmi natyrës... Megjithëkëtë, o shokë dhe bashkëluftëtarë të mij fort të dashur, unë nuk e përballoj tani, nuk e përqafoj me shpirt kaqë të qetë këtë fat të vdekjes që t'u shmangem rreziqevet, që t'u bëj bisht mundimevet, që t'u shpëtoj vuajtjevet, në të cilat kam qenë zhystur dhe kam jetuar gjatë gjithë kohës gjer tani... Përkundrazi, unë jam gati që të heq vuajtje dhe mundime gjithëmonë më të shuma e më të mëdha, veçse po e shoh, po e shoh tanimë se jeta ime po merr fund... Por, përpara

se të heq fryshtë e fundit dhe të ikëj nga ju e t'ju lë, është nevoja para së gjithash për një gjë, për të cilën unë, sipas zakonit që kam pasur gjithëmonë në vitet më fatlumë të mos hës sime, mendova t'ju flas dhe t'ju këshilloj, që shpëtimin dhe nderin... ta kini edhe këtej e tutje, pas vdekjes sime, gjithëmonë në zëmër, gjithëmonë para syvet, dhe të derdhni për të gjer në pikën e fundit tërë djersën tuaj, po ash tu siç e kini derdhur gjer tani, me mua gjallë, tërë mundin tuaj me një simpathi e admirim aq të madh nga të gjithë... Dhe të gjitha punët, besomëni mua, do t'i kini shumë të lëhta dhe shumë të mbara dhe çdo gjë do ta çmoni më poshtë si të mirën e përbashkët dhe dobinë publike, po qe se ruani gjithëmonë paqen dhe bashkimin së pari dhe pastaj besën e dashamirësinë ndërmjet jush. Dhe me të vërtetë, s'ka asnjë shtet aqë të fuqishëm dhe aqë të shëndoshë, që të mos shembet dikur e të mos rrënohet, kur u lëshon vend mërivet dhe grindjeve të përbashkëta, kur vë përpara së mires së përgjithëshme dobinë dhe përfitimin vehtiak. Por, në rast se ju do të jeni përkundrazi të lidhur e të bashkuar, asnjë armik dhe asnjë sulm kundërshtari nuk do të mundë t'ju dëmtojë, mbretëritë dhe shtetet tuaja do të rrojnë, do të qëndrojnë përrhera; popujt, gjindjet, gratë, fëmijët dhe të mirat tuaja do t'i kini siguruar për gjithmonë për qetësinë dhe fatbardhësinë e përrherëshme. Ju nuk do të mund t'i trëmbi tèrbimit të Otomanit, as furisë barbare. Dhë përitë, kurthet e pusitë, që ai po kurdis ditë e natë dhe, po përpinqet t'i ngrejë kundër jush me qëllim që t'ju ndajë dhe t'ju veçojë ju dhe fuqitë tuaja dhe ta shëmbë e ta çdukë kështu secilin prej jush veçmas e një nga një, ashtu siç ia do zëmra, nuk do t'i ndezin.

Veç këtyre, o shokë, dhe luftëtarë kryetrima, unë po e lë tërë hall, kujdes e dashuri në dorë tuaj dhe në besën e trimërinë tuaj birin tim Gjon, i cili është akoma i pafuqisnëm dhe thua jse foshnjë që ende belbëzon, prandaj nuk është mjaft i zoti as të parashikojë, as ta prapësojë rrezikun që të mos e shqyejnë e të mos e gjalltin tigrat e egër e të tèrbuar që Mehmeti i pabesë dhe armiku i përbashkët të mos e çdukë së bashku me mbretërinë, gjë për të cilën ai është gjithëmonë në hall të madh dhe së cilës i rri ngahera në pritë me gojën e vet të tèrbuar e të gjakosur. Dhe më pikon në zëmër, por ai do t'ja arrijë kësaj, do t'a shtjerë në dorë, do ta dërmojë të ziun, po qe se nuk do t'i dalë për zot e nuk do ta shpëtojë trimëria dhe armët tuaja. Dhe me të vë-

tetë, sa po ta marrë vesh tirani gjakatar se unë kam mbaruar, nuk do të presë asnje çast, por do të vrapojë sa më shpejt, si ndonjë egërsirë e tèrbuar, për të çfryrë dhe për t'u shpaguar kundër birit të vogël e fatzi për gjithë ato të këqia, për gjithë ato kërdira dhe dëme që pësoi nga i ati, dhe për të bérë kundër tij, o i mjeri unë, gjithë provat e egërsisë dhe të gjakësisë më çnjerëzore. Prandaj gjënë dhe mbretërinë e tij, o shokë dhe bashkëluftëtarë fort të dashur, rrëthojeni me atë besnikëri, me atë kujdes, me të cilin unë i kam rrëthuar, po deshët të them të vërtetën, gjatë gjithë jetës sime tërë të mirat dhe gjërat tuaja të çmuara. Unë jetova jo vetëm për vehte time, por edhe për ju të gjithë dhe për fëmijët tuaj dhe u mundova e dërsita me një mënyrë t'atillë, që s'pushova as ditë, as natë nga mundi e pagjumësia. Mua s'më tepëroi asnjeherë koha në gjithë jetën time për pushim, as për qetësi, s'pata vënd të caktuar, as kohë, për të ngrënë apo për të fjetur; dhe rrinja si ditën, si natën pa gjumë... Unë ju betohem, që t'ua hap tanë së paku zëmrën time, meqë e solli fjala, unë kundër jush s'kam bërë apo kurdisur ndonjëherë asnje kurth apo mashtrim dhe ju kam patur e dashur jo si ushtarë që të më ruanit e të më shërbenit, por si shokë e vëllezër gjithëmonë. Asnjeri prej jush, siç e mbaj mënd mirë, nuk është prekur nga unë jo vetëm me dorë, por as me fjalë të rendë. Për kujdes në fushë të luftës, për mund e shërbim ushtarë, për roje e patrullim unë s'kam qënë kurrë më poshtë se ju, por e quanja vechten si një prej bashkëluftëtarëvet dhe donja që t'u mharesha jo fjalëvet, por vepravet, dhe të kërkohet prej meje jo vetëm disiplina, por edhe shëmbëlla. Asnjë mundi, a një vështirësie apo rreziku nuk i shmangesa apo nuk i largohesha me ndonjë farë të shtime apo bishtërimi. Në sulmin kundër armikut, mos ma merrni për keq, unë hidhësha ndër të parët; nga beteja dhe përleshja kthehësha me të fundit. Plaqën e barbarëvet unë jua ndanja dhe jua jepnja së pari juve: asgjë prej tyre nuk mbanja për vehte. Mbretërinë, pushtetin, të mirat dhe më në fund çdo gjë timen unë e kisha të përbashkët me ju. Unë asgjë s'kisha të vetën, apo të dalluar, asgjë të ndarë apo të veçuar, nga ju. Tani, o bashkëluftëtarë fort të dashur, ja, po vdes, ja, po ju lë. Prandaj ju lutem të gjithëvet dhe ju kërkoh që ktë besnikëri, mirësi dhe dashuri që s'ju ka munguar kurrë nga ana ime, ta kini e ta tregoni me dëshirën tuaj

kundrejt birit tim, mbretërisë dhe pushtetit të tij, kundrejt Gjonit tim, që unë po jua dorëzoj dhe po jua lë si fytyrë dhe pasqyrë time, si mëkëmbës në vëndin tim». (XIII, 483-486).

Pastaj Skënderbeu, si tha këto fjalë, thirri pranë të birin e vet Gjon dhe i dha, si një prind i vërtetë shqiptar, tërë kujdes e dashuri, me hall në zémër e «me fjalë përkëdhelëse», këshillat e rastit. Ndër të tjera ai i foli kështu:

O biri im, biri im Gjon, ja, unë po vdes tanimë dhe ty po të le fëmijë të vogël e të njomë, por me një mbretëri e pushtet të fortë dhe të patundur sigurisht, po të jesh i mirë, që të dobët e të pafuqishëm, po të jesh i keq. Prandaj përpipu dhe kujdesu fort që të mos vësh gjë përrpara mirësisë dhe virtutit, sepse me anë të këtyre edhe vechten tënde do ta shpëtosh, edhe mbretërinë dhe pushtetin jo vetëm që do ta kesh të qetë dhe pa dallgë, por edhe do ta rrëtësh çdo ditë, do ta bësh më të madh e më të shkëlqyer. Por tani, or bir, ti je i pafuqishëm për shkak të moshës dhe jo mjaft i zoti për të mbajtur frenat e pushtetit; përveç kësaj, ti ke armiq nga të katër anët, ke egërsirat më të këqia, që përpiqen paprerë të të shqyejnë dhe të të gllabërojnë, ke Mehmetin, atë tiranin e dëgjuar, armikun e përbashkët . . . i cili, po të marrësh, o biri im, përsipër kaqë i vogël dhe i pafuqishëm kujdesin e mbretërisë sate atërore, do të të dërmojë dhe do të të shëmbë krejt. Prandaj, o shpirti im, sapo t'ia kesh mbyllur dhe shtrënguar sytë babës dhe sapo të ma kesh futur trupin në vart hidhu menjëherë së bashku me tët'ëmë në Dauni dhe shko sa më shpejt në qytetet dhe kështjellat e tua<sup>1)</sup> dhe qëndro atje, gjersa të të dërsijnë mustaqet dhe të bëhesh i zoti për të drejtuar dhe qeveri. ur shtetin tënd». (XIII, 486-487). Pastaj vazhdon:

Por, kur të kthehesh, o biri im, e të rrish në mbretërinë tënde të paqesuar e të qetë e të marrësh përsipër kujdesin e drejtimin e saj, respekto para së gjithash drejtësinë, e cilë është më e shkëlqyera nga gjithë virtutet, ruaj paanësinë, duke mos bërë asnjë dallim ndërmjet fytyrës së të varfërit, të të pasurit dhe të të fuqishmit, në çdo gjë përdor urtësinë dhe maturinë. Mbretërinë tënde gardhoje dhe forcoje . . .

1) Janë qytetet që mbreti Ferdinand I Napolit i kish falur Skënderbeut në shenjë mirënjohjeje për ndihmën kundër galëvet. (X, 416).

Ti, pra, o bir, do t'i kesh t'e gjitha këto, do t'i kesh, besomë mua, do t'i mundësh, do t'i bësh krejt për vehte gjithë njerëzit, po qe se do t'e mbash porositë e mia, sepse vetëm **njerëzishmëria**, vetëm **mirëbërësia**, të pëlqyera nga . . . njerëzia, që s'të rrezikojnë kurrë dhe në asnjë vënd dhe që ua kalojnë pa dyshim dhe i lenë prapa shumë virtutet e tjera, lindin në zëmrat e të gjithëvet dashurinë e tyre të admi-rueshme . . .

Më në fund, o bir, ji trim në kohët e vështira dhe të zeza. Përkundrazi, në kohët e lumura dhe të bardha, drejtoje dhe frenoje fatin e mbarë me anë të virtutit. **Mos e duro qetësinë** qulle dhe plogështinë e çburrëuar, sepse prej tyre vijnë të gjitha të këqiat. Plogëشتia është burimi i gjithë të këqiat. Ushtarët e tu mos i lërë të kalben duke ndenjur në plogëشت, por ushtroji me punë, mund e pagjumësi të paprerë; megjithëkëtë, mos i përdor ata si shërbëtorë, por si shokë e bashkë-luftëtarë. Në punë të luftës e të kujdesit për ushtarët të tregohen jo vetëm komandant, por edhe ushtar. Endjet urreji fort, tepërvet largoju, sepse prej tyre edhe burrat më trima z më të fuqishëm qullen e çburrërohen. Largoju gjithashtu edhe retepësisë së tepëruar edhe egërsisë, e cila u ka hije vetëm bishavet. Ji i duruar në mundime dhe i patrembur në rreziqe. Ndryshimin dhe paqëndrueshmërinë e punëvet përballoje me trimëri dhe urtësi . . .

Përveç këtyre, ki gjithëmonë parasysh që t'u largohesh pësivej të barbarëvet, me të cilat merret me të madhe ky farë milieti. Largoju pabesis, largoju dhëlpërvet të gjindjes së pabesë; përbuze miqësinë, urreje shoqërinë dhe dashamirësinë e tiranit më të kobshëm, përbuzi dhuratat ledhat dhe zotimet e tij, që të mos të të zhytë në mjerim të përjetëshëm, gjersa dëshiron të të shtjerë në dorë. Prandaj të marrësh gjithëmonë këshilla nga këshillonjës të njohur, besnik dhe të dashur,

Këto janë, o drita ime, o biri im, porositë dhe mësimet që unë vetë kam marrë e kam mësuar nga prindi im, mësonjësi i merituar dhe nga këto mësime kam mbetur gjithëmonë i kënaqur; me këto unë e kam arësyer vehten, me këto e kam mësuar, këto i kam patur si model për moshën dhe tërë jetën time, prej këtyre më në fund kam patur përfitime shumë të mëdha. Prandaj këto tanë të këshilloj me të madhe, të porosis dhe, po durove, të lutem si prind, si prind, them, të lutem

e të lëshoj be që t'i mësosh edhe ti, që t'i përqafosh, t'i ihithësh, t'i ruash». (XIII, 486-488).

Skënderbeu lindi, jetoi, veproi e vdiq për atdhenë. Edhe në kohën, kur po lëngonte duke dhënë shpirt mbi shtratin e vdekjes, me të dëgjuar «se turqit ia kishin mbërritur tanimë, se kishin përshkuar e djegur viset fqinje», ai kërkon armët dhe kalin për t'i dalë armikut përpara duke e kyçur gojën me këto fjalë të tij të fundme: «**Dilni, dilni, ushtarë, kundër armiqvet dhe barbarëvet, shkonit përpara meje, se po ju vij menjëherë nga pas**». (XIII, 489). «Kaqë fort që vlonë në atë gjoks të zjarrtë një zémër e zjarrtë» përfundon Barleti ynë i zjarrtë.

Por s'ka dyshim se ky zjarr dashurie të pashuar për atdhe, për liri e pavarësi, që vlonë aqë fort në atë zémër të zjarrtë e në atë gjoks të zjarrtë të kryetrimit tonë Skënderbeu dhe ushtarëve të tij dhe që aq mirë e bukur është ruajtur e pavdekësuar me atë zjarrin e zémrës e të pendës së Barletit tonë në veprën e tij monumentale, është vetë zjarri i dashurisë për liri e pavarësi, që vlonë e s'shuhej kurrë në zémër e në gjoks të popullit, që digjte e përvëlonë, bënta hi e shkrumbonte, nën drejtimin e kryetrimit, çdo këmbë e dorë armiku, që tentonte të shkelte e të robëronte Shqipërinë, atdheun e Skënderbeut, selinë e kryetrimavet, Arbërinë e pamposhtur. Prandaj Skënderbeu mbetet kështu për jetë një yll — simbol i zjarrtë i zémrës popullore, një «yll i ndritur e i bukur i Arbërisë», një simbol i pavdekur i lavdisë dhe pavdekësisë shqiptare, i mëndjes dhe i zémrës, i shpirtit të popullit të vet të pamposhtur.

## TI RICORDO COME ALLORA

Vai, vai,  
presto verrò da te.

Vai, non parlare,  
m'immagini lontano  
per un ricordo passato,  
per un dolce ricordo,  
per un ricordo immacolato!

No, non l'ho dimenticato,  
quel dolce momento!  
eh, quando mi stringevi la mano  
quali tremori prendevano il corpo mio  
chi potrà comprendermi?  
solo tu stella splendente  
seppur io non parlo?!

Vai, vai,  
presto verrò da te,  
vai col cuor leggero  
senti i sospiri del cuore,  
piano mi prende la fretta,  
non mi lascia quiete.

Sulla spalla,  
ora la tua mano si ferma!  
Io rivivo questo momento!  
ma, ho, il ricordo non m'abbandona!  
ti sento come quel giorno  
cosa avverrà qui di me,  
cosa accadrà più, con gioia?!/contentezza?!

SHPËTIM

di

nascita:

TIRANA

BOZHA

(Albania)

TERICORDO COME ALLORA

Vai, vai,  
presto verrò da te.  
Vai, non parlare,  
m'immagini lontano  
per un ricordo passato,  
per un dolce ricordo,  
per un ricordo immacolato!

No, non l'ho dimenticato,  
quel dolce momento!  
eh, quando mi stringevi la mano  
quali tremori prendevano il corpo mio  
chi potrà comprendermi?  
solo tu stella splendente  
seppur io non parlo?!

Vai, vai,  
presto verrò da te,  
vai col cuor leggero  
senti i sospiri del cuore,  
piano mi prende la fretta,  
non mi lascia quiete.

Sulla spalla,  
ora la tua mano si ferma!  
Io rivivo questo momento!  
ma, ho, il ricordo non m'abbandona!  
ti sento come quel giorno  
cosa avverrà qui di me,  
cosa accadrà più, con gioia?!/contentezza?!

SHPËTIM

di

nascita:

TIRANA

BOZHA

(Albania)

Përbajtja e lëndës

	Faqe
1 Dy fjalë si hyrje .....	3
2 Fjalimi i Skënderbeut në Krujë .....	5
3 Fjalimi i Skënderbeut para Sfetigradit .....	9
4 Fjalimi i Skënderbeut në Kuventin e Lezhës .....	13
5 Fjala e Skënderbeut para përieshjes me Ali Pashën .....	22
6 Letra e Vladislavit dërguar Skënderbeut .....	31
7 Letra e Skënderbeut dërguar Vladislavit .....	33
8 Letër e Skënderbeut dërguar Muratit .....	34
9 Fjalimi i Skënderbeut para ndeshjes me Mustafanë .....	36
10 Fjalimi i Skënderbeut para përieshjes me Venedikasit në Shkodër .....	41
11 Fjalimi i Skënderbeut drejtuar mbrojtësve të Sfetigradit .....	45
12 Përgjigja e Skënderbeut Muratit .....	48
13 Fjalimi i Skënderbeut pasi dërmol Muratin .....	50
14 Fjalimi i Skënderbeut para betejës së Pologut .....	55
15 Fjalimi i Skënderbeut para fushatës për çlirimin e Beratit .....	57
16 Fjalimi i Skënderbeut para përieshjes me Hamzën .....	61
17 Përgjegjia e Skënderbeut prepozimit të Mehmetit për armëpushim .....	63
18 Pritja e Skënderbeut në Raguzë dhe fjala në senat për ndër tjetj .....	79
19 Fjala e Ferdinandit për Skënderbenë .....	72
20 Letër e Skënderbeut me të cilën i përgjigjet Mehmetit .....	75
21 Letër e Skënderbeut, me të cilën i shpalli luftën Mehmetit .....	77
22 Fjala e Skënderbeut para përieshjes me Ballabanin .....	82
23 Fjala e Skënderbeut para përieshjes së kërdishme me Ballabanin .....	84
24 Fjala e Skënderbeut para përieshjes me Jakupin .....	87
25 Fjalimi i Skënderbeut në mbledhjen e princërvet .....	90
26 Nga fjalimi i Skënderbeut pas vrasjes së Ballabanit .....	91
27 Fjalët qe këshillat e fundit të Skënderbeut në Lezhë para vdekjes së tij .....	97

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921

1920-1921